



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Nr. 02-060/01-0021467/26 dt. 20.04.2026

Mitrovicë

Në zbatim të nenit 43, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale; nenit 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, dhe nenit 5, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës; nenit 50, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, dhe nenit 52, paragrafi 1, të Statutit të Komunës së Mitrovicës; Kryesuesi i Kuvendit të Komunës për të **mërkurën** më dt. **29.04.2026**:

T H Ë R R E T

Mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës
(Mbledhja e 8-të)

Mbledhja do të ketë këtë REND DITE:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
2. Draft-Rregullorja për plotësim të Rregullores Nr. 01/2022 Për organizimin, kompetencat dhe përgjegjësitë e Administratës Komunale
3. Propozim vendim për bartjen e të hyrave vetanake të pashfrytëzuara në vitin 2025 dhe vitet paraprake, në vitin 2026
4. Propozim vendim për kompensimin e anëtarëve të komiteteve konsultative, komiteteve tjera, kryetarëve të këshillave lokale dhe komisioneve ad hoc të formuara nga Kuvendi i Komunës, për vitin 2026
5. Propozim vendim për subvencionimin e fëmijëve me autizëm
6. Propozim vendim për vendosjen e pllakës përkujtimore heroit Driton Veliu
7. Propozim vendim për caktimin e selisë së përhershme të Muzeut të qytetit të Mitrovicës
8. Propozim vendim për shfuqizim të Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-0005630-18/26, dt. 10.02.2026 Për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave në procedurën e përzgjedhjes së anëtarëve në Bordet e Drejtorëve të NPL-ve
9. Propozim vendim për shfuqizim të Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02/06-4136/10 dt. 02.08.2010
10. Kërkesa e Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve të Luftës së UÇK-së – Dega në Mitrovicë, për mbështetje financiare
11. Kërkesa e Invalidëve të Luftës së UÇK-së – Dega në Mitrovicë, për mbështetje financiare
12. Kërkesa e Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së – Dega në Mitrovicë, për mbështetje financiare
13. Kërkesa e Lidhjes së Invalidëve dhe Viktimave Civile të Luftës – Dega në Mitrovicë, për mbështetje financiare
14. Raport financiar për periudhën janar-mars 2026
15. Raport i vlerësimit të dëmeve të shkaktuara në biznese nga vërshimet
16. Pyetje dhe përgjigje

Mbledhja do të mbahet në Sallën e Kuvendit duke filluar nga ora 10:00.

Mitrovicë



Kryesuesi i Kuvendit

Safet KAMBERI



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT
Nr. 02-060/01-0014451/26 dt. 27.03.2026
Mitrovicë

PROCESVERBAL
Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës
Seanca e 7-të

Koha: 27.03.2026, ora 10:00

Vendi: Salla e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës

Të pranishëm: Anëtarët e Kuvendit: Shkëlqim Ibrahim, Fisnik Suma, Majlinda Kurti, Igballe Islami, Ferdi Kadriu, Artan Berisha, Gëzim Stavileci, Egzon Sadiku, Valon Brahimi, Liridona Muharremi, Nazmije Sejdiu, Lavdim Zeneli, Armend Begu, Jeton Zeneli, Kushtrim Zeneli, Erseka Barani, Rinesa Preteni, Sazan Ramaxhiku, Bajram Istrefi, Visar Sylja, Xhevdet Osmani, Elfate Ademi Bahtiri, Rozana Peci, Oltion Ahmeti, Xhylyjeta Imeri, Arta Neziri, Gjergj Beka, Jeton Ujkani dhe Flamur Vojvoda

Kryetari i Komunës z. Faton Peci

Nënkryetari i Komunës z. Enis Osmani

Përfaqësues të Shoqërisë Civile

Mediat

Mungoi: Egzon Hamza

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi Kryesuesesi i Kuvendit z. Safet Kamberi, i cili fillimisht përshëndeti Kryetarin e Komunës, Nënkryetarin e Komunës, anëtarët të Kuvendit, përfaqësuesit e Ministrisë së Pushtetit Lokal të cilët monitorojnë përmes teleprezencës, organizatat joqeveritare vendore dhe ndërkombëtare, media dhe të pranishmit tjerë. Në vazhdim Kryesuesi i Kuvendit i Kuvendit theksoi Në zbatim të nenit 43, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale; nenit 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, dhe nenit 5, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 02/2015 Për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës; nenit 50, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, dhe nenit 52, paragrafi 1, të Statutit të Komunës së Mitrovicës, në cilësinë e Kryesuesi i Kuvendit të Kuvendit të Komunës kam thirrur mbledhjen e 7-të të rregullt të Kuvendit të Komunës, me rend dite siq është paraparë me thirrje (lexoi rendin e ditës). Të pranishëm janë 24 anëtarë.

Hap diskutimin rreth rendit të ditës.

Kryetari i Komunës z. Faton Peci: Të nderuar anëtarë të asamblesë, drejtorë të ekzekutivit, duke u bazuar në mundësitë dhe kompetencat ligjore që mi jep ligji, unë kam dy propozime: Largimin e pikës dytë nga rendi i ditës, për shkak se vlerësoj që ka nevojë ende për një përgatitje më adekuate të dokumentacioneve për të kaluar tutje, përkundër që zotimi im publik para qytetarëve ka qenë që drejtoria e pronës të jetë një drejtori e veçantë, mirëpo kam disa rezerva nga mënyra se qysh administrativisht është menaxhuar kjo çështje. E dyta, kam tre pika të rendit të ditës si propozime.

E para ka të bëjë me kompensimin e kostove financiare të dy familjeve për shkak të humbjes tragjike të anëtarëve të tyre në një aksident komunikacioni në Itali, fjala është për familjen e Fidan Pecit dhe Ardian Avdyilit, të cilët kanë humbur jetën tragjikisht në Itali dhe se kostoja e ekzaminimit dhe kostoja e transportit të kufomave është barrë e rëndë për familjet. Në këto momente shumë të rënda, minimumi çka mund të bëjmë është që të paktën t'u kompensojmë kostot financiare të transportit të kufomave deri në vendlindje.

Pika tjetër e rendit të ditës që unë propozoj ka të bëjë me propozim-vendimin për formimin e komisionit për rivlerësimin e gjendjes ekonomike dhe sociale të familjeve përfituese, fjala është për pronat ose objektet banesore që janë nën menaxhimin e Komunës së Mitrovicës dhe besoj që materiali është shpërndarë te anëtarët e Kuvendit.

Propozimi i tretë për pikë të rendit të ditës vije nga Drejtoria e Arsimit: propozim-vendim për formimin e komisionit për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve në institucionet edukative dhe arsimore, prej të cilave 20 janë të listuara në propozim-vendim.

Valon Brahim: Para se të fillojmë me diskutimin e pikave të rendit të ditës, kam disa vërejtje që janë të natyrës substanciale dhe që kanë të bëjnë me fjalën publike dhe përgjegjësinë për fjalën publike. Prej ditës së parë kur keni ardhur këtu si asambleistë, kemi qenë më tepër se korrekt edhe me ekzekutivin edhe me kolegët e asamblesë. Dy deklaratat që kanë qarkulluar nga kryetari dhe nënkryetari në media, se kinse disa zyrtarë të PDK-së kanë dalë me i mbrojtë interesat e bizneseve, dhe se kinse neve po na "udhëheqin" bizneset por nuk po na udhëheqin Kadriu dhe Hashimi dhe se kinse kemi dalë qëllimshëm në vendngjarje, nuk qëndrojnë. Është mirë me dëgjuar deklaratën time edhe Kryetari edhe Nënkryetari, e cila ka qenë shumë konstruktive. Unë kam deklaruar në mënyrë decisive, siç po e them tani, Nënkryetar, pastaj ti mundesh me qesh, por dua me kërku falje. Konsideroj që duhet me kërku falje, sepse kërkimi i faljes nuk është ligësi, është burrëri. Deklarata ime ka qenë decisive: jam për me u largu të gjitha billboardet që janë në kundërshtim me ligjin, pa më interesu për cilin biznes bëhet fjalë. Te billboardi që ka të bëjë me dy figurat kombëtare, kam deklaruar se ato nuk janë vetëm të miat, por edhe të juajat, sepse i përfaqësojmë të gjithë, kam thënë se për shkak të momentit në të cilin po kalon Kosova, duhet me tejkalluar çdo bindje politike. Kadriu dhe Hashimi nuk kanë nevojë me na dhimbtë as mua, as juve. Ata nuk janë për dhimbje, por për krenari. Prandaj, nuk kemi nevojë me i përdorë në këtë kontekst. Është mirë me u matë deklaratat dhe me kërku falje publike. Përndryshe, Ligji për shpifje e din çfarë flet. Nëse nuk kërkohet falje publike dhe nuk sqarohet situata, unë kam me e adresu në gjykatë. Shumë e thjeshtë dhe shumë e qartë. Nuk e kam vullnet, por e kam të domosdoshme nëse vazhdohet kështu. Deklarata ime ka qenë shumë e qartë: nuk ka pasur asnjë tendencë me u heq billboardet, dhe nuk ka pasur asnjë zyrtar komunal me qëllim me i mbrojtë bizneset apo me i targetu ato. Kemi qenë shumë korrekt. Ligji duhet me u zbatu gjithmonë. Çdo veprim i Drejtorisë së Inspeksionit për largimin e billboardëve pa leje e ka përkrahjen time në çdo kohë, nuk dua me e politizu këtë çështje. Janë dalë dy-tre zyrtarë të PDK-së, ato i din edhe Kryesuesi i Kuvendit, kam pasur edhe procedura administrative për kryerjen e punëve në komunë. Kërkoni falje dhe bëni më shumë konstruktivitet. Dhe pika tjetër, kam edhe një vërejtje të dytë, veç dëgjoni një sekondë.

Kryesuesi i Kuvendit Safet Kamberi: Meqenëse jemi tek rendi i ditës, unë për këtë arsye sot e kam shpërndarë tek secili anëtar i Kuvendit Rregulloren për punën e kuvendit.

Valon Brahim: Po, vetëm dua me thënë që kërkim-falja duhet me i paraprirë kësaj pune, sepse ne mundemi edhe mos me marrë pjesë në seancë, që kjo pastaj bëhet problem dhe nuk e dimë as a po e miratojmë rendin e ditës apo jo. Nuk është ligësi me kërku falje për një gabim që është bërë nga nënkryetari. E dyta, e kam edhe një vërejtje tjetër, ne kemi pritur me na ardhur si zyrtarë komunal ftesat për akademinë me rastin e përkujtimit të dy figurave kombëtare, Latif Berisha dhe Agim Hajrizi. Si zyrtarë, ne e dimë që bëhen publikime në faqen e komunës, por ne nuk jemi të obliguar me përcjellë faqen e komunës. Ne kemi email-e zyrtare dhe nuk duhet me na konsideruar neve, po them me thonjëza, si njerëz që nuk marrim pjesë në këto tubime. Latif Berisha dhe Agim Hajrizi janë njerëz të kombit. E

di që kanë qenë të LDK-së dhe është mirë që kanë qenë LDK, por pas martirizimit të tyre më nuk duhet me u trajtu kjo çështje si ekskluzivitet politik. Ata nuk kanë të njohur kështu që në të ardhmen është mirë me pas kujdes me na ftu në këto akademi, sepse ata meritojnë nderim dhe ne kemi qenë me marrë pjesë për me i nderuar figurat e tyre. Besoj që vërejtja ime duhet me qenë edhe një herë më e kujdesshme, si në deklaratatë ashtu edhe në këto ftesa kur bëhet fjalë për figura publike.

Nënkryetari i Komunës z. Enis Osmani: Mua po më vjen keq që është keqinterpretuar nga asamblisti në fjalë. E keni deklaratën, nuk e paske dëgjuar me vëmendje. Unë besoj që ti nuk je përfaqësues i asnjë kompanie që ka billboarda diku në Mitrovicë. Asnjë emër të veçantë, as të asamblistëve, as të askujt tjetër nuk kam përmendur. Kam thënë disa kompani të caktuara, disa individë të caktuar. Dëgjoje deklaratën mirë. Unë jam i prirur me mbrojt fjalën time që e kam thënë sot e katër vjet, ose sa kohë që jam këtu. Për hir të korrektësisë, po ta kthej përgjigjen: nuk besoj që ti ke billboarda, as familjarët e tu, as ndonjë kompani që e ke ti. Nuk besoj që je medium që ke dalë dhe ke shpifur atë ditë, siç kanë bërë disa medime të tjera që kanë thënë se po largohen dy billboarda. Ato dy billboarda nuk kanë pasur me u largu. Ka qenë dakordim me propozim të Kryetarit. Ato dy billboarda, ajo para komunës dhe ajo te ish-Florienti, ajo e madhja, nuk kanë pasur me u largu. Mua më vjen keq që keni ra pre e provokimeve të gazetarëve dhe disa personave të pandërgjegjshëm, që kanë tentuar me përfitu në atë nivel. Më vjen keq që kanë ra pre edhe disa asamblistë dhe ish-nënkryetari. Dëgjoje mirë edhe këtë përgjigje. Unë kam thënë disa persona të caktuar, disa individë të caktuar që kanë pasur interesa financiare, dhe ju e dini kush janë. Nëse doni, mund t'i përmend edhe me emra, por për hir të korrektësisë nuk dua me u lëshu deri në atë pikë. Nuk jam i interesuar me u përfshi në këtë nivel, por kërkoj që të ruhet korrektësia. Tjetër, më vjen keq që disa asamblistë, përfshirë zotëri Stavilevci, dhe nënkryetarin, nuk e kam parë deklaratën tuaj dhe nuk e kam dëgjuar. Unë nuk i lexoj portalet shpifëse që qarkullojnë në Mitrovicë, prandaj nuk e kam dëgjuar deklaratën tuaj. Mua më vjen keq që keni ra pre e këtyre provokimeve të disa portaleve. Unë nuk kam përmendur asnjë asamblist në mënyrë të drejtpërdrejtë. Lexojeni deklaratën mirë: paragrafi i parë thotë disa persona që kanë pasur interesa financiare ata janë të identifikueshëm dhe mund të përmenden me emra, por nuk është qëllimi im me e eskalu këtë çështje.

Kryesuesi i Kuvendit: Faleminderit z. Brahimi unë po besoj që u sqarut atë që ngrite ti, e dha përgjigjen nënkryetari dhe po besoj që nuk kem nevojë me diskutu më për këtë çështje.

Valon Brahimi: Nënkryetar i nderuar, unë nuk e di ku janë billboardet dhe asnjëherë nuk më ka interesuar ku janë vendosur. Edhe drejtor kur kam qenë u kam thënë inspektorëve kryeni punën tuaj.

Kryesuesi i Kuvendit: Për mua kjo është çështje e mbyllur. A ka dikush tjetër, sa i përket rendit të ditës? Në këtë drejtim, u propozua që pika numër dy të tërhiqet nga rendi i ditës. Kryesuesi konstatoi se, në bazë të rregullave në fuqi, propozuesi ka të drejtë që në çdo fazë të shqyrtimit ta tërheqë pikën e propozuar, pa qenë e nevojshme hapja e diskutimit apo votimi për të njëjtën. Si rrjedhojë, konstatohet se pika numër dy tërhiqet nga rendi i ditës.

Nw vazhdim Kryesuesi I kuvendit kërkoi që të prezantohen saktë pikat e reja të propozuara nga kryetari i komunës, me qëllim të evidentimit korrekt të tyre në rendin e ditësi ne vazhdim:

- propozim vendimi për subvencionimin e familjeve Peci dhe Avdyli,
- propozim vendimi formimin e komisionit për vlerësimin e gjendjes ekonomike dhe sociale të familjeve përfituese.
- propozim-vendimin për formimin e komisionit për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve në institucionet edukative dhe arsimore.

Pas tërheqjes së pikës numër dy, u konstatua se të gjitha pikat e tjera të rendit të ditës zhvendosen për një numër më lart në renditje. Në këtë mënyrë, pikat e reja të propozuara nga kryetari u radhitën si pika 9, 10 dhe 11 e rendit të ditës, ndërsa pika 12 u caktua për pyetje dhe përgjigje.

Kryesuesi i Kuvendit: Meqenëse nuk ka diskutime tjera, hedh në votim propozimin që të hyjë si pikë e 9-të e rendit të ditës Propozim vendim për mbështetje financiare të familjeve Peci dhe Avdyli, e cila u propozua nga Kryetari i Komunës.

Rezultati i votimit: 29 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesi i Kuvendit konstaton se propozimi u miratua.

Kryesuesi i Kuvendit hedh në votim propozimin që të hyjë si pikë e 10-të e rendit të ditës Propozim vendim për formimin e Komisionit për rivlerësimin e gjendjes ekonomiko sociale të familjeve përfituese,

Rezultati i votimit: 29 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesi i Kuvendit konstaton se propozimi u miratua.

Kryesuesi i Kuvendit hedh në votim propozimin që të hyjë si pikë e 11-të e rendit të ditës Propozim vendim për formimin e Komisionit për zgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendëso drejtorëve në institucionet edukativo arsimore dhe aftësuese.

Rezultati i votimit: 29 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesi i Kuvendit konstaton se propozimi u miratua.

Në fund të kësaj pjese të mbledhjes, u konstatua se në seancë janë të pranishëm gjithsej 29 anëtarë të kuvendit. Kryesuesi i Kuvendit hedh në votim rendin e ditës të plotësuar ai në vijim:

1. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara
2. Propozim vendim për miratim të vendimit paraprak për publikim të listës së përgjithshme të pronave të paluajtshme të komunës si dhe listën e veçantë të pronave të cilat planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2026
3. Propozim-vendim për lejimin e mjeteve financiare për trajtim mjekësor jashtë vendit për znj. Elijona Brahimi
4. Propozim vendim për formimin e komiteteve konsultative
5. Propozim vendim për zgjedhjen e përfaqësuesve të Kuvendit të Komunës për anëtarë të Kuvendit të Asociacionit të Komunave të Kosovës
6. Kërkesë për vazhdimin e marrëveshjes me Këshillin e Bashkësisë Islame në Mitrovicë
7. Raport mbi vlerësimin e dëmeve si pasojë e vërshimeve në territorin e Komunës së Mitrovicës së Jugut, janar 2026
8. Raporti financiar i komunës për realizimin e buxhetit komunal janar - dhjetor 2025
9. Propozim vendim për mbështetje financiare të familjeve Peci dhe Avdyli
10. Propozim vendim për formimin e Komisionit për zgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendëso drejtorëve në institucionet edukativo arsimore dhe aftësuese
11. Propozim vendim për formimin e Komisionit për rivlerësimin e gjendjes ekonomiko sociale të familjeve përfituese
12. Pyetje dhe përgjigje

Rezultati i votimit: 29 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesi i Kuvendit konstaton se Kuvendi i Komunës unanimisht miratoi rendin e ditës,

Pika 1

Në vijim, Kryesuesi i Kuvendit njoftoi kalimin në pikën e parë të rendit të ditës, e cila kishte të bënte me miratimin e procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara. Ai theksoi se në shqyrtim ishin tre procesverbale dhe ftoi të pranishmit që të paraqesin vërejtje apo sugjerime eventuale.

Meqenëse nuk ka të lajmëruar për diskutim i hedh në votim procesverbalin nga mbledhja e 4-të.

Rezultati i votimit: 29 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesi konstaton se procesverbali nga mbledhjet e 4-të e Kuvendit u miratuan unanimisht.

Kryesuesi i Kuvendit hedh në votim procesverbalin nga mbledhja e 5-të.

Rezultati i votimit: 29 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesi konstaton se procesverbali nga mbledhjet e 5-të e Kuvendit u miratuan unanimisht.

Kryesuesi i Kuvendit hedh në votim procesverbalin nga mbledhja e 6-të.

Rezultati i votimit: 29 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesesi konstatoi se procesverbali nga mbledhjet e 6-të e Kuvendit u miratuan unanimisht.

Pika 2

Kryesesi në vazhdim njoftoi kalimin në pikën e dytë të rendit të ditës, e cila kishte të bënte me propozim-vendimin për miratimin e vendimit paraprak për publikimin e listës së përgjithshme të pronave të paluajtshme të komunës, si dhe listës së veçantë të pronave që planifikohen për dhënie në shfrytëzim për vitin 2026. Në këtë rast, u theksua se materiali përkatës u është shpërndarë sot tek anëtarët, duke përfshirë edhe një version të sistemuar në format Excel, i cili është përgatitur pas një kërkesë shtesë nga ministria përkatëse. U sqarua se përmbajtja e materialit mbetet e njëjtë, ndërsa ndryshimi qëndron vetëm në formën e paraqitjes. Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin.

Igballe Islami Theksoi se çështja e pronës publike lidhet drejtpërdrejt me interesin e qytetarëve dhe përfaqëson pasuri të përbashkët, për menaxhimin e së cilës kërkohet përgjegjësi e lartë institucionale. Ajo nënvizoi se çdo vendim duhet të jetë në përputhje me ligjin, i mbështetur në procedura të rregullta dhe në dokumentacion të saktë. Gjithashtu, ajo theksoi se para vetes ka dy versione të materialeve, një që është shqyrtuar në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe një tjetër që është paraqitur për shqyrtim në këtë seancë, duke lënë të kuptohet se ekziston nevoja për sqarime të mëtejshme lidhur me këto materiale. Në vijim të diskutimit, theksoi se diskutimi duhet të bazohet në dy dokumente të cilat, sipas saj, janë në kundërshtim të plotë me njëra-tjetrën. Ajo sqaroi se materiali i shqyrtuar në Komitetin për Politikë dhe Financa parasheh dhënien e parcelave për periudhë afatgjatë, ndërsa materiali i paraqitur në Kuvend ka ndryshuar këtë periudhë nga afatgjatë në afatshkurtër, me planifikim për zbatim që në tremujorin e dytë për parcelat nga një deri në nëntë. Gjithashtu, ajo theksoi se në materialin aktual janë përfshirë edhe tetë parcela të cilat nuk kanë kaluar fare në Komitet dhe rrjedhimisht, nuk janë pjesë përbërëse e propozim-vendimit të shqyrtuar institucionalisht. Më tej, deklaroi se në Komitet kanë qenë të shqyrtuara gjithsej 62 parcela, ndërsa në materialin e paraqitur në Kuvend janë përfshirë 67 parcela. Ajo përmendi konkretisht se parcelat me numër rendor 28, 34, 38, 47, 50, 58, 60 dhe 61 nuk kanë qenë pjesë e materialit të shqyrtuar në Komitet. Po ashtu, ajo ngriti shqetësimin se disa parcela që kanë kaluar në Komitet nuk janë sjellë fare për shqyrtim në Kuvend, duke përmendur konkretisht parcelat me numër 43 dhe 60, për të cilat kërkoi sqarime se pse janë tërhequr nga rendi i ditës dhe nuk janë paraqitur për miratim. Në vazhdim, ajo theksoi se njëra nga pikat (parcela nr. 28) nuk i ka plotësuar kriteret minimale për të vazhduar tutje, pasi nuk ka përmbajtur dokumentacionin e kërkuar sipas ligjit dhe rregullores përkatëse. Për këtë arsye, sipas saj, Komiteti ka votuar kundër që kjo pikë të procedohet për shqyrtim në Kuvend. Ajo shtoi se Komiteti ka nxjerrë konkluzione të qarta, duke kërkuar respektimin e rregullores dhe ligjit në fuqi, si dhe plotësimin e materialit me dokumentacionin e nevojshëm, përfshirë ortofotot përkatëse, certifikatat e pronësisë dhe përcaktimin e destinimit të tokës për secilën parcelë. Duke iu referuar rregullores përkatëse dhe ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës komunale, theksoi se materiali i paraqitur në këtë seancë nuk i përmbush këto kërkesa. Ajo potencoi se mungon destinimi i tokës për 67 parcelat e propozuara për dhënie në shfrytëzim, si dhe mungon konfirmimi ligjor nga zyra ligjore, gjë që, sipas saj, e bën të pamundur marrjen e një vendimi të ligjshëm dhe të bazuar në dokumentacion të plotë. Në vijim, ajo deklaroi se materiali i paraqitur nuk është i njëjtë me atë që ka kaluar në Komitet dhe se nuk përmban as konkluzionet e Komitetit, duke mos i përmbushur kërkesat ligjore dhe rregullative për procedim të mëtejshëm. Theksoi se me këtë material po tentohet të miratohet dhënia në shfrytëzim e rreth 420,000 m² tokë komunale pa shqyrtim të plotë, pa konkluzion të Komitetit dhe jashtë procedurave të parapara ligjore. Ajo e cilësoi këtë jo si gabim teknik, por si ndryshim substancial dhe të qëllimshëm të materialit, i cili cenon ligjin dhe procedurat. Në përfundim, ajo theksoi se, pavarësisht ekzistimit të shumicës, asnjëherë nuk mund të vendoset mbi ligjin dhe nuk mund të përdoret për të anashkaluar procedurat apo për të miratuar materiale që nuk i plotësojnë kërkesat ligjore. Për këtë arsye, kërkoi që kjo pikë të tërhiqet menjëherë nga rendi i ditës dhe të kthehet për rishqyrtim në

Komitetin për Politikë dhe Financa, duke respektuar rregulloren, duke siguruar dokumentacion të plotë dhe duke garantuar që çdo vendim për pasurinë publike të jetë i ligjshëm, i qartë dhe i përgjegjshëm. Në vazhdim të diskutimit, theksoi se bëhet fjalë për pasuri publike, për të cilat secili anëtar i asamblesë është i obliguar t'i mbrojë. Ajo nënvizoi se këto pasuri janë në interes të qytetarëve dhe përbëjnë përgjegjësi ligjore për secilin prej të pranishmëve. Ajo shtoi se, pa dashur të tingëllojë e ashpër, nëse kjo pikë procedohet në këtë formë dhe me të gjitha vërejtjet e paraqitura, ajo do të sigurojë edhe procesverbalin e Komitetit për Politikë dhe Financa, në të cilin, sipas saj, është ngritur qartë shqetësimi se kjo pikë nuk duhet të procedohet tutje. Ajo potencoi se edhe vetë drejtori, gjatë mbledhjes së Komitetit, ka deklaruar se ende nuk e ka konfirmimin nga zyra ligjore lidhur me çështjen e pronësisë. Më tej, ajo theksoi se në dokumentacion mungon edhe përcaktimi i destinimit të tokës nga drejtoria përkatëse e urbanizmit, në përputhje me planin zhvillimor komunal dhe hartën zonale komunale. Për këtë arsye, ajo kërkoi që e gjithë deklarata e saj të përfshihet në procesverbal. paralajmëroi se, nëse tentohet që përmes shumicës të anashkalohen dispozitat ligjore, ajo do t'u drejtohet organeve kompetente për të garantuar respektimin e ligjit dhe mbrojtjen e pasurisë publike. Gjithashtu, ajo theksoi se materiali i paraqitur në këtë seancë nuk u është dhënë anëtarëve në kohë të mjaftueshme për shqyrtim, duke shtuar se nuk kanë pasur as dhjetë minuta kohë për ta analizuar atë. Sipas saj, nëse ka pasur kërkesa shtesë nga ministria, materiali është dashur të kalojë sërish në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe t'u shpërndahet anëtarëve së paku shtatë ditë para mbajtjes së seancës, e jo në ditën e mbledhjes. Ajo përfundoi duke theksuar se në këtë mënyrë po vendosen para një akti të kryer dhe se po tentohet të procedohet materiali në moment të fundit, duke u mbështetur në shumicë. Në fund, ajo rikujtoi edhe një herë dispozitat e rregullores për dhënien në shfrytëzim, konkretisht nenin 6, i cili kërkon përcaktimin e destinimit të tokës. Kështu që këto janë ankesat e mia kryesore, vërejtjet e mia edhe ndryshe kërkoj me nënshkruar aty ku është vendi me nënshkruar në preambulë këtu se këtu realisht nuk po tingëllon edhe që është dokument zyrtar.

Kryesuesi i Kuvendit ndërhyri duke theksuar se, sa i përket materialit të paraqitur, bëhet fjalë për të njëjtin material si më parë, por të sistemuar në format Excel, duke shtuar se ndryshimi është vetëm teknik dhe se përmbajtja mbetet e njëjtë. Në vijim, Kryesuesi i Kuvendit i dha fjalën drejtorit përkatës.

Nazmi Kelmendi: Ai theksoi se është i gatshëm për debat, por fillimisht dëshiron të japë arsyetimin ligjor, duke pohuar se propozimi ka bazë ligjore dhe është në përputhje me legjisllacionin në fuqi. Pas kësaj, drejtori filloi paraqitjen e tij duke u drejtuar me fjalë përshëndetëse ndaj Kryesuesi i Kuvendit, kryetarit dhe anëtarëve të kuvendit komunal, si dhe të pranishmëve në sallë. Në vijim të fjalës së tij, ai theksoi se, në cilësinë e drejtorit përgjegjës për menaxhimin e pronës publike, po paraqet para asamblesë arsyetimin juridik dhe institucional lidhur me publikimin e të dhënave mbi pronat publike. Ai shtoi se publikimi i pronave publike bazohet drejtpërdrejt në parimet themelore të transparencës dhe llogaridhënies, të sanksionuara në legjisllacionin në fuqi. Në vijim të paraqitjes së tij, drejtori theksoi se institucionet publike kanë obligim ligjor për administrimin e pasurisë publike në mënyrë të hapur, duke raportuar para organeve më të larta vendimmarrëse, në këtë rast para Asamblesë Komunale. Ai shtoi se, në përputhje me dispozitat ligjore që rregullojnë pronën publike, çdo aset që është në pronësi apo shfrytëzim të komunës duhet të evidentohet, të regjistrohët dhe të përfshihet në raportime periodike, në funksion të transparencës dhe llogaridhënies. Gjatë diskutimit, drejtori theksoi se i gjithë procesi është zhvilluar në koordinim të plotë me sekretariatit e kuvendit dhe se ndryshimet e bëra në material janë të natyrës teknike, të cilat, sipas tij, kanë qenë të lejuara të bëhen deri në ditën e mbajtjes së seancës. Sa i përket konfirmimit ligjor, drejtori deklaroi se ka kërkuar një opinion nga zyra ligjore përmes postës elektronike, mirëpo nuk ka marrë përgjigje me shkrim. Ai shtoi se zyra ligjore ka shprehur qëndrim mosdakordues lidhur me një shkresë të adresuar nga kryetarët e komunave, duke e konsideruar atë si jo në përputhje me ligjin, por theksoi se kjo çështje nuk është thelbësore për diskutimin aktual. Në lidhje me destinimin e tokës, drejtori deklaroi se të gjitha parcelat kanë të përcaktuar zonën kadastrale, sipërfaqen dhe destinimin, bazuar në dokumentacionin e lëshuar nga drejtoria e urbanizmit.

Kryesuesi i Kuvendit sqaroi rregullat e zhvillimit të diskutimit, duke theksuar se çdo ndërhyrje duhet të bëhet përmes tij dhe se drejtorët nuk kanë obligim të përgjigjen në pyetje që nuk parashtrihen sipas procedurës së rregullt. Ai gjithashtu nënvizoi rëndësinë që të gjitha diskutimet dhe shqetësimet të regjistrohen në procesverbal, për arsye të transparencës dhe dokumentimit zyrtar, përndryshe nuk evidentohet diskutimi në procesverbal.

Shkëlqim Ibrahim Theksoi se nga deklaratimet e drejtorit rezulton se nuk ekziston konfirmimi i zyrës ligjore dhe se madje edhe MAPL i ka kthyer përgjigje negative. D.m.th sa i përket listës vlerësoi se kjo është e mjaftueshme që ne si kuvendarë të kërkojnë tërheqjen e kësaj pike nga rendi i ditës dhe plotësimin e dokumentacionit përkatës. Në vijim të diskutimit, theksoi se mungesa e opinionit të zyrës ligjore e vë në pikëpyetje ligjshmërinë e propozim-vendimit. Ai shtoi se, edhe pse është përmendur koordinimi me sekretariatën e kuvendit, një dokument i vlefshëm kërkon përfshirjen e disa komponentëve thelbësorë, ndër të cilët më i rëndësishmi është opinionimi i zyrës ligjore.

Kryesuesi për të orientuar diskutimin, theksoj se është e natyrshme që çdo drejtor, në përpjekje për të përgatitur një material sa më të plotë proceduralisht, të konsultohet me sekretariatën e kuvendit. Megjithatë, ai rikujtoi se ekziston edhe konkluzioni i Komitetit për Politikë dhe Financa, në të cilin kërkohet që propozim-vendimit t'i bashkëngjiten dokumentet përkatëse, përfshirë destinimin e pronës sipas planit zhvillimor komunal dhe hartës zonale, certifikatat e pronësisë dhe ortofotot, theksoi se këto kërkesa kanë qenë të qarta nga KPFkompletimin e lëndës para se ajo të procedohet në Kuvend. Ai gjithashtu vuri në dukje se nuk është kërkuar ndryshimi i përmbajtjes së materialit, përkatësisht i listës së pronave, por vetëm plotësimi i dokumentacionit. Në vijim, Kryesuesi i Kuvendit i dha fjalën kryetarit të komunës.

Kryetari i Komunës z. Faton Peci: Pasi falënderoi Kryesuesin, u shpreh se i bashkohet sugjerimit të tij dhe kërkoi fjalën për të dhënë disa sqarime. Ai theksoi se jeta institucionale është dinamike dhe se është e mundur që në rendin e ditës të futen edhe pika pa material të plotë, për të cilat më pas vendos vetë asambleja. Ai shtoi se kjo nuk nënkupton që çdo çështje duhet domosdoshmërisht të kalojë paraprakisht në KPF, duke bërë një analogji edhe me nivelin qendror të vendimmarrjes. Më tej, kryetari u shpreh pozitivisht për rolin e opozitës, duke theksuar se e vlerëson qasjen opozitare dhe ngritjen e çështjeve që synojnë përmirësimin e qeverisjes dhe rritjen e llogaridhënies. Megjithatë, ai shtoi se ndihet në njëfarë sikleti kur diskutohet për ndjeshmërinë ndaj pronës komunale, duke lënë të kuptohet se kjo çështje duhet parë edhe në një kontekst më të gjerë. Në vijim të fjalës së tij, kryetari përmendi se, sipas tij, ka pasur raste të shumta të keqpërdorimit të pronës komunale në të kaluarën, duke theksuar se në shumë lokacione në qytet, pronat komunale janë shfrytëzuar apo abuzuar për një periudhë të gjatë kohore. Ai nënvizoi se qëllimi i institucioneve është që çdo pronë komunale të ketë një destinim të qartë në interes publik dhe se në të ardhmen do të punohet që këto pasuri të menaxhohen në mënyrë të rregullt dhe në përputhje me interesin e qytetarëve. Në vijim të fjalës së tij, kryetari theksoi se të gjithë ata që kanë shfrytëzuar pronën komunale në mënyrë të rregullt dhe në përputhje me kontratat do të obligohen që t'i përmbushin të gjitha detyrimet kontraktuale, ndërsa për rastet e uzurpimeve u shpreh se nuk do të tolerohen dhe do të ndërmerren masa përkatëse. Ai shtoi se kjo qasje synon të forcojë përgjegjësinë institucionale në trajtimin e pronës komunale dhe të sigurojë menaxhim më të drejtë dhe në interes publik. Lista e propozuar e pronave nuk ka karakter përfundimtar për dhënie në shfrytëzim, por paraqet një obligim ligjor për evidencimin e pronave potenciale që mund të jepen në shfrytëzim. Ai sqaroi se përfshirja e parcelave në këtë listë nuk nënkupton automatikisht se ato do të jepen në shfrytëzim, pasi secila prej tyre do t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme dhe vendimmarrjes përkatëse. Më tej, kryetari theksoi se në baza ditore pranon kërkesa dhe interesim nga afaristë, biznesmenë dhe përfaqësues të mërgatës për investime në komunë. Ai u shpreh se mbështet një qasje pragmatike që synon krijimin e hapësirave për sektorin privat, me qëllim të zhvillimit ekonomik të komunës. Në vazhdim, ai paraqiti disa të dhëna lidhur me gjendjen ekonomike në komunë, duke theksuar se, sipas analizave të fundit, niveli i aktivitetit ekonomik në Mitrovicën e Jugut është më i ulët krahasuar me mesataren e komunave

të tjera në Kosovë. Ai përmendi se gjatë vitit 2024, qarkullimi i sektorit privat në këtë komunë ka arritur rreth 391 milionë € duke e cilësuar këtë si tregues të një performance ekonomike që kërkon përmirësim. Në këtë kontekst, kryetari bëri thirrje për reflektim dhe angazhim më të madh institucional, duke theksuar nevojën që të gjithë akterët të jenë në nivel të detyrës për të përmirësuar gjendjen ekonomike dhe për të nxitur zhvillimin lokal. Në vijim të fjalës së tij, kryetari bëri një krahasim të gjendjes ekonomike ndërmjet komunave, duke theksuar se ekziston një dallim i madh në nivelin e aktivitetit ekonomik. Ai përmendi se ndërsa disa komuna arrijnë qarkullim prej rreth 8.8 miliardë € në vit, komuna e Mitrovicës ka arritur rreth 391 milionë € gjatë vitit 2024. Në këtë kontekst, ai ngriti çështjen e rolit të komunës dhe të asamblesë në përmirësimin e kësaj gjendjeje, duke theksuar se një nga mënyrat kryesore është menaxhimi më i mirë i pronës komunale dhe dhënia e saj në shfrytëzim në mënyrë të rregullt dhe transparente. Sipas tij, kjo do të ndikonte në rritjen e investimeve, krijimin e vendeve të reja të punës, rritjen e të hyrave komunale dhe forcimin e bazës tatimore. Kryetari theksoi gjithashtu se lista e pronave ka karakter potencial dhe se qëllimi i saj është të identifikojë mundësitë për investim. Ai u shpreh se çdo investitor i interesuar duhet të mirëpritet dhe t'i ofrohet mundësia për të investuar, në mënyrë që të kontribuohet në zhvillimin ekonomik të komunës.

Në përfundim të fjalës së tij, ai rikujtoi se gjatë fushatës zgjedhore ka propozuar ndarjen e drejtorisë së pronës si një mekanizëm për përmirësimin e menaxhimit dhe rritjen e përgjegjshmërisë në administrimin e pasurisë publike.

Shkëlqim Ibrahim: Meqenëse kryetari tha se materialet mund të procedohen edhe pa konfirmim të zyrës ligjore, vetëm po ja ua rikujtoj se praktika e mëparshme ka qenë që asnjë akt normativ apo dokument i rëndësishëm nuk është miratuar pa një opinion të tillë. Ai vlerësoi se kjo praktikë nuk duhet të ndryshohet. Ai shtoi se, ndonëse është i hapur për kompromis, konsideron se disa nga deklaratimet e bëra gjatë diskutimit përbëjnë akuza të rënda, veçanërisht ato që lidhen me keqpërdorimin e pronës komunale. Në këtë drejtim, ai kërkoi që, nëse ekzistojnë dyshime të tilla, ato të adresohen në organet kompetente për hetim. Në fund, ai ngriti një pyetje thelbësore lidhur me rolin e zyrës ligjore, duke theksuar se nëse shpërfillet opinioni i saj, atëherë vihet në pikëpyetje vetë funksioni dhe ekzistenca e kësaj zyre në kuadër të institucionit. Në vijim të diskutimit, ritheksoi se në rastet kur ngrihen akuza për keqpërdorim të pronës komunale, ato duhet të trajtohen në përputhje me detyrimet ligjore dhe të adresohen në organet kompetente përkatëse.

Igballe Islami: Çështja në diskutim nuk ka të bëjë me debat politik, por me dhënien në shfrytëzim të pasurisë komunale, e cila kërkon trajtim të kujdesshëm dhe në përputhje me ligjin. Ai kundërshtoi deklaratimin se ndryshimet në material janë të natyrës teknike, duke argumentuar se ndryshimi i afatit të dhënies në shfrytëzim nga afatgjatë në afatshkurtër nuk mund të konsiderohet ndryshim teknik. Gjithashtu, ai theksoi se nuk është ndryshim teknik as zëvendësimi i parcelave të miratuara në Komitet me parcela të tjera, si dhe shtimi i tetë parcelave të reja që nuk kanë qenë pjesë e shqyrtimit në KPF. Ajo shtoi se, ndonëse në disa raste mund të procedohen materiale drejtpërdrejt në Kuvend, kjo zakonisht vlen për çështje të tjera, siç janë formimi i komisioneve, dhe jo për çështje që lidhen me dhënien në shfrytëzim të pronës komunale. Në vijim, ajo shprehu shqetësimin e tij duke theksuar se shpreson që ndryshimet në material nuk janë ndikuar nga grupe interesi, veçanërisht duke marrë parasysh përfshirjen e një sipërfaqeje prej rreth 420,000 m² në këtë proces. Ai rikujtoi gjithashtu se materiali thirret në dispozitat e rregullores për dhënien në shfrytëzim, konkretisht në nenin 6, dhe ngriti shqetësimin se mungesa e destinimit të tokës nga drejtoria e urbanizmit përbën shkelje të kësaj rregulloreje. Ai përfundoi duke theksuar se, nëse ekziston dokumentacioni i plotë, është i gatshëm të mbështesë propozimin.

Valon Brahim: Udhëzimit administrativ e rregullon hartimin e akteve dhe propozim-vendimeve për komunat, duke theksuar se në këtë udhëzim parashihet qartë roli aktiv i zyrës ligjore në çdo fazë të procesit, nga inicimi deri në paraqitjen në Kuvend. Sipas këtij udhëzimi, propozim-vendimi duhet të shoqërohet me opinion pozitiv të zyrës ligjore para se të procedohet në KPF dhe më pas në Kuvend. Në vijim, sqaroi se, ndonëse ekzistojnë raste kur mund të procedohen vendime pa kaluar në Komitet, natyra

e çështjes në fjalë që lidhet me pronën komunale dhe aspektet pasurore-juridike e bën të domosdoshëm kalimin nëpër KPF. Qëllimi nuk është pengimi i procesit apo i zhvillimit ekonomik, duke pranuar se bizneset kanë nevojë për mbështetje dhe se gjendja ekonomike në komunë është e vështirë, por kërkesa kryesore është që dokumentacioni të jetë i plotë dhe në përputhje me kriteret formale dhe ligjore. Po ashtu theksojse mungesa e konfirmimit nga zyra ligjore nënkupton se kriteret formale juridike nuk janë përmbushur. Ai gjithashtu reagoi ndaj deklarimeve për uzurpimin e pronave komunale në të kaluarën, duke kërkuar që të jepen shembuj konkretë për raste të tilla. Pra duhet të bëhet e qartë për qytetarët periudha kohore e rasteve të pretenduara të uzurpimit të pronës komunale, duke kërkuar që të mos paraqiten informacione të pasakta lidhur me kohën dhe përgjegjësitë institucionale në periudha të ndryshme qeverisëse. Ai deklaroi se nuk synon të amnistojë askënd dhe se çdo rast i uzurpimit të pronës publike duhet të trajtohet sipas ligjit, pavarësisht periudhës kur ka ndodhur. Në këtë kontekst, ai theksoi se çdo listë e pronave duhet të paraqitet në përputhje me ligjin dhe se Kuvendi duhet të votojë vetëm dokumente që janë në përputhje të plotë me procedurat ligjore. Anëtar i shtoi se gjatë shqyrtimit të këtij materiali janë bërë disa vërejtje në mbledhjet e mëparshme të KPF dhe se ato, sipas tij, nuk janë marrë parasysh në mënyrë të plotë. Ai theksoi gjithashtu nevojën për përmirësim të dokumentacionit dhe shmangie të përshpejtimit të procedurave pa përmbushur standardet e kërkuara. Në vijim, ai ngriti shqetësime edhe lidhur me rolin e sekretariatit të Kuvendit dhe zbatimin e rregullores, duke theksuar se stafi profesional ka përgjegjësi në garantimin e procedurave të sakta administrative dhe ligjore. Ai shtoi se çdo tentativë për të kaluar materiale që nuk janë në përputhje me ligjin nuk duhet të pranohet nga Kuvendi. Më tej, ai theksoi se Kuvendi nuk duhet të vendoset para situatave të përshpejtuara apo të paplota dhe se çdo vendim duhet të jetë i bazuar në dokumentacion të plotë dhe të verifikuar.

Kryetari i Komunës z. Faton Peci: E pranoj diskutimin tuaj z. Brahimi duke vlerësuar se diskutimi ishte i sqartë, por njëkohësisht ngriti shqetësime lidhur me funksionimin e strukturave profesionale brenda administratës komunale, duke theksuar se nëse gjatë periudhave të mëparshme ka pasur njohuri për raste të uzurpimit të pronës, atëherë është dashur të ndërmerren veprime konkrete institucionale në përputhje me kompetencat ligjore, pronës komunale edhe nuk e ke ndërmarrë asnjë veprim që kjo është shumë problem i madh për ty. A diskutimi juaj unë vlerësoj që është i sqartë? E para. Në vijim të diskutimit, kryetari theksoi se është paraqitur para qytetarëve dhe ka marrë besimin e tyre, duke shtuar se përgjegjësinë për mandatin e ushtron në mënyrë të plotë dhe se vlerësimin për punën e tij do ta japin qytetarët në fund të mandatit. Ai deklaroi se gjatë analizave të kryera nga administrata komunale ekzistojnë raste të ndryshme të pronave të uzurpuara ndër vite, duke përmendur se një pjesë e konsiderueshme e këtyre rasteve i takojnë periudhave të mëhershme qeverisëse. Në këtë kontekst, ai theksoi se në evidencat aktuale ekzistojnë raste të uzurpimeve të pronës komunale gjatë periudhës 2009–2013, të cilat sipas tij përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të problemeve të trashëguara. Më tej, kryetari përmendi raste konkrete që, sipas tij, lidhen me mosinkasim të të hyrave komunale dhe mosrespektim të detyrimeve kontraktuale, duke theksuar se ka pasur prona komunale të dhëna në shfrytëzim pa pagesë të rregullt të obligimeve ndaj komunës. Në vijim, ai vlerësoi diskutimin e mëhershëm si të sqartë, por shtoi se disa nga pretendimet e ngritura reflektojnë situata që lidhen edhe me mosveprim institucional në të kaluarën. Ai theksoi se, sipas tij, mosveprimi institucional gjithashtu mund të përbëjë shkelje ligjore në kuadër të dispozitave përkatëse.

Valon Brahimi: Deklaroi se ka keqkuptim në interpretimin e deklarimeve të tij dhe sqaroi se pronat për të cilat është referuar nuk kanë qenë të uzurpuara në kuptimin e drejtpërdrejtë, por se kanë ekzistuar çështje të tjera lidhur me shfrytëzimin dhe mosrespektimin e detyrimeve financiare ndaj komunës. Ai shtoi se këto situata, sipas tij, kanë ndodhur gjatë periudhave të mëhershme qeverisëse dhe nuk lidhen me administratën aktuale. Gjithashtu, ai theksoi se nuk ka synim të mbrojtjes apo të akuzojë persona apo subjekte politike, por të trajtojë çështjen në aspekt profesional dhe institucional. Në vijim, ai vlerësoi se menaxhimi i pronës komunale është kompetencë e drejtorive përkatëse, duke përmendur drejtorinë e urbanizmit dhe atë të kadastrit si institucione përgjegjëse, e jo drejtoria e inspeksionit. Ai shtoi se gjatë

periudhës së tij të angazhimit janë liruar një numër i konsiderueshëm i pronave publike komunale dhe se për këtë ekzistojnë raporte përkatëse që mund të vihen në dispozicion. Në fund, ai bëri një krahasim lidhur me zhvendosjen e objekteve të përkohshme (kioskeve), duke theksuar se jo çdo zhvendosje përbën përmirësim të situatës së pronës publike nëse nuk respektohet destinimi dhe planifikimi urbanistic të pronës publike, ke qit në pronë publike? Po ju sugjeroj që në bashkëpunim me drejtorinë e urbanizmit ju tregoj që pronat komunale dhe objektet e banimit është kompetencë e drejtorisë së urbanizmit dhe e inspeksionit, duke sqaruar se këto institucione veprojnë në faza të ndryshme të procedurës administrative. Ai shtoi se, në rastet kur nuk respektohen kontratat apo detyrimet e shfrytëzimit, institucionet përkatëse kanë obligim të ndërmarrin veprimet e nevojshme sipas kompetencave ligjore.

Gjatë diskutimit, pati ndërhyrje dhe replika ndërmjet pjesëmarrësve, ku u ngritën akuza dhe kundërpërgjigje lidhur me kompetencat institucionale, menaxhimin e pronës komunale dhe përgjegjësinë për veprim apo mosveprim në raste të caktuara. Për shkak të ndërprerjeve dhe debatit të zhvilluar jashtë rregullave të diskutimit, Kryesuesi i Kuvendit ndërhyri disa herë duke kërkuar ruajtjen e rendit dhe respektimin e rregullores së punës së Kuvendit. Kryesuesi i Kuvendit rikujtoi rregulloren e punës së Kuvendit, duke theksuar se secili anëtar i Kuvendit ka të drejtë të flasë deri në pesë (5) minuta për një çështje të caktuar, ndërsa në rast të paraqitjes në emër të grupit parlamentar, koha mund të jetë deri në tetë (8) minuta. Ai gjithashtu sqaroi se replika për të njëjtën çështje kufizohet në dy (2) minuta për secilin anëtar. Po ashtu theksoi se disa prej pjesëmarrësve e kanë tejkaluar kohën e paraparë për diskutim dhe se diskutimet që zhvillohen jashtë procedurës nuk mund të përfshihen në procesverbal apo në incizimin zyrtar të seancës. Ai kërkoi që diskutimet të përqendrohen dhe të rrumbullakësohen, në mënyrë që seanca të vazhdojë sipas rendit të ditës dhe rregullores së punës.

Valon Brahim: Kryetar, ne i kemi liruar 35 prona publike, ndërsa drejtorit aktual dhe juve po ju vihet fjala ngushtë. A e jepni fjalën që, nëse ajo është ndërtua brenda mandatit tuaj, unë do të jap dorëheqje; por nëse nuk është ndërtua, atëherë ju do të jepni dorëheqje?

Ardian Kavaja: Theksoi se çështja e paraqitur lidhet me shqetësime të ngritura nga disa anëtarë të Kuvendit, veçanërisht sa i përket destinimit të pronave, ortofotove dhe aspektit të ligjshmërisë së materialit të paraqitur. Ai sqaroi se, sipas informacioneve të tij, nuk ka pasur kundërshtime sa i përket aspektit të zyrës ligjore në vetvete, duke theksuar se institucionet komunale nuk do të procedonin materiale në Kuvend jashtë kornizës ligjore. Gjithashtu, ai deklaroi se një nga shqetësimet ka qenë afati kohor i dhënies së pronave në shfrytëzim, i cili sipas tij është përcaktuar deri më 31 dhjetor, dhe se ky afat është diskutuar edhe me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal. Ai shtoi se gjatë komunikimeve me Ministrinë janë marrë udhëzime dhe kritere lidhur me mënyrën e përgatitjes së dokumentacionit, përfshirë edhe përcaktimin e destinimit të pronave, i cili sipas tij është përfshirë në materialin e dorëzuar. Sa i përket ortofotove, ai sqaroi se bëhet fjalë për rreth 70 parcela dhe se dokumentacioni përkatës është përgatitur për secilën prej tyre. Ai pranoi se mund të ketë pasur vështirësi teknike në formatin e paraqitjes së tyre, por theksoi se qëllimi ka qenë përmbushja e kërkesave procedurale. Në fund, ai theksoi se sipas tij, destinimi i pronave, ortofotot dhe konsultimet me Ministrinë janë përfshirë në përputhje me kërkesat procedurale dhe se nuk sheh shkelje në materialin e paraqitur.

Nënkryetari i Komunës z. Enis Osmani: Sa i përket afatit për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale, ai ka qenë deri më 31 dhjetor, për shkak të zgjedhjeve dhe disa kryetarëve të rinj. MAPL ka marrë vendim që ky afat të shtyhet deri më 31 mars. I vetmi shqetësim i zyrës ligjore në komunën e Mitrovicës ka qenë nëse kjo ka qenë në përputhje me kompetencat, por Ministria e ka marrë këtë vendim. Ministri e ka nënshkruar dhe vlen për të gjitha komunat e Kosovës, jo vetëm për Mitrovicën, që kanë afat deri më 31 mars për ta aprovuar këtë listë. Pra, i vetmi shqetësim i zyrës ligjore ka qenë ky. Nuk ka asnjë shqetësim tjetër. Nëse dikush ka paqartësi lidhur me këtë çështje, kjo është e vetmja. Nuk ka diçka tjetër.

Artan Berisha: Materialet e paraqitura duhet të jenë të kompletuara me destinimin e pronës, duke vlerësuar se mungesa e këtij elementi përbën mangësi procedurale në dokumentacion. Ai gjithashtu ngriti

shqetësim lidhur me ndryshimet në numrin e parcelave krahasuar me versionin e shqyrtuar në KPF, duke kërkuar sqarime shtesë për këto ndryshime. Në vijim, ai kërkoj sqarime edhe lidhur me një parcelë të propozuar për dhënie në shfrytëzim që lidhet me objektin e Shtëpisë së Shëndetit, duke kërkuar qartësi nëse propozimi përfshin vetëm parcelën apo edhe objektin ekzistues.

Kushtrim Zeneli: Pavarësisht debatit të zhvilluar rreth pronave, komuna ka ndërmarrë veprime për lirim të hapësirave publike dhe adresimin e rasteve të uzurpimeve, të cilat sipas tij janë çështje të trashëguara nga periudhat e mëhershme dhe unë si asambleist po them nuk është dashur të lejohet të vije deti këtu. Ai shtoi se materialet që lidhen me pronat duhet të trajtohen në mënyrë më të detajuar në bashkëpunim me drejtoritë përkatëse, përfshirë drejtorinë e inspeksionit dhe atë të urbanizmit, në mënyrë që të shmangen paqartësitë dhe interpretimet e ndryshme gjatë shqyrtimit në Kuvend. Gjithashtu, ai theksoi se gjatë shqyrtimit të pikës së rendit të ditës, diskutimet duhet të përqendrohen në përmbajtjen e materialit dhe jo të devijojnë në interpretime personale apo përmendje të individëve, duke kërkuar që debati të mbetet brenda kornizës institucionale. Në fund, ai deklaroi se vota e tij për këtë pikë do të bazohet në argumentet dhe përmbajtjen e materialit të paraqitur në Kuvend. Po ashtu theksoi se vota e tij për pikën në fjalë do të bazohet në përmbajtjen e materialit dhe në mënyrën se si ai është përgatitur, duke shtuar se është e rëndësishme të shmangen dezinformatat dhe interpretimet e pasakta që mund të ndikojnë në opinionin publik. Ai u ndërlidh me diskutimet e mëhershme lidhur me interpretimet ligjore, duke theksuar se sipas tij, dokumentacioni dhe rekomandimet e kërkuara nga KPF përfshijnë edhe destinimin e tokës, planifikimin urbanistik dhe interpretimin ligjor përkatës. Ai shtoi se, sipas informacioneve të paraqitura në seancë, MAPL ka dhënë udhëzime lidhur me afatet për miratimin e listave, të cilat janë të zbatueshme për të gjitha komunat. Gjithashtu, ai ngriti pyetje lidhur me pasojat eventuale në rast se dokumenti apo lista e paraqitur do të rezultonte me gabime, duke kërkuar sqarime për procedurat që do të ndiqen në rast të konstatimit të pasaktësive pas miratimit. Ai theksoi se, sipas tij, procedura e miratimit dhe më pas verifikimi nga niveli qendror (MAPL) kontribuon në rritjen e transparencës dhe sigurisë ligjore të procesit.

Artan Berisha: Sa i përket kësaj çështje në të kaluarën materialet gjithnjë kanë ardhur të përgatitura me destinime e me të gjitha. Sipas vlerësimit tim personal, kjo nuk i plotëson kushtet. Unë votoj mbi bazën e bindjes sime dhe në këtë rast kam dyshime. Ka pasur raste të tjera që janë trajtuar ndryshe, ndërsa kjo po vjen pa konfirmim të qartë. Po ashtu te shtëpia e shëndetit, kam nevojë për sqarime shtesë. I nderuari drejtor, si është paraparë kjo çështje: a bëhet fjalë për dhënie me objekt apo pa objekt? Cili është destinimi konkret i pronës? Pa këto sqarime, është e vështirë të merret një vendim i bazuar.

Kryesuesi i Kuvendit: Atëherë, mendoj se është e nevojshme të sqarohet disa çështje që u ngritën, sidomos lidhur me rolin e sekretarisë. Së pari, besoj se edhe ju që keni qenë më herët në këtë kuvend e dini që sekretaria nuk e ka për obligim të hartojë propozim-vendimet e drejtorive apo të kryetarit. Të gjitha propozim-vendimet vijnë nga drejtoritë, përkatësisht nga ekzekutivi, dhe pastaj i përcillen sekretarisë. Sekretaria i përpunon në aspektin procedural dhe, bashkë me kryetarin, i vendosim në rend të ditës dhe i procedojmë për shqyrtim.

Kryesuesi i Kuvendit: Pra, sekretaria nuk është përgjegjëse për përmbajtjen e propozim-vendimeve të ekzekutivit, rendine ditës e caktojme unë dhe kryetari i komunës. Së dyti, sa i përket çështjes së ligjshmërisë: është e vërtetë që është praktikë e mirë të ketë një konfirmim nga zyra ligjore, por kjo nuk është obligim ligjor për kuvendin. Vendimet e kuvendit, si vendime kolegjiale, i nënshtrohen kontrollit të ligjshmërisë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe, sipas rastit, edhe nga ministri të tjera përkatëse. Zyra ligjore mund të japë rekomandime dhe ndihmon sidomos kryetarin në vendimmarrje, por për kuvendin kjo nuk është kusht i detyrueshëm. Procedura është e qartë: lënda përgatitet, vjen në kuvend, shqyrtohet, jepen vërejtje, votohet ose jo, dhe pastaj dërgohet për vlerësim të ligjshmërisë në ministri. Në fund, ministria është ajo që e konfirmon ose e kthen vendimin, nëse ka shkelje. Ka pasur edhe raste kur vendimet janë kontestuar dhe çështjet kanë përfunduar deri në Gjykatën Kushtetuese. Prandaj, sa i përket kësaj pjese, nuk duhet të ketë shqetësim të madh. Vërejtjet janë të

mirëseardhura dhe të nevojshme, por nëse ka ndonjë shkelje procedurale, ministria do ta kthejë vendimin për rishqyrtim. Gjithashtu, duhet të kemi parasysh afatin – jemi në fund të muajit dhe kemi kohë deri më 31 mars për ta aprovuar listën. Në fund, nëse një vendim refuzohet nga ministria, atëherë përgjegjësia bie mbi ekzekutivin. Ne si kuvend po e kryejmë obligimin tonë dhe jemi në rregull me procedurën tonë.

Igballe Islami: Vetëm, të lutem, para se të shkojmë në votim, drejtori i drejtorisë duhet të na japë përgjigje të sakta: pse ka ndryshuar parcela dhe pse janë shtuar parcela që nuk kanë qenë pjesë e mëhershme? Gjithashtu, materiali që do të dërgohet në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal nuk duhet të jetë i ndryshuar nga ai që kemi sot para vetes. Nuk duhet që në ministri të dërgohet një version tjetër i materialit, por i njëjti që është shqyrtuar këtu në Asamblenë Komunale. Unë nuk e kam parë të përcaktuar qartë destinimin e pronës pa u shqyrtuar nga asambleja. Prandaj, i njëjti material duhet të shkojë në ministri pa ndryshime. Duhet të ndjekim procedurën e ligjshmërisë deri në fund. Pra, materiali që shkon për shqyrtim në MAPL duhet të jetë identik me atë që është trajtuar në Asamblenë Komunale.

Kryesuesi i Kuvendit dha një sqarim se materialin e ka marrë ministria. Domethënë, ashtu siç e keni pranuar ju materialin për Kuvend, e njëjta dosje i është dërguar edhe ministrisë. Ne kemi për detyrë vetëm ta përcjellim vendimin e Kuvendit, i cili pastaj i nënshtrohet procedurës së ligjshmërisë. Materiali, përkatësisht dosja e plotë, tashmë është në ministri, sepse kjo është praktikë standarde.

Jeton Ujkani: Është debatuar goxha gjatë dhe është një pikë me rëndësi, duke qenë se po shihet që kemi afat deri më datën 31 dhe nuk kemi mundësi tjetër për ta shtyrë këtë pikë, unë do të propozoj që pika të kalojë. Pastaj, pas konfirmimit të ligjshmërisë nga MAPL, ata do të vendosin nëse çdo gjë është në rregull, nëse është në rregull, vazhdojmë tutje, nëse jo, atëherë procedohet sipas ligjit. Gjithashtu, edhe për pronat specifike, secila pronë që do të shpallet për dhënie në shfrytëzim do të vijë sërish në Kuvend për votim dhe në atë fazë kemi mundësi t'i shqyrtojmë në mënyrë më të detajuar dhe të dimë saktësisht për secilën pronë. Prandaj, unë propozoj që pika të kalojë.

Erseka Barani: Realisht, u shterën të gjitha diskutimet. Unë e kërkoja fjalën më herët për të dhënë një sqarim se pse ka ndodhur që ky dokument ka ligjshmëri. Kjo ka ndodhur pikërisht për shkak se ministria ka nxjerrë një dokument tjetër. Kërkoj nga drejtori, nëse është e mundur, që t'ua paraqesë edhe asamblistëve këtë dokument, për t'ju treguar se ka qenë vendim i ministrisë. Unë mendoj se kjo është e rregulluar edhe me Ligjin nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronave, neni 10, ku përcaktohen kufizimet e komunës. Në momentin që presidenti apo presidentja shpall zgjedhjet, automatikisht komuna nuk mund të japë prona në shfrytëzim. Kjo ka vlejtur për të gjitha komunat dhe ka ardhur në fillim të janarit. Edhe në praktikat e mëherëshme ka pasur raste që nuk ka qenë konfirmimi ligjor dhe ne si asamblistë konstruktivë jemi munduar që asnjëherë të mos bllokojmë komunën dhe proceset e saj, qoftë në aspektin ekonomik apo shoqëror. Prandaj mendoj se konstruktiviteti ynë ka treguar se, edhe kur ligjshmëria nuk ka qenë e plotë, ne kemi pasur besim në një organ më të lartë, siç është ministria, e cila e ka kthyer ose konfirmuar ligjshmërinë, dhe nuk ka pasur nevojë të bllokohen proceset në kuvend. I ftoj të gjithë kolegët asamblistë që ta votojmë këtë listë të pronave, duke e plotësuar me dokumentacionin që u kërkua. Pajtohem plotësisht që të shtohet edhe destinimi në dokument. Kjo të bëhet deri në fund të seancës dhe pastaj ne si Kuvend ta votojmë, duke i bashkëngjitur të gjitha dokumentet e nevojshme.

Xhylljeta Imeri: Unë pajtohem me shumicën e kërkesave dhe kritikave të kolegëve paraprakë, por mendoj se ky vendim, pasi të shkojë në MAPL dhe të konfirmohet ligjshmëria e tij, duhet të përkrahet në këtë fazë. Më pas, kur të vijë secila pronë veç e veç, atëherë do të vendosim dhe do ta shqyrtojmë deri në fund, duke marrë vendimet më të mira për qytetarët.

Visar Sylja: Të gjithë i kemi secili vërejtjet dhe sugjerimet tona, por siç tha edhe Kryesuesi i Kuvendit, në fund vlerësimi i ligjshmërisë bëhet nga MAPL-ja. Unë besoj se zyra ligjore nuk është më kompetente sesa vlerësimi që i bëhet ligjshmërisë nga MAPL-ja. Prandaj, mendoj se është mirë të vazhdojmë, pa e shtyrë as për fund të seancës dhe as për seancë tjetër. Është më mirë të vazhdojmë me pikën dhe ta kalojmë, pa e shtuar dokumentacion të ri në këtë fazë.

Igballe Islami: Fillimisht, sa herë që po kalojmë në akte aktuale dhe po bëjmë ndërlidhje me të kaluarën me qëllim që të legjitimohet e tashmja, për mua kjo duket e pakuptimtë. Unë kam respekt për të gjithë, edhe kemi bashkëpunuar mirë gjatë gjithë mandatit, si në opozitë ashtu edhe tani. Por në momentin kur thuhet se “ne nuk e kemi pasur”, unë po kërkoj thjesht sqarim: sot po kërkohet që të bashkëngjitet i njëjti material që dikush tjetër mund ta ketë kërkuar edhe më herët, kur ka qenë në opozitë. Materialin që unë e kam marrë, e kam marrë rastësisht përmes emailit zyrtar të komunës. Meqenëse drejtorja që unë e kam menaxhuar nuk ka pasur të bëjë drejtpërdrejt me këto prona, e kam marrë vetëm për ta parë si është formati kur kalon një lëndë dhe për ta krahasuar me materialin që kemi sot. Sa i përket ligjshmërisë, nuk po them që nuk duhet të shkojë në MAPL për vlerësim, por për mua është e rëndësishme që të ketë të paktën destinimi i tokës, sepse kjo është kusht kryesor dhe është e përcaktuar edhe me rregullore komunale. Nuk po e kontestoj që ligjshmëria vendoset nga një akt më i lartë, dhe jam plotësisht dakord që MAPL-ja e bën vlerësimin. Ajo që po kërkoj unë është vetëm respektimi i procedurës dhe qartësimi i destinimit të tokës, pasi nëse kjo nuk specifikohet, mund të ketë shkelje të rregullores komunale. Sa i përket zyrës ligjore, konsideroj që përgjegjësia për sqarime dhe përgatitje është e drejtorisë përkatëse.

Valon Brahim: Po ndalem prapë te kjo çështje. Ne nuk jemi për ta penguar procesin, por po kërkojmë që gjithçka të jetë procedurale dhe ligjërisht e rregullt. Statusi i Shtëpisë së Shëndetit nuk është i definuar qartë. Ajo aktualisht figuron si institucion shëndetësor, ndërsa këtu është përfshirë në listën e pronave për dhënie në shfrytëzim. Së pari duhet të definohet statusi i saj: a duhet të rrënohet apo jo, dhe pastaj të vendoset për destinimin e saj. Nuk mund të vendoset për dhënie në shfrytëzim pa u sqaruar paraprakisht statusi i objektit. Është sikur të merret një objekt që është ende funksional si institucion shëndetësor dhe të futet në listë për shfrytëzim pa u bërë ndryshimet e nevojshme paraprake.

Shkëlqim Ibrahim: Fillimisht po e minimizojmë rolin e zyrës ligjore, por për shkak të afateve ligjore propozoj që deri në fund të seancës, pasi tash është edhe ditë e xhuma dhe kemi pushim, të bashkëngjitet lista e destinimit për secilën pronë. Së bashku me të, të bashkëngjitet edhe emaili zyrtar dhe dokumenti zyrtar që ka ardhur nga ministria. Këto po i bëjmë në shenjë respekti për institucionin, pasi kemi konsideratë për të.

Kryesuesi i Kuvendit kërkon falje që po e ndërpreu mirëpo thekson, se e kam një pyetje për sqarim, për të gjithë: për çfarë bëhet fjalë saktësisht në këtë rast për çfarë emaili është fjala?

Shkëlqim Ibrahim: Kryetari dhe nënkryetari e dinë dhe mund ta arsyetojnë pse nuk është përfunduar deri më 31 dhjetor, por afati ligjor është vazhduar deri më 31 mars, kërkoj që ky material të bashkëngjitet si shenjë respekti për secilin asamblist këtu që e ka kërkuar si dokument. Gjithashtu, kam një këshillë miqësore për drejtorin sa i përket Shtëpisë së Shëndetit: të konsultohemi pak me programin (NGAP) dhe premtimet që i ka bërë kryetari. Mendoj që kjo pronë duhet të hiqet nga lista për momentin, sepse është premtuar që ajo pjesë do të shndërrohet në hapësirë gjelbëruese dhe disa parkingje të vogla, jo nën tokësore apo mbi tokësore. Prandaj, do të ishte mirë të konsultohemi dhe ta ruajnë edhe aspektin e performancës.

Kryesuesi i Kuvendit: Atëherë e hedh në votim Propozim vendimin për miratim të vendimit paraprak për publikim të listës së përgjithshme të pronave të paluajtshme të komunës si dhe listën e veçantë të pronave të cilat planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2026 me vërejtjet dhe sugjerimet e paraqitura, të miratohet si e tillë, duke përfshirë edhe bashkëngjitjen e dokumenteve për destinimin e pronave dhe shkresën nga MAPL?

Rezultati i votimit: 16 për, 10 kundër dhe 2 abstenime.

Kryesuesi konstatoj se me shumicë votash miratohet vendimi për miratim të vendimit paraprak për publikim të listës së përgjithshme të pronave të paluajtshme të komunës si dhe listën e veçantë të pronave të cilat planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2026.

Kryesuesi Atëherë meqenëse është edhe vakti i xhumasë dhe ka kërkesa nga anëtarët e Kuvendit shkojmë në pauzë deri në ora 13:00.

Pauza: 11:40

Fillon: 13:15

Pika 3

Kryesuesi i Kuvendit konsataton se ka kuorum, në sallë janë të pranishëm me 26 anëtarë të Kuvendit.

Shkëlqim Ibrahim: Kam një vërejtje lidhur me mbarëvajtjen e seancës aktuale. Kërkoj si kryesues, por edhe nga kryetari dhe çdo anëtar i Kuvendit, që të dënohet gjuha denigruese dhe bullizuese. Kryetari, realisht, më është drejtuar në një mënyrë që unë e kam konsideruar të panevojshme. Ne si grup parlamentar gjithmonë kemi qenë të kujdesshëm dhe nuk kemi përdorur fjalë si “hajn”, “i korruptuar” apo akuza të tilla. Gjithmonë jemi drejtuar me respekt ndaj secilit këtu. Prandaj, në të ardhmen, kërkoj që të ketë kujdes më të madh në gjuhën që përdoret në Kuvend. Unë jam Shkëlqim Ibrahim dhe kam rreth 770 vota në historikun e zgjedhjeve në Mitrovicë. Çdo person këtu, pavarësisht pozitës, duhet të ketë përgjegjësi në komunikim qoftë kryetari, nënkryetari, drejtorët apo asamblistët dhe të respektohet kodi i etikës dhe komunikimi institucional. Gjithashtu, do të ishte mirë që kjo çështje të përcillet edhe më tej dhe të kërkohet një lloj sqarimi apo edhe faljeje, sepse përdorimi i shprehjeve të tilla mund të keqkuptohet dhe të ketë ndikim negativ. Në fund, ju lus që gjithmonë të dënohet gjuha denigruese dhe bullizuese në Kuvend.

Kryesuesi i Kuvendit: Absolutisht pajtohem me ty. Nuk ka nevojë të shkohet në ofendime ndaj askujt, duhet të ruhet respekti në komunikim edhe unë pajtohem plotësisht me këtë çështje. Atëherë kalojmë te pika e radhës së rendit të ditës: Propozim-vendim për lejimin e mjeteve financiare për trajtim mjekësor jashtë vendit për znj. Elona Brahimi. Ju paraprakisht e keni edhe materialin. Dihet se kjo çështje është iniciuar fillimisht nga z. Shkëlqimi Ibrahim në Kuvend, pastaj është orientuar si lëndë në Sekretarinë e Kuvendit, ku ne e kemi përcjellë te Drejtoria përkatëse dhe kështu ka vazhduar procedura. Tani lënda ka ardhur në Kuvend për miratim. Fillimisht ka qenë e planifikuar me kërkesë për 5,000€, ndërsa më pas është rritur në 6,000€ si mbështetje financiare. E hap diskutimin për këtë pikë.

Shkëlqim Ibrahim: Nuk do të zgjatem shumë, vetëm dua t’i falënderoj sinqerisht të gjitha palët e përfshira në subvencionim dhe të uroj që t’i lehtësohet sa më shumë trajtimi jashtë vendit personit në fjalë. Faleminderit të gjithëve.

Armend Begu: Pajtohem dhe jemi dakord. Unë personalisht e mbështes ndihmën për këtë familje, për shkak se aty ka më shumë anëtarë që janë të prekur dhe kanë nevojë për përkrahje. Prandaj, kjo është e mirëseardhur dhe, nëse ka nevojë, mund të rritet edhe vlera e mbështetjes.

Valon Brahimi: Edhe ne si anëtarë të Kuvendit e vlerësojmë ndihmën financiare dhe i falënderojmë të gjitha palët që kanë qenë të përfshira në këtë proces. Ne e dimë që fillimisht kërkesa ka qenë për 5,000€ ndërsa ekzekutivi ka propozuar 6,000 € Megjithatë, pas diskutimeve që kam pasur me familjarët e saj, rezultoi se shpenzimet kanë qenë më të larta për shkak të inflacionit dhe rritjes së kostove të shërbimeve shëndetësore jashtë vendit. Prandaj, mendoj se, nëse ka mundësi buxhetore, do të ishte mirë që mbështetja të rritet deri në 8,000 € Nëse nuk ka mundësi, edhe 6,000 € është e mirëseardhur. Gjithsesi, shpreh konsideratën time për këtë ndihmë dhe falënderoj të gjithë të përfshirët.

Xhyljeta Imeri: Unë mendoj që kjo ndihmë është e qëlluar, edhe pse nuk është e mjaftueshme, por gjithsesi ndihmon sadopak në lehtësimin e shpenzimeve.

Albina Kastrati Rama: Unë jam e vetëdijshme që ka nevojë për ndihmë financiare në rastin në fjalë dhe që nevojat janë më të mëdha, megjithatë, për vitin 2026, Drejtoria e Shëndetësisë në kategorinë e subvencioneve ka në dispozicion vetëm 80,000 € ndërsa numri i kërkesave që i drejtohen kësaj drejtorie është rreth 2,000 raste. Në këtë situatë, si drejtori, ne kemi tejkalluar maksimalisht mundësitë buxhetore për ta përkrahur këtë familje konkretisht, Elona Brahimin. Nëse realisht do të kishim mundësi më të mëdha, do të ishte shumë mirë t’i ofronim më shumë, por aktualisht kjo është maksimumi që mund të ndahet, duke pasur parasysh edhe kërkesat e tjera që mbesin pa mbështetje. Vlen të theksohet se pas mbylljes së thirrjeve për subvencione në vitin 2025, kanë ardhur edhe rreth 40 raste të reja, fatkeqësisht me sëmundje të rënda si kanceret agresive. Këto janë raste shumë shqetësuese dhe kërkesa të

vazhdueshme për mbështetje, së bashku me sëmundjet kronike që gjithashtu kanë nevojë për përkrahje. Megjithatë, prioritet mbeten rastet me sëmundje të rënda si kanceret. Duke pasur vetëm 80,000 € në dispozicion, aktualisht nuk mund të ofrojmë më shumë për këtë rast, megjithëse vullneti ynë është që të ndihmojmë sa më shumë.

Kryesuesi i Kuvendit Meqenëse nuk ka të lajmëruar për diskutim atëherë e hedh në votim Propozim-vendimin për lejimin e mjeteve financiare për trajtim mjekësor jashtë vendit për znj. Elijona Brahimi.

Rezultati i votimit: 30 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Konstatohet se janë të pranishëm 30 anëtarë të Kuvendit dhe vendimi për lejimin e mjeteve financiare për trajtim mjekësor jashtë vendit për znj. Elijona Brahimi është miratuar me votë unanime.

Pika 4

Kryesuesi i Kuvendit: Sa i përket Propozim vendim për formimin e komiteteve konsultative materialin e keni përpara. Kjo pikë ka kaluar në KPF. Çelësi i përfaqësimit të këtij komisioni është me përbërje prej tre anëtarëve nga Kuvendi, një nga ekzekutivi dhe një nga shoqëria civile. Sa i përket komiteteve dhe të çelësit të përfaqësimit nuk kemi pasur rast më herët të diskutojmë me përfaqësuesit e grupeve parlamentare se si do të bëhet përfaqësimi. Megjithatë, sipas logjikës që është praktikuar edhe më herët, propozohet një përfaqësues nga PDK-ja, një nga Vetëvendosja dhe një nga LDK-ja ose Guxo, ndërsa ekzekutivi ka një përfaqësues të vetin. Varësisht nga dakordimi mes Guxo dhe LDK-së, mund të vendoset nëse përfaqësuesi i ekzekutivit ose i Kuvendit do të jetë pjesë e komisionit. Sidoqoftë, nuk ka problem nëse arrihet pajtueshmëri. Nëse ka dakordim mes grupeve, mund të vendoset që njëri vend të plotësohet nga LDK-ja ose nga Guxoi, sipas marrëveshjes së tyre. Në parim, nuk ka kundërshtime. A pajtohemi që ky të jetë çelësi i përfaqësimit.

Visar Syla: Po, dakordohemi, nuk ka problem me propozimin e parë. Të drejtën, mund të jetë edhe dikush nga LDK-ja në vendin tonë, nuk ka problem.

Kryesuesi i Kuvendit: Atëherë faleminderit. Pajtoheni që ky të jetë çelësi i përfaqësimit dhe nuk ka nevojë të aprovet si i tillë.

Shkëlqim Ibrahim nga GP i PDK-së e propozojm z.Gëzim Stavilevci.

Kushtrim Zeneli nga GP i LVV e propozojm z.Bajram Istrefi.

Xhylljeta Imeri nga GP i LDK-së e propozojm z. Oltion Ahmeti.

Ramadan Beshiri nga ekzekutivi Fitore Mehmeti dhe Gjyla Haziri, është në organizatë të shoqërisë civile (“Zëri i prindërve”).

Kryesuesi e hedh në votim Propozim vendimi për formimin e komiteteve me këtë përbërje:

Gëzim Stavilevci,

Bajram Istrefi,

Oltion Ahmeti,

Fitore Mehmeti dhe

Gjyla Hajrizi.

Rezultati i votimit: 30 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesi konstaton se miratohet me votë unanime vendimi për formimin e komitetve konsultative.

Pika 5

Kryesuesi i Kuvendit: Sa i përket Propozim-vendimit për zgjedhjen e përfaqësuesve të Kuvendit të Komunës për anëtarë të Kuvendit të Asociacionit të Komunave të Kosovës. Domethënë, këta janë katër anëtarë sipas çelësit me të cilin do të përfaqësohet Komuna e Mitrovicës në këtë kuvend. Njëri anëtar është automatikisht Kryetari i Komunës, ndërsa tre të tjerët janë nga Kuvendi. Nëse keni konsideratë, do të ishte mirë që të përfshihet edhe Kryesuesi i Kuvendit, por sido që të jetë, është prapë propozimi juaj. Edhe dy anëtarë të tjerë duhet të jenë po ashtu nga përbërja e Kuvendit.

Shkëlqim Ibrahimimi nga GP i PDK-së propozon z. Egzon Sadiku.

Kushtrim Zeneli nga GP i LVV propozon z. Kushtrim Zeneli.

Kryesuesi i Kuvendit: Atëherë, përfaqësimi i Komunës së Mitrovicës në Kuvendin e Asociacionit të Komunave do të përbëhet nga katër anëtarë, fatkeqësisht të gjithë meshkuj. Nuk e di cili do të jetë shembulli që po japim si komunë me këtë përfaqësim. Në këtë formë është përfaqësimi i Komunës së Mitrovicës në Kuvendin e Asociacionit të Komunave: katër anëtarë, të gjithë meshkuj. Në rregull jemi. A pajtoheni që këtu nuk kërkohet më çelësi, pasi është vetëm një shembull për përbërjen? Në rregull, atëherë një pozitë i takon PDK-së, një Vetëvendosjes, dhe një tjetër mbetet për LDK-në.

Elfate Bahtiri Ademi nga GP i GUXO propozon z. Visar Syla.

Xhyljeta Imeri nga GP i LDK-së propozon z. Safet Kamberi.

Kryesuesi i Kuvendit tërhiqet, nuk pranon të propozohet për anëtarë për zgjedhjen e përfaqësuesve të Kuvendit të Komunës për anëtarë të Kuvendit të Asociacionit të Komunave të Kosovës

Visar Syla: Meqenëse ne u tërhoqëm nga pika më herët dhe i dhamë hapësirë LDK-së, besoj që ndoshta do të ishte mirë që edhe LDK-ja këtë herë të tërhiqet, në lidhje me përfaqësim.

Kryesuesi i Kuvendit: Unë tërhiqem plotësisht dhe nuk dua të jem pjesë e matjeve apo diskutimeve për këtë çështje.

Erseka Barani: Më fal, më vjen shumë keq. Kërkoj nga propozuesit që të paktën njëri prej tyre të bëjë kompromis, sepse mendoj se kemi gra shumë të zonja që mund të na përfaqësojnë denjësisht në Asociacionin e Komunave, kushdo qoftë, duke filluar nga shefi i grupit tim e deri te të tjerët. Do të ishte mirë që të paktën njëri prej tyre të përzgjedhë një grua, sepse nuk besoj se përfaqësimi pa asnjë grua do të ishte përfaqësim i denjë dhe gjithëpërfshirës në Asociacionin e Komunave. Ju lutem ta konsideroni këtë.

Kryesuesi i Kuvendit: A ka mundësi të dëgjojmë njëri-tjetrin, sepse besoj se kjo është krejt ideja me dhënë një shembull të mirë të përfaqësimit. Realisht këtu ka edhe femra shumë të zonja, dhe secila prej jush është shumë e zonja, pa dallim, dhe do të mund të përfaqësonit në mënyrën më të mirë të mundshme Komunën e Mitrovicës në Kuvendin e Asociacionit të Komunave. Prandaj po e shoh që ndonjëherë ka tërheqje, por nëse edhe këtu do të kishte kriter përfaqësimi gjinor, atëherë minimumi do të duhej të kishim dy propozime që të ishin gra. Nëse vazhdoni kështu me polemika, nuk po arrijmë asgjë, sepse duhet të respektohet rendi dhe fjala duhet marrë sipas rregullave për replikë apo deklaram zyrtar.

Shkëlqim Ibrahimimi: Unë realisht e vlerësoj propozimin e zonjës, mirëpo mendoj se Vetëvendosja e ka më së lehti të tërhiqet, sepse shefi mund ta tërheqë emrin e vet, kështu që do të ishte më korrekte. Unë kam propozuar njërin prej anëtarëve tanë, ndërsa për sa i përket diskutimeve, mendoj që edhe z. Zeneli, si person i natyrës së butë dhe bashkëpunuese, ka mundësi të bëjë një hap të tillë nëse ka nevojë.

Kushtrim Zeneli: Shkëlqim, është mirë të jemi korrekt, në seancën e kaluar, për dy ndërmarrje publike, ne kemi propozuar gra ose vajza për shkak të kuotës gjinore dhe i kemi tërhequr disa kandidatë, edhe pse ata nuk kanë qenë të vendosur përfundimisht, vetëm për të siguruar përfaqësimin gjinor, dy kompromise i kemi bërë në ndërmarrjet publike, ku kemi hequr dy kandidatë që i kemi pasur të propozuar. Njëri prej tyre ka qenë Bajram Istrefi dhe tjetri Armend Begu. Tani është duke u kërkuar edhe një kompromis tjetër, ndërkohë që katër pozitave duhet të mbahen të balancuara dhe të përfaqësuara si duhet.

Kryesuesi i Kuvendit: Edhe diçka të sqarohemi përfundimisht. Domethënë, përfaqësimi gjinor nuk është obligim ligjor. Ne po flasim për një çështje parimore, dhe për atë se çfarë do të ishte më e drejtë dhe më e mirë në aspektin e përfaqësimit. Përndryshe, unë i kam propozimet e mia dhe jam në rregull. Nëse ju nuk tërhiqeni dhe ata nuk tërhiqen, atëherë kërkohet një kompromis dhe vazhdojmë tutje.

Xhyljeta Imeri: Me të vërtetë është e papranueshme për secilin nga ju, pavarësisht se kush, në këtë rast ne si LDK automatikisht po përjashtohemi. Secila prej grupeve tuaja do të mund të na përfaqësonte në mënyrën më të mirë të mundshme. Nga ana tjetër, duhet të jemi të sinqertë: partia fituese aktualisht ka tre burra në përbërje. Besoj që së paku njëra prej tyre duhet të jetë grua, dhe kjo do të ishte e duhura

për të gjithë. Nëse mendoni që keni nëna, gra, motra dhe vajza, atëherë duhet të mendojmë edhe në këtë aspekt. Me të vërtetë është e papranueshme për secilin nga ju. Pavarësisht se kush, në këtë rast ne si LDK automatikisht po përjashtohemi. Nëse mendoni që keni nëna, gra, motra dhe vajza, atëherë duhet të mendojmë edhe në këtë aspekt.

Kryesuesi e hedh në votim vendimin për zgjedhjen e përfaqësuesve të Kuvendit të Komunës për anëtarë të Kuvendit të Asociacionit të Komunave të Kosovës. me këtë përbërje:

Faton Peci - Kryetar i Komunës,
Egzon Sadiku nga PDK
Kushtrim Zeneli nga VV
Visar Sylja nga Guxo

Rezultati i votimit: 16 për, 0 kundër dhe 11 abstenime.

Kryesuesi konstaton se miratohet vendimi për zgjedhjen e përfaqësuesve të Kuvendit të Komunës për anëtarë të Kuvendit të Asociacionit të Komunave të Kosovës.

Pika 6

Kryesuesi i Kuvendit: Atëherë përpara e keni Kërkesë për vazhdimin e marrëveshjes me Këshillin e Bashkësisë Islame në Mitrovicë. Ne e kemi diskutuar edhe në KPF rreth kësaj çështjeje. Ndërsa për ta sqaruar më detajisht fjalën ia kaloj drejtorit z. Ramdan Beshiri.

Ramdan Beshiri: Faleminderit për rekomandimet dhe debatet që i kemi pasur në KPF. Si Drejtori e Mirëqenies Sociale, duke pasur parasysh gjendjen socio-ekonomike, ne po synojmë të vazhdojmë një traditë për mbulimin e shpenzimeve të ceremonive të varrimit, që është në kuadër të marrëveshjes me Bashkësinë Islame. E re në këtë marrëveshje është kohëzgjatja trevjeçare, në vend të një viti si më herët. Këtë e kemi bërë për të shmangur ndërprerjet dhe vonesat në rinovimin e marrëveshjes, si dhe për shkak të rritjes së kostos së punës dhe inflacionit, me qëllim të kursimit të mjeteve publike. Një çështje që e kemi diskutuar edhe me Zyrën Ligjore, si dhe në konsultim me Kryesuesin e Kuvendit e Kuvendit, është që në marrëveshje të mos specifikohen fshatrat veriore, pasi kjo do të binte në kundërshtim me ligjin për vetëqeverisje lokale, i cili kërkon që administrimi të bëhet brenda kufijve territorial të komunës. Edhe pse si politikë e Lëvizjes Vetëvendosje kemi vëmendje dhe përkrahje për këto zona, nga aspekti ligjor jemi të detyruar të veprojmë në këtë mënyrë. Prandaj janë larguar nga marrëveshja fshatrat e komunës së Leposaviqit, Zveçanit dhe fshati Çabër i komunës së Zubin Potokut. Përndryshe, marrëveshja është e parashikuar për tre vite dhe është në përputhje me kornizën ligjore dhe mundësitë buxhetore. Nëse keni ndonjë kritikë apo ide, jemi të hapur për diskutim.

Shkëlqim Ibrahim: Edhe ne si Grup Parlamentar i PDK-së e mbështesim vazhdimin e kontratës ndërmjet Komunës së Mitrovicës së Jugut me Bashkësinë Islame, sepse kjo marrëveshje garanton vazhdimësi dhe stabilitet në ofrimin e një shërbimi kaq të ndjeshëm siç është mbulimi i shpenzimeve të varrimit për qytetarët. Bashkësia Islame ka përvojën, kapacitetin dhe besimin e qytetarëve për të kryer këtë shërbim në mënyrë të rregullt dhe sipas rregullave. Në të njëjtën kohë, edhe përfshirja e komunës e lehtëson procesin dhe e bën më funksional. Po ashtu, e përshëndesim marrëveshjen trevjeçare, e cila do të evitohet krijimin e vakumit gjatë periudhës së ripërtëritjes së kontratës.

Xhyljeta Imeri: Faleminderit. Mbështetja e qytetarëve përmes heqjes së shpenzimeve të ceremonive të varrimit përbën një barrë për komunën, por është një masë shumë e rëndësishme dhe e mirëseardhur për të gjithë qytetarët e Mitrovicës. Unë jam pro vazhdimin të kontratës me Bashkësinë Islame për ofrimin e shërbimeve të ceremonive të varrimit për të gjithë qytetarët, madje edhe për një periudhë prej tre vitesh, për aq kohë sa kjo nuk bie ndesh me dispozitat ligjore.

Kryesuesi i Kuvendit: Unë besoj që kjo është një praktikë shumë e mirë dhe duhet të vazhdohet edhe më tutje. Marrëveshja parasheh që të jetë për tre vite, e jo të rinovohet çdo vit. Ne e mbështesim këtë plotësisht, përfshirë edhe ndryshimet në çmime që kanë ndodhur për ceremonitë, ashtu siç është dakorduar ndërmjet Kryetarit dhe Bashkësisë Islame. Si e tillë, kjo marrëveshje mbetet në formën e

propozuar. Megjithatë, kam një sqarim që mendoj se është i nevojshëm për të shmangur paqartësitë më tutje. Ka pasur një periudhë kohore, rreth nga tetori apo nëntori, kur ka përfunduar marrëveshja paraprake, dhe gjatë kësaj kohe Bashkësia Islame ka vazhduar t'i kryejë të gjitha obligimet ndaj qytetarëve. Tani kemi një vakuum në këtë periudhë. Pyetja ime është: si është paraparë të trajtohet kjo situatë? A ka nevojë që edhe kjo periudhë të përfshihet me një vendim të Kuvendit, duke e formalizuar faktin që shërbimet janë kryer edhe gjatë kësaj kohe nga Bashkësia Islame?

Igballe Islami: Realisht, kemi pasur edhe vitin e kaluar një situatë të njëjtë. Ka qenë një periudhë kur nuk ka pasur kontratë dhe, nëse jam i saktë, ka qenë marrëveshja 14-mujore. Deri në momentin kur është inicuar kontrata e re, edhe në rastin e kaluar është specifikuar që kjo kontratë përfshin edhe obligimet retroaktive të Komunës së Mitrovicës ndaj Bashkësisë Islame. Kjo është një temë shumë e ndjeshme dhe askush këtu nuk ka qëllim ta politizojë. Megjithatë, Bashkësia Islame, edhe pse nuk ka pasur kontratë, ka vazhduar t'i kryejë shërbimet për qytetarët e komunës sonë. Për hir të kësaj, dhe për të tejkaluar këtë çështje procedurale, edhe në të kaluarën kemi vepruar njësoj, duke e përfshirë në kontratë obligimin për pagesa retroaktive për periudhën kur nuk ka pasur kontratë. Arsyetimi ka qenë se Kuvendi Komunal në atë periudhë nuk ka qenë funksional.

Ramdan Beshiri: Po, gjithçka është në rregull, ashtu siç e theksoi edhe kolegja. Pajtohem dhe besoj që kjo është edhe një çështje humane, përtej aspektit formal. Shërbimet janë kryer, faturat do të paraqiten dhe ne do t'i mbulojmë ato në mënyrë retroaktive. Ekziston edhe disponueshmëria financiare, kështu që obligimet dhe borxhet do të mbulohen.

Valon Brahim: Unë vetëm desha të ndalem te pjesa e pagesave retroaktive. Në aspektin ligjor, kjo mund të paraqesë vështirësi, prandaj do të ishte mirë të merret një vendim i veçantë nga Kuvendi për t'i mbuluar këto obligime. Pagesat retroaktive mund të kenë pengesa ligjore nëse nuk formalizohen si duhet. Prandaj, me një vendim të veçantë të Kuvendit, kjo çështje mund të rregullohet dhe të shmangen problemet në të ardhmen. Besoj që ekziston vullneti i të gjithëve për ta zgjidhur këtë çështje pa telashe.

Kryesuesi i Kuvendit: Edhe pse në parim ata kanë vazhduar t'i kryejnë obligimet, komuna në një formë është dashur ta trajtojë këtë çështje edhe përmes procedurave përmbarimore. Megjithatë, ideja dhe qëllimi im është që ne të tentojmë të formulojmë një qëndrim formal, në mënyrë që ekzekutivi të jetë korrekt në raport me vendimin e Kuvendit, por njëkohësisht të mos i sjellim telashe Bashkësisë Islame për këtë periudhë kohore, në mënyrë që ata të mund të inkasojnë të hyrat dhe obligimet që u takojnë, duke pasur parasysh se kanë pasur shumë obligime për shkak të mospagesave nga Komuna e Mitrovicës. Prandaj, duke pasur parasysh periudhën pas skadimit të kontratës paraprake, propozoj që kjo periudhë të trajtohet në mënyrë retroaktive. Atëherë e hedh në votim Kërkesë për vazhdimin e marrëveshjes me Këshillin e Bashkësisë Islame në Mitrovicë dhe a pajtoheni që kjo të jetë pjesë e vendimit, pra që të mbulohet edhe kjo periudhë dhe të mos ketë telashe ligjore për ekzekutivin, ndërsa vendimi i Kuvendit të jetë në rregull?

Rezultati i votimit: 29 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesi konstaton se miratohet me votë unanime Kërkesë për vazhdimin e marrëveshjes me Këshillin e Bashkësisë Islame në Mitrovicë, dhe thekson se janë prezent 29 anëtarë të Kuvendit.

Pika 7

Drejtoresha Fitore Mehmeti e informoi Kuvendin se vlerësimi i dëmeve nga vërshimet është realizuar nga komisionet përkatëse, në përputhje me aktet ligjore në fuqi. Janë angazhuar komisioni për fatkeqësi natyrore, si dhe dy komisione të veçanta për vlerësimin e dëmeve në bujqësi dhe në biznese. Sipas saj, raporti është i kompletuar dhe i ngjashëm me praktikën e mëhershme, përfshirë edhe rastet e vitit 2023. Qëllimi kryesor është që përmes miratimit të këtij raporti në Kuvend, të mundësohet kërkesa për mbështetje financiare nga niveli qendror për qytetarët e dëmtuar. Gjithashtu, ajo theksoi se në raport ekziston një gabim teknik në llogaritjen e dëmit për një familje (me numër rendor 92). Fillimisht, dëmi

ishite regjistruar në vlerë prej 930 € por pas verifikimit është konstatuar se dëmi real është 3,290 € pasi një pjesë e dëmeve nuk ishte përfshirë në llogaritje.

Igballe Islami: Fillimisht, falënderoj drejtoreshën për sqarimet e dhëna dhe për konfirmimin se raporti aktual është i ngjashëm me atë të vërshimeve të vitit 2023. Dua të rikujtoj se procesverbalin e asaj periudhe nuk e kam votuar, por kam abstenuar. Arsyeja ka qenë se ai nuk pasqyronte saktë diskutimet e zhvilluara, veçanërisht në pjesën ku thuhej se kryetari i komisionit kishte qenë drejtor i drejtorisë. Për këtë arsye, sot kam sjellë me vete raportin e shkurtit 2023, i cili dëshmon se përbërja e komisionit ka qenë e njëjtë si atëherë ashtu edhe sot, përfshirë edhe renditjen e anëtarëve. I vetmi ndryshim është adresimi dhe emri i Kryesuesi i Kuvendit. Ne jemi këtu për të përfaqësuar interesat e qytetarëve dhe për të thënë të vërtetën. Faktet tregojnë qartë se komisioni ka qenë i njëjtë dhe ka kryer punën e tij në mënyrë profesionale, si në vitin 2023 ashtu edhe tani. Prandaj, nuk duhet të ketë keqinterpretim apo shtrembërim të fakteve. Sa i përket situatës aktuale, ne të gjithë bashkëndojmë me qytetarët e prekur nga vërshimet, si në vitin 2023 ashtu edhe në rastin e fundit. Tani që raportin e kemi përpara dhe të dhënat janë të qarta, pres që të ndërmerren hapa konkretë. Duke u bazuar edhe në deklaratimet e mëhershme të kryetarit të komunës, i cili ka premtuar mbështetje nga niveli lokal, propozoj që në mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të sillen një propozim-vendim për subvencionimin e familjeve të dëmtuara. Duke pasur parasysh edhe të hyrat buxhetore të bartura, është e arsyeshme që një pjesë e tyre të dedikohet për këtë qëllim. Gjithashtu, kjo duhet të shërbejë si mësim për të ardhmen: deklaratimet në Kuvend duhet të jenë të sakta dhe të verifikueshme. Kryesuesi i Kuvendit nuk është aty për të “mbajtur për fjale” askënd, por për të udhëhequr seancën. Megjithatë, secili prej nesh ka përgjegjësi për atë që deklaron, dhe në rast të pasaktësive, është e drejtë të kërkohet korrigjim apo edhe falje. Në fund, shpreh respekt për punën e komisionit, i cili ka vepruar në kushte të vështira dhe me profesionalizëm të lartë. Reagimet e mia kanë qenë pikërisht në mbrojtje të integritetit të punës së tyre.

Kryesuesi i Kuvendit: A ka mundësi një sqarim, diskutimi juaj a ka të bëjë me mua “Më mbaj për fjale”.

Igballe Islami: Jo nuk është për ju.

Xhylyeta Imeri: Fillimisht, dua të ndalem te çështja e parandalimit të vërshimeve, e pastaj të kalojmë te raporti i dëmeve. Sot po flasim për një problem që po përsëritet vazhdimisht në komunën tonë. Mitrovica, për shkak të lumenjve si Ibri, Sitnica dhe Lushta, është vazhdimisht e rrezikuar nga vërshimet. Megjithatë, duhet të jemi të sigurtë: vërshimet nuk janë vetëm pasojë e natyrës, por edhe e mungesës së veprimeve tona në kohë. Nuk mund të vazhdojmë të reagojmë vetëm pasi të ndodhë dëmi. Është e domosdoshme të ndërmarrim masa parandaluese, si, pastrimi i rregullt i lumenjve dhe kanaleve kulluese, ndalimi i ndërtimeve në zonat e rrezikuara, investime në mure mbrojtëse dhe sisteme të drenazhimit, kontroll më i rreptë ndaj ndotjes dhe hedhjes së mbeturinave, rritja e vetëdijes së qytetarëve për ruajtjen e mjedisit dhe ndalimin e prerjes së drunjve, të cilët ndihmojnë në përthithjen e ujit. Parandalimi gjithmonë kushton më pak sesa përballimi i pasojave, prandaj kjo çështje duhet të jetë prioritet. Sa i përket raportit të dëmeve, sipas të dhënave: janë dëmtuar 118 ekonomi familjare, 28 prona bujqësore, 13 biznese dhe 1 automjet. Vlera totale e dëmeve arrin rreth 800,000 € Duke parë që dëmet janë të ndryshme nga rasti në rast, nuk është e drejtë të aplikohet një shumë e njëjtë për të gjithë. Për këtë arsye, propozoj që komuna të kompensojë deri në 80% të dëmit për secilën kategori, që në total do të ishte rreth 640,000 € Duke pasur parasysh rritjen e buxhetit komunal, ky është një obligim i përbalueshëm dhe një ndihmë e domosdoshme për qytetarët e prekur.

Kushtrim Zeneli: Sa i përket raportit të vërshimeve, dua të sqaroj se unë e kam votuar këtë raport edhe më herët, por kjo nuk do të thotë se jam pajtuar me përmbajtjen e tij, as atëherë dhe as sot. Ndoshta ka pasur një lëshim teknik nga ana ime në formulim, por thelbi i qëndrimit tim ka qenë i qartë, nuk jam pajtuar me mënyrën e vlerësimit. Nuk kam insistuar se kush ka qenë kryetar i komisionit; ajo që kam theksuar është se drejtori që e ka mbrojtur pikën ka qenë i përfshirë në proces si pjesë e strukturave të emergjencës edhe sot vazhdoj të pranoj ankesa nga qytetarë dhe biznese që ndihen të dëmtuar dhe të

padrejtë në vlerësim. Kjo tregon se problemi nuk është mbyllur dhe se ka nevojë për rishikim serioz. Edhe në diskutimet e mëhershme kam kërkuar një auditim të brendshëm për këtë proces. Edhe pse e kam votuar raportin, këtë e kam bërë për të mos dëmtuar qytetarët që kishin nevojë urgjente për ndihmë, e jo sepse kam qenë i bindur për saktësinë e tij. Ka raste konkrete ku ka mospërputhje mes gjendjes reale dhe vlerësimit në raport. Për shembull, ka biznese që sipas raportit figurojnë me dëme të mëdha, ndërkohë që në ditën e vërshimeve nuk është vërejtur një situatë e tillë në terren. Për këtë arsye, edhe sot, pavarësisht se do ta votoj raportin, e ritheksoj kërkesën time për: një auditim të plotë dhe të pavarur të procesit të vlerësimit, ndarje më të qartë të kategorive (biznese, ekonomi familjare, bujqësi), dhe përmirësim të metodologjisë së vlerësimit. Vërejtjet që i kam sot janë të njëjtat që i kam pasur edhe në vitin 2023, pasi bëhet fjalë për të njëjtin komision dhe të njëjtën qasje në vlerësim. Qëllimi im nuk është të bllokoj procesin, por të sigurojmë drejtësi dhe transparencë për të gjithë qytetarët e prekur. Besoj që një pjesë e rekomandimeve tona janë marrë parasysh, megjithatë vërejtjet që kam për këtë raport mbeten të njëjta si edhe më herët, sidomos sa i përket punës së komisionit.

Valon Brahim: Si anëtar i Komitetit për Politikë dhe Financa, bazuar në ankesat e qytetarëve dhe bizneseve që kanë qenë subjekt i vlerësimit, kam kërkuar përmes drejtoreshës që raportin veçanërisht për bizneset të na paraqitet i kompletuar, i shoqëruar me: dëshmi fotografike, metodologjinë e vlerësimit, dhe formularët përkatës se si është bërë vlerësimi. Sa i përket ekonomive familjare dhe bujqësisë, ka disa vërejtje, por në përgjithësi janë më të pranueshme. Ka raste konkrete që tregojnë mospërputhje në vlerësim. Për shembull, në një rast që e kam parë vetë në terren, një familjeje i janë dëmtuar rreth 500 pula, ndërsa vlerësimi për to ka qenë dukshëm më i ulët se vlera reale në treg. Për një familje, një dëm i tillë është shumë i madh dhe duhet trajtuar me seriozitet. Pikërisht për këto arsye, me shumë respekt ndaj drejtoreshës, vlerësoj se ky raport duhet të kthehet për plotësim me dokumentacion shtesë. Madje kam menduar të propozoj edhe një ekip të veçantë mbikëqyrës, jo për rivlerësim, por për verifikim në terren të rasteve sidomos të bizneseve për të parë nëse dëmet përputhen me atë që është raportuar. Problemi kryesor është mungesa e dëshmive. Nuk kemi asnjë fotografi për biznese të dëmtuara. Kjo krijon paqartësi dhe dyshime të arsyeshme, ka raste ku, sipas informacioneve në terren, vlerësimet nuk përputhen me gjendjen reale. Ne si asambleistë nuk jemi kundër asnjë biznesi përkundrazi, nëse dikush është dëmtuar, meriton mbështetje, madje edhe më shumë. Por kërkesa jonë është e thjeshtë: të kemi transparencë dhe dokumentim të plotë për atë që po votojmë. Prandaj, kërkoj që raporti të plotësohet me: fotografi për çdo biznes të vlerësuar, dokumentacion shoqëruar të qartë, dhe përputhje me konkluzionet e dala nga Komiteti për Politikë dhe Financa. Vetëm në këtë mënyrë mund të kemi besim të plotë në vendimet që marrim.

Nënkryetari I Komunës z. Enis Osmani: Nuk isha këtu dhe përsëri u bashkangjita kur e kuptova që është pika e vërshimeve, sepse kemi edhe takime me qytetarë. Për shkak të respektit dhe transparencës për secilin prej jush, erdha të jap një sqarim shtesë. Së bashku me drejtoreshën dhe kryetarin kemi vlerësuar që te raporti i bizneseve të bëhet një rivlerësim nga fillimi deri në fund. Nuk është i drejtë ky vlerësim që ka ndodhur. Unë nuk jam i kënaqur me këtë komision; këtë e din edhe drejtoresha, edhe kryetari, madje edhe vetë kryetari i komisionit. Kam pasur një ballafaqim personal me të dhe i kam thënë që nuk është bërë drejt. Numri i zyrtarëve është i kufizuar, ka mungesë stafi në drejtori dhe në komunë. Nuk po them që nuk është bërë punë, por nuk është bërë puna më e mirë e mundshme. Sa i përket raportit të bizneseve, duhet të bëhet edhe njëherë vlerësimi për të gjitha bizneset. Nuk është e drejtë që një biznes të vlerësohet, për shembull, me 65.000€ ndërsa një tjetër i ngjashëm me 8.560 €. Prandaj, ne do ta tërheqim pjesën e raportit për biznese nga kjo seancë dhe do të bëjmë një komision të ri për verifikim të saktë. Ky komision nuk do të jetë i njëjti; do të kërkojmë ndihmë edhe nga drejtoritë e tjera. Do të jetë komision gjithëpërfshirës, ku mund të përfshihen edhe asamblistët që kanë interes për të parë nga afër procesin e vlerësimit. Nuk jemi kundër bizneseve dhe as kundër asnjë personi. Nuk jam as kundër personit që u përmend. Por ne e dimë që disa prej jush janë takuar me qytetarë dhe kanë ngritur shqetësime konkrete. Sa i përket rasteve konkrete, kemi marrë masa. Për shembull, ura në zonën e Lushës

është rrënuar sepse ka ndikuar në bllokimin e rrjedhës së ujit. Po ashtu, edhe pjesa te stacioni i autobusëve është përfshirë nga vërshimet për shkak të lumit Lushta, ku materialet e mëdha kanë shkaktuar bllokime. Këto janë larguar dhe është ndërhyrë. Pastrimi i lumenjve po bëhet dhe është bërë edhe më parë. Nuk mund të pastrohet lumi disa herë brenda një dite, por do të bëhet në mënyrë të vazhdueshme. Do të ketë edhe raportim me data konkrete, i cili do të protokollohet për transparencë. Nuk dua të hyj në debat për të kaluarën, por dua të theksoj që çdo veprim do të jetë transparent. Këto kritika i marrim seriozisht. Jemi bashkë me ju në këtë proces, sepse është interes i qytetit, jo interes personal apo partiak. Sa i përket pikës, pjesa për bizneset tërhiqet. Për pastrimin e lumenjve, besoj që e keni parë që po ndërmarrim masa. Ju lus edhe juve, si asamblistë, të kontribuoni në vetëdijesimin e qytetarëve. Ka raste kur lumenjtë pastrohen, por brenda ditës hidhen përsëri mbeturina të mëdha. Duhet të punojmë së bashku për këtë çështje. Nuk po them që jemi perfekt, por bashkë mund të gjejmë mënyra për ta përmirësuar situatën dhe për të rritur vetëdijen e qytetarëve.

Ferdi Kadriu: Përshëndetje për të gjithë. Meqenëse erdhe nënkryetar dhe e ke vizituar lagjen Bajr, për shkak të rrëshqitjeve të dheut që po ndodhin vazhdimisht, bashkë me ju ka qenë prezent edhe një përfaqësues nga, nëse nuk gaboj, AME-ja, si dhe nga ministria. Cilat janë veprimet që janë ndërmarrë më tutje? Me sa e di, një raport është dërguar prej atje, por cilat janë hapat konkretë që janë ndërmarrë pas kësaj? Sepse banorët janë duke u ankuar që nuk po kanë mundësi të takohen dhe të procedojnë tutje çështjen. Dhe, aq sa di unë, ata janë duke planifikuar edhe të ndërmarrin veprimet e tyre demokratike.

Nënkryetari i Komunës z. Enis Osmani: Në rregull, në këtë pikë mua më duhet me ju kritikë juve të gjithëve. Mos e merrni si dobësi. Raportin për Bajrin 2023–2026 nuk e keni përfunduar sa i përket ekonomive familjare. Unë e kam urdhëruar drejtoreshën dhe është bërë raporti për gjithë Bajrin. Sa i përket ekonomive familjare, raporti është përfunduar. Në njërin prej seancave të ardhshme do të vijë raporti për Bajrin dhe do ta diskutoni. Ju, ekzekutivi i kaluar, nuk e keni bërë. Pse nuk e keni bërë, e dini më mirë vetë. Nuk dua ta zgjeroj si kritikë ndaj jush, por hapat nuk i keni marrë. Raporti që i është dorëzuar drejtoreshës – më korrigjoni nëse gaboj – ka qenë për tre ose katër shtëpi, ndërkohë që janë përmendur 23 shtëpi. Raporti ka qenë për 23 ose 27, por ju keni dorëzuar një raport vetëm me tre shtëpi. Kjo nuk është mënyra e duhur, sepse secila shtëpi duhet të evidentohet dhe të përshkruhet dëmi për secilën veç e veç. Në një nga seancat e ardhshme do të vijë raporti për Bajrin dhe do ta diskutojmë. Nuk dua të marr më shumë kohë, por dua të theksoj që raporti nuk është përfunduar si duhet. Më vjen keq që ka ndodhur kjo. Nuk dua ta politizoj, por duke marrë parasysh dëmet që janë shkaktuar – tërmeti i vitit 2023 dhe rrëshqitjet e dheut ky raport nuk është vlerësuar siç duhet. Po flas në bazë të asaj që kanë thënë banorët. Nuk jam këtu me ju vënë para përgjegjësisë, por fakt është që raporti nuk ka qenë i plotë. Prej kur kemi ardhur në ekzekutiv ka ndodhur edhe një tërmet tjetër, ku janë dëmtuar tre ose katër shtëpi gjatë kësaj periudhe, nga dhjetori e këndeje. Pjesa paraprake është dashur të bëhej nga ju. Do ta diskutojmë kur të vijë në seancë, por aktualisht janë evidentuar vetëm tre shtëpi.

Gëzim Stavilevci: Për hir të korrektesisë: raporti ka qenë i përgatitur për katër shtëpi, sepse në kohën kur ka ndodhur rasti, vetëm katër shtëpi kanë qenë të dëmtuara. Për ta njoftuar nënkryetarin, raporti ka qenë i përfunduar dhe i votuar në Kuvendin Komunal, dhe banorët janë kompensuar me nga 15,000€ (nëse nuk gaboj) për këto katër shtëpi. Pjesa tjetër nuk është përfshirë, sepse nuk ka pasur dëmtime në shtëpi të tjera në atë kohë. Ka mundur të ndodhë për shkak se në atë pjesë ka shumë rrëshqitje të dheut, nënkryetar. Edhe për këto mundesh me u bind, sepse ekziston raporti i dorëzuar në AME nga banorët, me rreth 15 raste.

Shkëlqim Ibrahim: Më vjen mirë që u tërhoq pika për bizneset, sepse nuk ka pasur... Veç kërkoj që, meqë e keni cekur në preambulë Rregulloren 17/2015, ku edhe specifikohen metodologjitë, në të ardhmen kur të vijë raporti të jetë më përmbajtësor dhe më i detajuar për neve si assemble. Të kemi për secilin biznes që vlerësohet formularin përkatës, çmimoren sipas Agjencisë së Statistikave, sepse edhe rregullorja e parasheh që duhet të ketë një vlerë referente të çmimeve, jo vetëm të vendosen çmime të përgjithshme. E kuptoj që nuk është e lehtë, mirëpo sa i përket volumit të madh të bizneseve, neni 12 i

rregullores e lejon që të ketë numër më të madh të komisioneve. Kështu që kërkoj që edhe në të ardhmen, për të pasur një bashkëpunim sa më efikas në kuadër të komisionit, mundësisht të ketë edhe ekonomistë. Unë e pashë që nuk kishte ekonomistë në komision. E di që është vazhduar me përbërjen e njëjtë si më herët, por do të ishte mirë të përfshihen edhe ekonomistë, sepse kanë të bëjnë me llogaritje ekonomike. Unë jam me profesion inxhinier, por e pashë që ka nevojë edhe për ekonomistë. Kështu që për të ardhmen, le të jetë formulari për secilin rast, fotografitë dhe çmimoret sipas Agjencisë së Statistikave. Besoj që kjo do të ishte më korrekte dhe, siç u tha edhe nga kolegu, nëse kërkohet auditim, këto të shërbejnë si dëshmi apo prova.

Igabllë Islami: Meqenëse nënkryetari nuk ishte këtu gjatë diskutimit tim mbi raportin e vërshimeve, dua shumë shkurt të rikthehem pa u përsëritur, sepse disa asambleistë kanë qenë të pranishëm dhe janë drejtuar edhe nga drejtoresha. Më intereson të di, meqenëse tash e kemi raportin, dhe kryetari në mbledhjen e kaluar ka thënë që në momentin kur raporti të jetë gati do të ketë subvencionim: a pritet të ketë subvencionim për këto kategori që janë prekur nga vërshimet?

Gjithashtu, nga ana procedurale, dua të di: a mundet Kuvendi Komunal ta miratojë raportin duke e larguar pjesën e bizneseve? Pra, a kemi të drejtë ta miratojmë raportin pa pjesën e bizneseve, apo duhet të konsiderohet si raport i plotë.

Kryesuesi i Kuvendit: Po, përgjigjja është që mbetet obligim i ekzekutivit me themelun një komision dhe me hyrë në rivlerësim vetëm sa i përket bizneseve, ndërsa pjesa tjetër e raportit aprovohet dhe procedohet tutje. Domethënë, kjo bëhet pjesë e vendimit, ndërsa pjesa për bizneset trajtohet me një vendim të veçantë që i referohet të njëjtës periudhë kohore.

Nënkryetari i Komunës z. Enis Osmani: Sa i përket subvencionimit, ne e kemi rishikuar raportin dhe e kemi analizuar me shumë kujdes. Ekonomistë familjare, nëse e kuptoj saktë, janë rreth 295.000€ afërsisht 300.000€. E di që ka qenë kështu. Duhet me e kqyr edhe buxhetin. Ju e dini, ti ke qenë drejtoreshë e financave dhe i njeh linjat buxhetore. Ne duhet me e pa çka mundemi me bë dhe me u dalë në ndihmë këtyre familjeve. Për momentin jemi duke e analizuar dhe duke e rishikuar se prej cilave burime mund të veprojmë dhe çka mund të bëhet, për ta analizuar raportin saktësisht.

Kushtrim Zeneli: Veç një pyetje për Gëzimin, se nuk e dëgjova mirë për raportin e vërshimeve, për pikën e Bajrit, atë raport, se nuk e dëgjova qartë përgjigjen, dhe tani kam edhe një koment.

Gëzim Stavilevci: E theksova se i kemi subvencionuar me nga 10.000€

Kushtrim zeneli: E përshëndes propozimin e ekzekutivit dhe të nënkryetarit që bizneset të tërhiqen prej kësaj pike. Po ashtu propozoj nuk po dua me u përzi shumë në këtë çështje por mendoj që ndoshta do të ishte mirë të formohet një komision krejt tjetër, jo ky komision që e ka bërë raportin e vlerësimeve të vitit 2023 dhe as ky i tanishmi. Sa për me e thënë hapur, një biznes në katin e dytë nuk po dua me përmend emra ka pasur vlerësim 140.000€ ndërsa një restorant te liqeni ka pasur 2.000€ dhe një restorant në qendër ku kemi pi kafe ditën e vërshimeve ka pasur 12.000€ Nuk po hyj në detaje, por po flas për raportin e vitit 2021–2023. Kështu që ka dallime të mëdha në vlerësime. Edhe një gjë tjetër: nuk kam pasur qëllim tendencioz ndaj drejtorit, ndaj teje apo ndaj askujt në seancën e kaluar. Kam folur vetëm për raportin. Edhe këtu mos i përzieni raportet raporti i rrëshqitjeve të dheut dhe raporti i vërshimeve janë dy çështje të ndryshme. Ju lutem të mos i ngatërroni, sepse janë dy raporte krejt të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit: Unë besoj që ju po i ngatërroni këto çështje, sepse ne në Kuvend kemi sjellë raportin e dëmeve të janarit 2026, dhe realisht duhet të përqendrohemi në këtë raport, jo të hyjmë në çështje të tjera që nuk janë në rend dite. Të koncentrohemi dhe të jemi sa më praktikë në pikat që po i diskutojmë.

Atëherë, kush është që raporti të aprovohet me vërjetjet e dhëna nga drejtoresha tek ekonomit familjare të bëhet përmirësimi me numër rendor 92 prej 930 € të rrugullohet në 3,290 € dhe që raporti i bizneseve të tërhiqet dhe të mbetet çështje e ekzekutivit që ta themelojë një komision dhe ta bëjë rivlerësimin e dëmeve të cilat kanë ndodhur aty.

Rezultati i votimit: 28 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesi konstaton se 28 anëtarë janë prezent në sall dhe miratohet Raporti.

Pika 8

Gazmend Gjoshaj: Para jush e keni raportin financiar për vitin 2025, i cili nuk ka nevojë të aprovohet. Raporti paraqet të hyrat vetanake, buxhetin dhe shpenzimet në nivel të kategorive ekonomike dhe nënprogrameve, llogaritë e arkëtueshme, obligimet financiare, obligimet kontraktuale, detyrimet kontingjente si dhe lëndët e ekzekutuara përmes procedurave përmbarimore. Të dhënat e raportit janë të siguruara nga sistemi i tri bilancit. Për çdo pyetje apo sugjerim mundemi me e diskutuar nëse keni ndonjë vërejtje.

Kryesuesi i Kuvendit: Pajtohem me ty drejtor që ligji nuk e thotë që raporti duhet të aprovohet, por për shkak të performancës është mirë me u aprovu, sepse merret si poentë pozitiv, ndërsa obligim ligjor nuk e kemi.

Igabllë Islami: Kryesues, meqenëse ju e përmirësuar drejtorin se realisht raporti miratohet për shkak të performancës, ndërsa sot edhe nëse nuk miratohet fare, unë po ju them që nuk luan kurrfarë roli, sepse është obligim ligjor që i njëjti të miratohet në janar për të arritur pikët në performancë. Sot, nëse u miratua apo nuk u miratua, nuk është se do të ndikojë pozitivisht në performancë. Miratimi ose mosmiratimi i këtij raporti financiar, meqenëse afati për shqyrtimin e tij sipas performancës ka qenë në janar të vitit 2026. Realisht më takon edhe ta vlerësoj raportin financiar janar–dhjetor 2025 dhe unë uroj që të vazhdojë menaxhimi i kujdesshëm financiar, pa marrë parasysh kush udhëheq komunën dhe drejtorinë e financave. Ndërsa, si pyetje, e kam: sa është shuma e mjeteve vetanake të pashpenzuara të ndara në kategori ekonomike dhe kur pritet që neve si Asamble Komunale të na vijë bartja e tyre?

Kushtrim Zeneli: Në faqen 24 të raportit paraqiten disa obligime kontraktuale në vlerë prej 16.2 milion €, ndërsa vlera për pagesë është 9.2 milion € na sqaroni këtë. Në faqen 25, detyrimi kontingjent në vlerë 6.9 milion € është rritur nga 3.2 milion sa ka qenë në vitin 2023 në 6.9 milion në vitin 2025. Po ashtu, një çështje shumë shqetësuese është se borxhet për tatimin në pronë janë rritur nga 8.9 milion € në vitin 2023 në 12.2 milion € në vitin 2025. Ndoshta është mirë të na shpjegohet si ka ardhur kjo, dhe po ashtu kam edhe disa çështje të tjera që janë me interes për qytetarët. Këto tre çështje që i ngrita, janë shumë në interes të qytetarëve. Fola për faqen 24 dhe 25, si dhe për faqen 17, ku paraqiten disa borxhe dhe rritje të tyre, dhe ndoshta do të ishte mirë të jepet një shpjegim, sidomos për tatimin në pronë dhe për obligimet kontraktuale dhe detyrimet kontingjente. Po ashtu, disa çështje të tjera që desha t'i ngrit janë se po flitet shumë në qytet dhe na intereson të dimë: kontrata për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore (DVM), e cila ka kushtuar rreth 500.000 €. Ajo që na shqetëson është se kontratat trevjeçare janë shpenzuar pra kontratat që janë paraparë për tre vite janë konsumuar brenda vetëm një muaji. Këtu i kam dy pyetje: si është e mundur që buxheti i paraparë për tre vite të konsumohet për një muaj? Dhe e dyta, mund të na shpjegoni pak ku kanë përfunduar konkretisht këto mjete? Çështja tjetër lidhet me projektin për qent endacak. Kemi parë edhe disa lajme në media dhe kemi dëgjuar që edhe krimet ekonomike janë duke e hetuar këtë rast. Ndoshta është mirë të na tregoni pak më shumë për këtë çështje, deri ku ka shkuar procedura dhe cila është gjendja aktuale. Edhe e dyta, mund të na shpjegohet pak më shumë.

Kryesuesi i Kuvendit: Drejtor të lutem merr shenime dhe në fund pastaj përgjigjesh. Po ashtu edhe unë me thënë të drejtën çar më ka rënë ky dy çështje diçka s'po mj e i kam të qarta tjetër a ka mundësi me shpjegu ose është bërë ndonjë ga abela numër 11, faqe 17, pika e katërt e raportit të hyrave ku thuhet: tatimi në pronë në vitin 2025 ka të hyra 12,206,000.323 cent, ndërsa gjithsej të hyra janë 16,927,000 € A po i lexoj drejt?

Gazmend Gjoshaj: Kryesues jo nuk është e drejtë, këto janë borxhet që na kanë neve si komunë.

Igabllë Islami: Nuk është pyetje që më është adresuar mua, por ndjej obligim të sqaroj që nuk desha ta elaboroj shumë raportin financiar. Megjithatë, ajo që bie në sy është tejkalimi i të hyrave vetanake

komunale. 3.9 milion € janë të hyra vetanake, ndërsa në planifikim kanë qenë 3.6 milion € dhe pikërisht tatimi në pronë e ka tejkaluar planin e të hyrave, duke inkasuar gjatë vitit 2025 1.4 milion €. Tabela të cilës ju, kryesues, i referoheni është tabela e llogarive të arkëtueshme. Kjo ngritje ka ndodhur për shkak të vlerësimit të pronave komunale rezidenciale dhe tokave biznesore të bërë nga departamenti i tatimit në pronë. Ne kemi ngritur gjithmonë si çështje që qytetarëve të komunës, jo vetëm të Mitrovicës por gjithandej Kosovës, u është rritur vlera e tatimit të vlerësuar. Dhe padyshim kjo ka reflektuar edhe në llogaritë e arkëtueshme, edhe pse Drejtoria për Buxhet dhe Financa ka inkasuar 1.4 milion € më shumë se plani i paraparë.

Kryesuesi i Kuvendit: Sa i përket obligimeve kontraktuale për dhjetor 2025 vlera e kontratës, vlera e shpenzuar, vlera e mbetur e kontratës dhe afati i mbetur në muaj po i referohem faqes 19. Në faqen 19 thuhet: “Intervenimi emergjent për fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera ekstreme gjatë forcave madhore”. Kontrata është 36 muaj. Vlera e kontratës është 495,000 € muajt e mbetur prej 36 janë 35, që do të thotë se për një muaj janë shpenzuar rreth 500,000 € A ka mundësi drejtori me e shpjegu këtë fenomen?

Gazmend: Sipas raportit të komisionit, për një muaj janë shpenzuar këto mjete.

Nënkryetari i Komunës z. Enis Osmani: Kryesues, ke të drejtë me këtë potencim. Është shqetësuese kjo që ka ndodhur dhe për mua, në këtë pozicion që kemi. Vlera e kontratës ka qenë rreth 500.000 € Për një muaj, sipas raportit që kam parë unë, janë shpenzuar pothuajse të gjitha mjetet që kanë qenë të planifikuara për tre vite. Kjo është shpenzuar brenda një muaji. Po ashtu, në raport shihet që një lum është pastruar tre herë brenda një dite në komunën e Mitrovicës. Nuk e kam për t’ju akuzuar juve, mirëpo atë komision që e ka bërë këtë raport e konsideroj shumë problematik. Me u harxhu mjete që janë të parapara për tre vite brenda një muaji, për mua si ekonomist kjo nuk është reale. Edhe drejtoresha e di shumë mirë këtë. Kontrata ka qenë e paraparë për 36 muaj, ndërsa rreth 90% e mjeteve janë shpenzuar për vetëm një muaj. Kjo është shqetësuese dhe, aq më tepër, në qershor të vitit të kaluar nuk ka pasur as vërshime, as tërmete. Nuk e di si janë kryer këto intervenime. Unë po flas në bazë të asaj që po shoh në raport: një lum është pastruar tre herë. Çfarë ka ndodhur saktësisht nuk e di, ndoshta ju e dini më mirë, ndoshta dikush ju ka orientuar gabim, por unë po flas për atë që kam parë në dokumente. Nuk dua të keqkuptohem, siç është keqkuptuar më herët një deklaratë tjetër. Por ajo që po them është e bazuar në raport. Kështu që, për mua kjo është shumë shqetësuese. Pa vërshime, pa tërmete, janë shpenzuar 500.000 € brenda një muaji.

Valon Brahim: po ndërlidhem pak me diskutimin e kryetarit për këtë kontratë. Ne e dimë që kontratat kanë fillim dhe mbarim, por kjo nuk do të thotë që me përfundimin e afatit përfundojnë edhe shpenzimet. Nëse rrethanat kanë qenë të paparashikuara dhe kanë dalë shpenzime shtesë, atëherë mund të ndodhë edhe në të ardhmen që të kemi situata të ngjashme. Duhet me u mirëkuptu nëse punët janë kryer. Nëse nuk janë kryer, si anëtar i Kuvendit Komunal, pavarësisht kush ka qenë në qeverisje, nëse vërehet keqpërdorim i detyrës apo i parasë publike, duhet me u trajtu seriozisht. Por në këtë rast, unë nuk shoh që ka pasur keqpërdorim, sepse pagesat janë bërë për punë të kryera nga operatorët. Ndoshta ka pasur nevojë që lumi të pastrohet më shumë herë, nuk po them që jam pjesë e komisionit, por po e analizoj situatën siç është. Ju inkurajoj që këto tema mos me i trajtu vetëm politikisht. Nëse jeni të bindur që ka shkelje, obligimi ligjor është me e adresu edhe penalisht. Nëse nuk ka shkelje dhe punët janë kryer për shkak të nevojës, atëherë duhet me qenë më korrekt dhe më konstruktiv në diskutim. Nëse ka dyshime për keqpërdorim, atëherë mos na i adresoni vetëm neve si anëtarë të Kuvendit, por drejtojini në prokurori. Edhe ne si Kuvend kemi obligim me vepru nëse ka dyshime. Nuk ka rëndësi kush ka qenë në pushtet. Por duhet me e ndjekur rrugën institucionale. Menaxheri i kontratës ka përgjegjësi për zbatimin e saj, jo domosdoshmërisht kryetari. Prandaj duhet me u drejtu te përgjegjësit e kontratës. Akuzat publike pa prova nuk janë të mira. Nëse ekzistojnë dyshime serioze, ato duhet të adresohen në institucione përkatëse.

Xhylljeta Imeri: Tek investimet kapitale: figuron që janë realizuar 85%. Në realitet, kjo nuk është shifër reale, duke marrë parasysh që në shumë objekte figuron sikur projektet janë realizuar. Por në fakt, këtu janë përfshirë edhe mjete që janë marrë përmes përmbarimit. Pra, janë mjete të tërhequra nga përmbaruesi. Unë këtë e kuptoj, sepse nga kontratat kolektive kanë pësuar të gjitha komunat. Megjithatë, realisht kjo nuk paraqet gjendjen e vërtetë.

Erseka Barani: Kam dashur të ndalem te investimet kapitale, pasi ato ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e qytetarëve, figuron se janë shpenzuar 6,909,000 € por 3,225,000 € kanë shkuar përmes përmbarimit, që do të thotë se pothuajse gjysma e projekteve nuk janë realizuar realisht.

Shumë projekte që figurojnë si të përfunduara, në terren nuk ekzistojnë. Konkretisht, në faqen 21 paraqiten si të realizuara, por mungojnë në praktikë. Për këtë kërkoj sqarim nga ekzekutivi.

Po ashtu, Komuna e Mitrovicës ka përfituar 700,000 € nga Fondi i Eficiencës së Energjisë për disa projekte të rëndësishme, por këto nuk janë realizuar siç duhet dhe marrëveshjet përkatëse nuk janë paguar. Kjo është shqetësuese, sepse rrezikojmë të humbim mundësinë për përfitime të reja nga ky fond. Prandaj, kërkoj që kjo çështje të trajtohet me seriozitet, pasi investimet kapitale janë thelbësore për përmirësimin e jetesës së qytetarëve.

Igballe Islami: Duke mbrojtur rolin tim si anëtare e asamblesë dhe e opozitës, theksoj se nga raporti financiar janar–dhjetor 2021 rezultoi se rreth 3 milionë € kanë qenë të pasqyruara, në kohën kur edhe disa nga ju keni qenë pjesë e ekzekutivit apo asamblesë.

Sa i përket kontratës për emergjencë: menaxhimi i saj është përgjegjësi e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit. Drejtorja e financave është e obliguar të kryejë pagesën brenda 30 ditëve pasi krijohet obligimi financiar. Mënyra e realizimit të punëve nuk është përgjegjësi e drejtorit të financave.

Rregullativa për shpenzimin e parasë publike është e qartë dhe përcakton saktë përgjegjësit për procedimin e pagesave.

Sa i përket fondit të eficiencës: obligimet nga marrëveshjet e mëhershme janë paguar pjesërisht (137,000 € dhe 37,000 € në vitin 2022). Obligimet e mbetura kanë ardhur si pasojë e mospërputhjeve ndërmjet prokurimit dhe financave dhe janë propozuar të mbulohen përmes subvencioneve.

Kjo situatë lidhet edhe me kufizimet buxhetore, pasi komuna ka pasur rreth 1.2 milion € në dispozicion, duke e bërë të pamundur mbulimin e të gjitha obligimeve.

Kryesuesi i Kuvendit Meqenëse nuk ka të lajmëruar për diskutim atëherë e hedh në votim Raportin financiar të komunës për realizimin e buxhetit komunal janar - dhjetor 2025.

Rezultati i votimit: 25 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesi Konstaton të miratuar Raportin financiar të komunës për realizimin e buxhetit komunal janar - dhjetor 2025.

Pika 9

Kryesuesi i Kuvendit: Bëhet fjalë për propozim-vendimin për subvencionimin e familjeve Peci dhe Avdyli, të cilat kanë humbur familjarët në një aksident trafiku në Itali. Vlera totale është 6,000 € përkatësisht nga 3,000 € për secilën familje. Ky propozim ka ardhur nga Drejtorja e Mirëqenies Sociale përmes kryetarit të komunës. A ka dikush për diskutim rreth kësaj çështjeje?

Valon Brahimi: Faleminderit kryesues. Fillimisht shprehim ngushëllimet për këtë rast të dhimbshëm, pasi humbja e dy të rinjve është e rëndë jo vetëm për familjet, por për gjithë qytetin. Në parim e përkrahim ndihmën për familjet, por vlerësoj që shuma prej 3,000 € për familje është e vogël. Prandaj propozoj që të rritet në 5,000 € për familje, duke pasur parasysh që mund të ketë mjete në dispozicion. Ky është një propozim që mendoj se duhet të merret në konsideratë nga drejtorja përkatëse.

Nënkryetari i Komunës z. Enis Osmani: Kostoja e ndihmës për këto dy familje ka qenë rreth 2,000 € sipas informatave nga familjarët. Ne kemi vlerësuar që, duke përfshirë shpenzimet për ushqim dhe nevoja të tjera, të shtohet edhe 1,000 € dhe kështu shuma është rritur në 3,000 €. Kjo është bërë brenda mundësive buxhetore që kemi pasur në dispozicion.

Valon Brahimi: Unë, kryesues, kam menduar se familjarët për një kohë nuk do të jenë në gjendje, as psikologjikisht, të mirë për të kryer punë të zakonshme dhe për të përfituar të ardhura. Nuk e di nëse kanë qenë mbajtës të familjes, nëse kanë qenë të martuar apo kanë lënë fëmijë, sepse nuk kemi informacione të mjaftueshme për këtë rast. Dëshira ime ka qenë që shuma të ishte 5,000 € por duke marrë parasysh mundësitë buxhetore, ne e përkërahim edhe me shumën prej 3,000 €

Kryesuesi i Kuvendit Meqenëse nuk ka të lajmëruar për diskutim atëherë e hedh në votim Propozim vendimin për mbështetje financiare të familjeve Peci dhe Avdyli.

Rezultati i votimit: 25 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesi Konstaton të miratuar vendimin për mbështetje financiare të familjeve Peci dhe Avdyli.

Pika 10

Kryesuesi i kuvendit sa i përket propozimit për formimin e komisionit për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në institucionet edukative-arsimore, është obligim ligjor i Kuvendit ta miratoj. Përbërja e komisionit është: Zyrtar i lartë ligjor nga DKA z. Valon hetemi, z. Sinan Tupella Drejtor i shkollës fillore, Një përfaqësues nga Ministria e Arsimit U theksua se komisioni ka për detyrë zhvillimin e procedurave të përzgjedhjes së drejtorëve të shkollave. E hap për diskutim.

Igballe Islami: Theksoj se kjo pikë është e njëjtë me çështjen paraprake, por për shkak të ndjeshmërisë nuk është diskutuar më herët, ndërsa tani konsiderohet si e domosdoshme. Bëhet fjalë për propozim-vendimin për formimin e komisionit për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve. U ngrit shqetësim se propozimi ka ardhur si pikë shtesë e rendit të ditës, por nuk është i kompletuar si dokument zyrtar, pasi mungojnë vula dhe protokoll, dhe si i tillë nuk duket të jetë material i rregullt për shqyrtim. Sa i përket përbërjes së komisionit, u theksua se nuk ka ankesa për individët e propozuar, por u shpreh pritja që procesi të udhëhiqet në mënyrë sa më transparente dhe profesionale. Gjithashtu u theksua rëndësia që procesi i përzgjedhjes të jetë i drejtë dhe ligjor, duke shmangur çdo ndikim politik apo nepotizëm, duke marrë parasysh edhe përvojat e mëhershme në emërimet e drejtorëve.

Kryesuesi hedh në votim

Kryesuesi i Kuvendit Meqenëse nuk ka të lajmëruar për diskutim atëherë e hedh në votim Propozim vendim për formimin e Komisionit për zgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendëso drejtorëve në institucionet edukativo arsimore dhe aftësuese me emërat të cilat i citoj më lart.

Rezultati i votimit: 25 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesi Konstaton të miratuarin vendimin për formimin e Komisionit për zgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendëso drejtorëve në institucionet edukativo arsimore dhe aftësuese me përbërjen e cekur më lartë po ashtu konstaton se të pranishëm në sallë janë 25 anëtarë.

Pika 11

Kryesuesi i Kuvendit: Sa i përket propozim vendimit për formimin e komisionit për rivlerësimin e gjendjes ekonomiko-sociale të familjeve përfituese, do të përbëhet nga dy anëtarë nga Kuvendi dhe tre anëtarë nga ekzekutivi i komunës. Atëherë kërkoj nga ekzekutivi tre emëra. u nga Nënkryetari i Komunës z. Enis Osmani nga ekzekutivi propozojm Ardian Kavaja, Ramadan Beshiri dhe Arjeta Beqiri Hyseni. Në diskutim u theksua se është e rëndësishme që të sigurohet edhe përfaqësimi i opozitës në këtë komision, duke pasur parasysh se pjesa më e madhe e përbërjes vjen nga ekzekutivi.

U vazhdua me propozimin për përbërjen e komisionit, ku u propozua që nga Kuvendi të përfshihen edhe anëtarë shtesë për të siguruar përfaqësim më të balancuar politik.

Igballe Islami nga GP i PDK-së propozojm z. Shkëlqim Ibrahim .

Xhyljeta imeri nga GP i LDK-së znj. Arta Neziri.

Pas propozimeve, u konstatua përbërja përfundimtare e komisionit si vijon:

Ardian Kavaja

Ramadan Beshiri

Arjeta Beqiri Hyseni
Shkëlqim Ibrahim
Arta Neziri

Kryesuesi i Kuvendit atëherë e hedh në votim Propozim vendim për formimin e Komisionit për rivlerësimin e gjendjes ekonomiko sociale të familjeve përfituese me përbërjem të cilën e citoj më lart.

Rezultati i votimit: 25 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesi Konstaton të miratuarin vendimin për formimin e Propozim vendim për formimin e Komisionit për rivlerësimin e gjendjes ekonomiko sociale të familjeve përfituese me përbërjen e cituar më lartë.

Pika 12

Shyljeta Imeri: Që nga mandati i kaluar kam kërkuar rregullimin e rrugës “Fazli Barani”, e cila ndodhet tek ish hortikultura. Në atë kohë kjo zonë ka qenë në mbikëqyrjen e Ministrisë së Bujqësisë dhe pushteti lokal nuk ka pasur kompetencë të vazhdojë punimet aty. Prandaj sot po rikërkoj me këmbëngulje asfaltimin e kësaj rruge, e cila, ndonëse është një segment i shkurtër, është urgjent dhe ndodhet në një zonë qendrore. Përveç faktit që është shumë e frekuentuar, me rritjen e temperaturave qarkullimi i automjeteve shkakton pluhur të madh, duke vështirësuar jetën e banorëve përreth dhe duke rrezikuar shëndetin e tyre, përfshirë edhe timin, pasi aty banoj. Njëkohësisht kërkoj që të realizohet ndërtimi i trotuarit dhe vendosja e ndriçimit publik, në mënyrë që të lehtësohet lëvizja e qytetarëve dhe të rritet siguria për të gjitha moshat. Këtë kërkesë e drejtoj tek Drejtoria e Infrastrukturës dhe Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor. Nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor kërkoj që në të njëjtën zonë, tek magazinat e ish hortikulturës, të cilat i keni pastruar para një jave për çka ju përgëzoj të propozohet që kjo hapësirë të shndërrohet në park rekreativ për të moshuar, të rinj dhe fëmijë. Kjo hapësirë ka potencial të mjaftueshëm dhe është e nevojshme për zonën, sidomos duke pasur parasysh ndërtimin e dendur të objekteve banesore në këtë pjesë, çka rrit dukshëm nevojën për hapësira të gjelbra dhe rekreative. Investime të tilla nuk janë vetëm përmirësim i infrastrukturës, por edhe investim i drejtpërdrejtë në mirëqenien, shëndetin dhe jetën më cilësore të qytetarëve. Drejtor, nëse shndërroni këtë hapësirë në park, do të mbetet histori. Nuk do të përmendet se kush e ka propozuar, por kush e ka realizuar, sikurse ndodh zakonisht. Një kërkesë tjetër për Drejtorinë e Infrastrukturës. Në lagjen Shipol gjendet shkolla “Fazli Dajçevci” me rreth 800 nxënës dhe afro 70 mësimdhënës. Çdo ditë qindra fëmijë kalojnë në një rrugë ku mungojnë kushtet bazë të sigurisë: nuk ka vija të bardha për këmbësorë, nuk ka shenja paralajmëruese për praninë e shkollës dhe nuk ka kufizim të qartë të shpejtësisë. Pas hapjes së çerdhes “Dritë Dielli”, qarkullimi është rritur dhe bashkë me të edhe rrezikshmëria. Kjo është një kërkesë e vazhdueshme e banorëve të Shipolit dhe me të drejtë. Prandaj, nga Drejtoria për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë kërkoj: vendosjen e vijave të bardha për këmbësorë, vendosjen e shenjave paralajmëruese për shkollë, vendosjen e kufizimit të shpejtësisë në këtë zonë. Siguria e fëmijëve nuk pret. Çdo ditë pa veprim është një rrezik më shumë. Kjo çështje duhet të trajtohet me urgjencë dhe të ndërmerren masa konkrete sa më parë.

Egzon Sadiku: Sa i përket largimit të deponive ilegale, kam një pyetje konkrete. Kush e ka kontratën për largimin e deponive ilegale? A është me “Unitetin” apo me ndonjë operator tjetër? Nëse është me “Unitetin”, si po realizohet largimi nga operator tjetër? Pyetja kryesore është: kur largohen deponitë ilegale, ku dërgohen mbeturinat? A po dërgohen në deponi të rregullta apo po zhvendosen në zona të tjera periferike?

Nënkryetari i Komunës z. Enis Osmani: Të nderuar asamblastë, të gjitha deponitë ilegale i largon kompania që ka kontratë për këtë shërbim. Nuk bëhet fjalë për dy operatorë të ndryshëm. Uniteti merret me pastrimin e mbeturinave në hapësirat publike, ndërsa kontrata për largimin e deponive ilegale është e veçantë. Nuk kam informacion të saktë për emrin e operatorit, por kontrata është aktive. Sa i përket

destinimit të mbeturinave, ato dërgohen në vendet e përcaktuara ligjërisht, jo në zona të tjera ilegale. Do të kërkoj përgjigje dhe do t'ju njoftoj në seancën e ardhshme për detaje më të sakta.

Egzon Sadiku: Nuk e di saktësisht sa i përket marrëveshjes së kryetarit për shërbimet e fshirjes dhe larjes së rrugëve, por edhe për largimin e deponive ilegale, kjo është kompetencë dhe marrëveshje vetëm me “Unitetin”. Nuk bëhet largimi me operatorë të tjerë, në këtë rast as me operatorin e rrënimit apo kanalizimit. Sa i përket çështjes tjetër, kam kërkuar raport nga “Uniteti”, pasi informacionin që e kam është 100% i sigurt që do ta marr edhe me shkrim. Mbeturinat nuk dërgohen në mënyrë të tillë që të krijohen deponi të reja ilegale, por trajtohen dhe dërgohen në deponi legale.

Nënkryetari i Komunës z. Enis Osmani: Më vjen keq, por kjo është e pasaktë dhe e pavërtetë. Në një nga seancat e ardhshme do ta sjell përgjigjen, pasi kam për të pyetur dhe për ta sqaruar këtë çështje. Megjithatë, nuk guxon të ndërhyjë dikush tjetër në këtë proces, kështu që po e mbaj fjalën këtu.

Lavdim Zeneli: Për Drejtorinë e Shërbimeve Publike: Lagjja “Mehmet Akif Ersoi” në Bajt ka një kohë të gjatë pa ndriçim publik. Cilat janë arsyet e moszgjidhjes së këtij problemi deri më tani dhe kur pritet të ndërmerren masa konkrete për rikthimin e ndriçimit?

Elfate Ademi Bahtiri: Për Drejtorinë e Kulturës kërkoj një raport financiar për katër vitet e fundit lidhur me teatrin, pasi janë ngritur shqetësime për keqpërdorime.

Valon Brahim: Kam vërejtur që janë vizituar shkollat në qytetin e Mitrovicës. Disa arsimtarë kanë vështirësi me parkingun. Propozoj që të shqyrtohet mundësia e një sistemi digjital për parkingun e mësimdhënësve, sidomos në shkollat e mesme. Për Drejtorinë e Administratës: Çfarë po ndodh me pagesën e dy pagave e gjysmë për punëtorët e pastrimit në komunën e Mitrovicës? Kërkoj vetëm informatë, jo zgjidhje të menjëhershme.

Egzon Sadiku: Për Drejtorinë e Infrastrukturës dhe Inspeksionit: Pyetja e parë lidhet me zbatimin e kontratës për asfaltimin e rrugëve në Zhabar të nënshkruar vitin e kaluar. Kur do të realizohet? Pyetja e dytë lidhet me një parcelë pranë pishinës “Labaja”, ku është bllokuar hyrja nga një person privat, ndonëse nuk është pronë e tij.

Mujë Igrishita: E njëjta ka ardhur si kërkesë edhe nga banorët, kështu që është në procedurë shqyrtimi. Besoj që edhe kolegu më herët e di si shkon procedura. Janë afatet ligjore kohore dhe besoj që, në përputhje me to, do të realizohet.

Kryesuesi i Kuvendit i mbylli punimet e mbledhjes së 7-të të rregulltë të Kuvendit të Komunës në ora 15:20 min.

Mitrovicë

Procesmbajtëse:

Kryesuesi i Kuvendit

Afërdita MAXHUNI

Safet KAMBERI



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës së Jugut

Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South



DATË/A:	16.04.2026
REFERENCË:	02-01-052/01-0020586/26
PËR/ZA/TO:	z. Faton PEÇI – Kryetar i Komunës
CC:	z. Safet KAMBERI – Kryesues i Kuvendit Komunal dhe Anëtarët e Kuvendit të Komunës
NGA/OD/FROM:	z. Bedri MUJA – Kryetar i Komisionit për Hartimin e Draft – Rregullore për Plotësim-Ndryshimin e Rregullore Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale dhe Rregullore për Plotësim Ndryshim të Rregullorës 02/2024
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raport mbi procesin e hartimit të Draft – Rregullore për Plotësim-Ndryshimin e Rregullore Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale dhe Rregullore për Plotësim Ndryshim të Rregullorës 02/2024

Bazuar në Ligjina Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës së Mitrovicës së Jugut Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, nenin 14, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5, të Rregulloren (MAPL) Nr. 02/2021 Për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës, nenin 32, paragrafi 1 dhe Vendimi nr. prot. 01-020/04-0005970/26 të datës 02.02.2026, Komisioni për Hartimin e Rregullore për Plotësim-Ndryshimin e Rregullore Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale dhe Rregullore për Plotësim Ndryshim të Rregullorës 02/2024, paraqet këtë:

Raport mbi procesin e hartimit të Draft – Rregullore për Plotësim-Ndryshimin e Rregullore Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale dhe Rregullore për Plotësim Ndryshim të Rregullorës 02/2024.

Komisioni i formuar me Vendim nr. prot. 01-020/04-0005970/26 të datës 02.02.2026 për Hartimin e Rregullores për Plotësim-Ndryshimin e Rregullores Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale dhe Rregullores për Plotësim Ndryshim të Rregullorës 02/2024, tutje: “Komisioni”, ka zhvilluar procedurën për hartimin e draftit të Rregullores për Plotësim-Ndryshimin e Rregullores Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale, tutje: “Rregullores” konform dispozitave të Rregullores (MAPL) Nr. 02/2021 Për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës dhe aktet tjera relevante.

Në hapin e parë të zhvillimit të këtij procesi me datë 10.02.2026 në cilësi të kryetarit të komisionit iu drejtova me email drejtorëve të drejtorive në Komunën e Mitrovicës së Jugut, njërive që kanë rol të veçantë në administratën e komunës, përfshirë dhe nënkryetarin e komunës që deri me datë 12.02.2026 në përfundim të orarit ti dërgojnë propozimet e tyre, me qëllim të përfshirjes së tyre në rastin e hartimit në draftin e kësaj rregullorje.

Rreth kësaj çështje nuk kemi pranuar zyrtarisht propozime të kësaj natyre.

Në zhvillim të këtij procesi, Komisioni pasi hartoj Draftin fillestar të Rregullores iu drejtohet me email Zyrës Ligjore të Komunës, Udhëheqësi për Buxhet dhe Financa, Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore dhe Njësisë për Barazi gjinore me njoftimin për hartimin e draftit të kësaj rregulloreje me qëllimin e marrjes së konfirmimit nëse drafti I rregullores të hartuar është në harmoni me dispozitat ligjore, mundësitë financiare dhe organizative.

Me datë 16.02.2026 Zyra Ligjore sipas emailit të datës 16.02.2026 ka jep sugjerimet e veta të detajuara për të cilat komisioni mori parasysh dhe si të tilla i implementoj në draftin e rregullores. Përveç këtij konsultimi formal komisioni ka pasur herë pas here konsultime të brendshme me zyrën ligjore, të cilat janë zhvilluar në mënyrë jo-formalisht.

Me datë 16.02.2026 kemi pranuar email nga Udhëheqësi për Buxhet dhe Financa I cili në cilësi të zyrtarit kryesor financiar I cili në paragrafin e fundit të përgjigjes së tij thotë se: “Nga këndvështrimi buxhetor-financiar, Draft-Rregullorja nuk paraqet implikime shtesë financiare në buxhetin e aprovuar për vitin 2026, me kusht që organizimi dhe funksionimi i njërive të përfshira të mbetet brenda kornizës së ndarjeve buxhetore ekzistuese deri në rishikimin e buxhetit”. Meqense krijimi I kodit të ri buxhetor nuk mund të realizohet në këtë fazë të vitit fiskal, Sipas përgjigjes në këtë email Krijimi I kodit të ri buxhetor mund të bëhet vetëm në kuadër të procesit të rishikimit të buxhetit dhe pas marrjes së aprovimeve dhe lejitimeve të nevojshme nga Ministria e Financave, përkatesisht përmes reflektimit në sistemin BDMS.

Ndërsa me emailin e datës 16.02.2026 komisioni pranoi email nga Zyrtarja për Barazi Gjinore konfirmoj se për këtë akt plotësues vlerësoj se nuk cenon, ndryshon apo kufizon parimet e barazisë gjinore të përcaktuara në legjislacion. Po ashtu terminologjia e përdorur në këtë Rregullore është neutral dhe zbatohet në mënyrë të barabartë për të gjitha gjinit.

Gjatë kësaj faze komisioni është takuar herë pas here me qëllimin e hartimit dhe finalizimit të këtij aktit.

Në zhvillim të këtij procesi Komisioni ka publikuar Draft Rregulloren dhe po ashtu njoftimin për konsultim publik dhe mundësin e dërgimit të rekomandimeve, opinioneve apo vërejtjeve nga ana e publikut të interesuar deri me datë 06.03.2026. Me datë 27.02.2026 (e premte) në ora 10⁰⁰, në sallën e Kuvendit Komunal është mbajtur konsultimi publik ku në seancë kanë prezantuar gjithsej 12 persona. Ecuria e procesit është pasqyruar detajisht në Raportin nga Konsultimi Publik të datës 10.03.2026 nga Kryetari I Komisionit. Përmbledhur si informacion në këtë diskutim Publik nuk ka pasur kërkesë, komente apo rekomandime për ndryshime shtesë jashtë Draftit të punuar nga Komisioni, përveç se të pranishmit kërkuar sqarime shtesë jo formale lidhur me ndryshimet e propozuara në këtë Draft.

Përveç kësaj në kuadër të konsultimit publik është ofruar mundësia që publiku deri me datë 06.03.2026 (e premte) dhe në vijim nuk kemi pranuar ndonjë sugjerim apo koment në email adresë. Komisioni deri në përmbyllje të këtij procesi, respektivisht në datat respektive nuk ka pranuar ndonjë koment, apo rekomandim.

Në seancën për votim të datës 27.03.2026, Kryetari I Komunes propozoj që pika e rendit të ditës e caktuar për votimin e Rregullores në fjalë të shtyhet për një seancë tjetër. Shtyrja e seancës ka dal si rezultat I pamundësisë së përfshirjes me kohë të propozimit për përfshirje të Sektorit të Tatimit në kuadër të Drejtorisë së Pronës, fakt I cili ka shkaktuar paqartësi dhe kundërshti në radhet e anëtarëve të Komitetit për Politik dhe Financa.

Me datë 03.04.2026 Komisioni pranoj kërkesën nga Kabineti I Kryetarit të Komunes për procedim të Draft-Rregullores dhe përfshirjen e saj si pikë e rendit të ditës për votim në seancën në ardhje të Kuvendit Komunal. Po ashtu është kërkuar që në rastin e procedimit të draft-rregullores në fjalë, të ketë parasysh korigjimin dhe evitimin e të metave të paraqitura në draft rregulloren respektive.

Bazuar në kërkesën e lartëcekur, Komisioni me datë 03.04.2026 mbledhet me qëllim të shqyrtimit të Draft-rregullores dhe evitimin e mangësive përfshirë korigjimin bërë si pasojë e terheqjes nga propozimi për përfshirje të Sektorit të Tatimit në Pronë në kuadër të Drejtorisë së Pronës. Në lidhje me këtë çështje, veprimet e ndërmarrura janë sqaruar detajisht në procesverbalin e datës 03.04.2026.

Komisioni me datë 07.04.2026 me email iu drejtohet Sekretarisë së Kuvendit Komunal për përfshirje në rend të ditës fillimisht në KPF për diskutim dhe pastaj në seancë për votim në Kuvendin Komunal.

Krahas kësaj kërkesë po të njëjtën datë Komisioni me email I përcjelli informacionet e nevojshme Kryetarit të Komunes rreth kompletimit të Draft-Rregullores në fjalë me rekomandimin që e njëjta është gatshme që të procedohet për votim në seancën në ardhje të Kuvendit Komunal.

Komisioni konsideron se versioni përfundimtar i Draft-Rregullores i prezentuar për votim i plotëson kushtet dhe kriteret ligjore qoft ato materiale dhe procedurale dhe si i till mund të procedohet për votim në seancën e Kuvendit Komunal.

Me respekt.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

DATË/A:	08.04.2026
REFERENCË:	<i>02-052/01-0012901-2/26</i>
PËR/ZA/TO:	z. Safet KAMBERI – Kryesues i Kuvendit Komunal dhe Anëtarët e Kuvendit të Komunës
CC:	z. Bedri MUJA – Kryetar i Komisionit për Hartimin e Draft – Rregullores për Plotësim-Ndryshimin e Rregullores Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale dhe Rregullores për Plotësim Ndryshim të Rregullorës 02/2024
NGA/OD/FROM:	z. Faton PEÇI – Kryetar i Komunës
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Propozim për përfshirje në Rendin e Ditës Miratimi i Rregullores Komunale



Bazuar në kompetencat dhe përgjegjësit që dalin nga dispozitat Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, neni 58, pika h), dhe Statuti i Komunës së Mitrovicës së Jugut, Kryetari i Komunës, paraqet këtë:

Propozim për përfshirje në Rendin e Ditës – Miratimi i Rregullores Komunale për Plotësim dhe Ndryshim të Rregullores nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 02/2024.

Komisioni për Hartimin e Draft-Rregullores, përmes emailit të datës 07.04.2026, ka njoftuar Kryetarin e Komunës se Draft-Rregullorja për Plotësim dhe Ndryshimin e Rregullores Komunale nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale (e ndryshuar me Rregulloren nr. 02/2024) është finalizuar dhe mund të procedohet për miratim në seancën e ardhshme të Kuvendit Komunal. Bazuar në kompetencat dhe përgjegjësitë e Kryetarit të Komunës si dhe rekomandimin e Komisionit respektiv, paraqita këtë propozim.

Me respekt.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

**RREGULLORE PËR PLOTËSIM DHE NDRYSHIM TË RREGULLORES
KOMUNALE NR. 01/2022 PËR ORGANIZIMIN, KOMPETENCAT DHE
PËRGJEGJËSITË E ORGANEVE TË ADMINISTRATËS KOMUNALE E
NDRYSHUAR DHE PLOTËSUAR ME RREGULLOREN NR. 02/2024**

Mitrovicë e Jugut

Prill 2026



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Në bazë të dispozitave të nenit, nenit 12, paragrafi 12.2, pika c, dhe nenit 40, pika 40.2, shkronja a) të Ligjit Nr. 03L-040 Për vetëqeverisjen lokale, neni 4, 5, 6 dhe 7 Rregullore (MAPL) nr. 02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës, neni 13, paragrafi 1, nën-paragrafi 3, neni 46, paragrafi 1, nën-paragrafi 1 dhe neni 84, paragrafi 2 të Statutit të Komunës së Mitrovicës së Jugut Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, Komisioni i formuar me Vendim të Kryetarit të Komunës me nr. prot. 01-020/04-0005970/26 të datës 02.02.2026, në mbledhjen e mbajtur me datë 03.04.2026, përgatiti këtë:

RREGULLORE PËR PLOTËSIM DHE NDRYSHIM TË RREGULLORES KOMUNALE NR. 01/2022 PËR ORGANIZIMIN, KOMPETENCAT DHE PËRGJEGJËSITË E ORGANEVE TË ADMINISTRATËS KOMUNALE E NDRYSHUAR DHE PLOTËSUAR ME RREGULLOREN NR. 02/2024

Neni 1

Kjo rregullore ka për qëllim plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësit e Administratës Komunale e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 02/2024.

Neni 2

1. Neni 19, paragraf 1, nënparagrafi 1.13 i Rregullorës bazë ndryshohet dhe riformulohet në vijim:
1.13. Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër;
2. Neni 19, paragrafi 1 plotësohet si në vijim:
1.15 Drejtoria e Pronës

Neni 3

1. Neni 80 i Rregullorës bazë, titulli ndryshohet dhe riformulohet Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër.
2. Neni 80, paragrafi 1 ndryshohet dhe riformulohet Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër kryen këto detyra dhe është përgjegjëse për:

3. Neni 80 i rregullorës bazë i fshihen nën-paragrafët 1.5, 1.6, 1.7, 1.18, 1.19 dhe 1.20.

Neni 4

1. Neni 81 i rregullorës bazë ndryshohet dhe riformulohet titulli në Organizimi i Drejtorisë së Gjeodezisë dhe Kadastrit.
2. Neni 81, paragrafi 1 ndryshohet dhe riformulohet në: Funkzioni i Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër do të bazohet në këta sektor:
3. Fshihet nën-paragrafi 1.3 i neni 81 i rregullorës bazë.

Neni 5

1. Neni 84 i Rregullores bazë fshihet dhe riformulohet si në vijim: Drejtoria e Pronës.

Neni 6

2. Pas neni 84 shtohen edhe 3 nene të reja dhe atë:

Neni 84

Drejtoria e Pronës

1. Menaxhon me pronën në pronësi të komunës;
2. Zhvillon procedurën e vlerësimit të pronës sipas kriterëve, standardeve dhe akteve normative në fuqi;
3. Kujdeset dhe mban evidencat e të dhënave pronësore ku bartës i të drejtës së pronësore dhe e shfrytëzimit është Kuvendi Komunal;
4. Nxjerr aktvendime, konkluzione dhe akte tjera konform dispozitave ligjore në fuqi;
5. Sigurimin e zotërimit të tokës, reduktimin e konstestëve për tokën;
6. Përmirësimin e transferimit të tokës, menaxhimi i tokës shtetërore dhe efikasiteti në taksimin e tokave;
7. Kryen procedurat rreth transaksioneve të pronës publike dhe kryen procedurat e blerjes, dhënies në këmbim dhe shfrytëzim të pronës komunale.
8. Shqyrton dhe vendos për kërkesat e personave fizikë dhe juridik për rregullimin e marrëdhënieve pronësore-juridike lidhur me pronën komunale;

9. Mbron pronën komunale-publike nga uzurpimet dhe udhëheq procedurat lidhur me këtë çështje;
10. Zhvillon procedurën e shpronësimit të tokës në pronësi private dhe shoqërore për pronat që përfshihen në interes publik;

Neni 84A

Organizimi i Drejtorisë së Pronës

1. Drejtoria e Pronës organizohet në këto sektor:
 - 1.1. Sektori i Pronës;
 - 1.2. Sektori për Shpronësime, Këmbime dhe Shfrytëzim të Pronës Komunale.

Neni 84B

Sektori i Pronës

1. Menaxhon me pronën e patundshme në pronësi të komunës;
2. Zhvillon procedurën e vlerësimit të pronës të patundshme sipas kriterëve, standardeve dhe akteve normative në fuqi;
3. Nxjerr aktvendime, konkluzione dhe akte tjera administrative;
4. Sigurimin e zotërimit të tokës, reduktimin e kontesteve pronësore dhe mbajtja e evidencës për pronat komunale që gjenden në procedurë gjyqësore;
5. Shqyrton dhe vendos për kërkesat e personave fizik dhe juridik për rregullimin e marrëdhënieve pronësore-juridike lidhur me pronën komunale;
6. Mbron pronën komunale-publike nga uzurpimet dhe udhëheq procedurat lidhur me këtë çështje.

Neni 84C

Sektori për Shpronësime, Këmbime dhe Shfrytëzim të Pronës Komunale

1. Kujdeset dhe mban evidencat e të dhënave pronësore ku bartës i të drejtës pronësore dhe e shfrytëzimit është Kuvendi Komunal;
2. Menaxhon me procedurat dhe çështjet që kanë të bëjnë me shpronësime të pronës së paluajtshme;
3. Kryen procedurat rreth transaksioneve të pronës së patundshme komunale, realizim e pagesave nga kontratat e shfrytëzimit të pronës komunale dhe kryen procedurat e blerjes, këmbimit dhe të dhënies në shfrytëzim të pronës komunale;
4. Zhvillon procedurën e shpronësimit të tokës në pronësi private dhe shoqërore për pronat që përfshihen në interes publik;

5. Nxjerr aktvendime, konkuluzione dhe akte tjera administrative;

Neni 7

Në afatin prej 30 ditësh pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, Kryetari i Komunës obligohet të zhvilloj procedurën për miratimin e organogramit të Komunës së Mitrovicës në përputhje me dispozitat e kësaj Rregulloreje dhe rregullores bazë.

Neni 8

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore shpallet 30 (tridhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë Përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Mitrovicë

Kryesuesi i Kuvendit

Safet Kamberi

Nazmi Jashari

From: Arta Azemi
Sent: Friday, April 3, 2026 10:21 AM
To: Bedri Muja
Cc: Enis Osmani; Shkelzen M. Haliti
Subject: Kërkesë për procedim Draft-Rregullores

Kërkesë për procedim Draft-Rregullores dhe përfshirjen e saj si pikë e rendit të ditës për votim në seancën e radhës të Kuvendit Komunal.

I drejtohem Komisionit për Hartimin e Rregullorës për Plotësim Ndryshim të Rregullorës 01/2022 dhe Rregullorës për Plotësim Ndryshim nr. 02/2024 që të procedoj draftin e hartuar në Komitetin për Politik dhe Financa në mënyrë që të përfshihet si pikë e rendit të ditës për votim në seancën e radhës të Kuvendit Komunal.

Po ashtu Komisioni në rastin e procedimit të draft-rregullores në fjalë, të ketë parasysht korigjimin dhe evitimin e të metave të paraqitura në draft rregulloren në fjalë.

Me respekt
Arta Azemi Ahmeti



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Në bazë të dispozitave të nenit, nenit 12, paragrafi 12.2, pika c, dhe nenit 40, pika 40.2, shkronja a) të Ligjit Nr. 03L-040 Për Vetëqeverisjen Lokale, neni 4, 5, 6 dhe 7 Rregullores (MAPL) nr. 02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës, neni 13, paragrafi 1, nën-paragrafi 3, neni 46, paragrafi 1, nën-paragrafi 1 dhe neni 84, paragrafi 2 të Statutit të Komunës së Mitrovicës së Jugut Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, Komisioni i formuar me Vendim të Kryetarit të Komunës me nr. prot. 01-020/04-0005970/26 të datës 02.02.2026, në mbledhjen e mbajtur me datë 03.04.2026, paraqiti këtë:

PROCESVERBAL

Prezantojnë: Bedri Muja – Kryetar

Lumturiye Brahimi – Anëtare

Albana Azemi Hajrizi - Anëtare

Mbledhja filloj në ora: 13²⁰

Tema:

Shqyrtimi shtesë I Draft – Rregullores për Plotësim-Ndryshimin e Rregullores Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale dhe Rregullores për Plotësim Ndryshim të Rregullorës 02/2024.

Pikat e shqyrtuara dhe propozimet:

Komisioni realizoj shqyrtime shtesë në Draft-Rregulloren e hartuar e cila ka kaluar fazën e diskutimit publik, pas të cilës do të prezentohet në shqyrtim në Komitet për Politik dhe Financa për tu proceduar si pikë e rendit të ditës në seancën e radhës.

Në shqyrtim të Draft-Rregullores, Komisioni vlerësoj se duhet të rishikohen pikat e evidentuara si më poshtë:

- Neni 84B, paragrafi 2: Bënë vlerësimin e pronës së patundshme sipas kritereve, standardeve dhe akteve ligjore në fuqi. Kjo dispozitë të riformulohet me terma më të aplikueshëm juridik si: “Zhvillon procedurën e vlerësimit të pronës sipas kritereve, standardeve dhe akteve normative në fuqi”.
- Neni 84C, paragrafi 2. Menaxhon me procedurat për ndarjen e ngastrave. Kjo dispozitë përfshihet në nenin 80, paragrafi 1.14 të rregullores bazë dhe si detyrë buron nga Ligji për Kadastrin e Pronës së Paluajtshme dhe rrjedhimisht kjo pikë mbetet e pa ndryshuar në rregulloren bazë, pra qendron në kuadër të Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër. Të fshihet kjo dispozitë nga draft-rregullorja.
- Neni 84C paragrafi 5 Bënë vërtetimin dhe zbaton procedurat për shitblerjen e pronës së patundshme. Kjo dispozitë fshihet nga draft-rregullorja, pra bëhet fjalë për dispozitën e nenit 80, paragrafi 1.21 I rregullores bazë. Si detyrë mbetet në kuadër të detyrave dhe përgjegjësive të Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër.
- Neni 7 I draft-rregullores: Pjesë përbërëse e kësaj rregullorje është organogrami I përgjithshëm I Komunës së Mitrovicës së Jugut të cilin duhet të jetë në harmoni me dispozitat e kësaj Rregullorje. Të riformulohet në: Në afatin prej 30 ditësh pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregullorje, Kryetari I Komunës obligohet të zhvilloj procedurën për miratimin e organogramit të Komunës së Mitrovicës së Jugut në përputhje me dispozitat e kësaj rregullorje, rregullores bazë.
- Neni 8 Pjesë përbërëse e kësaj rregullorje është Lista e Klasifikimit të Pozitave për Shërbimin Civil në Komunën e Mitrovicës së Jugut. Të fshihet për faktin se klasifikimi i vendeve të punës në shërbimin civil në Komunën e Mitrovicës është bërë tashmë, dhe në rastin e shtimit të drejtorisë dhe sektorëve, procesi i klasifikimit të vendeve të punës do të realizohet përmes procesit të ristrukturimit në listë. Referuar emailit të Njësisë së Burimeve Njerzore.

Dokumentacioni i shqyrtuar:

LIGJI NR. 03/L-040 PËR VETËQEVERISJEN LOKALE

LIGJI NR. 08/L-125 PËR PRONËN PUBLIKE

LIGJI NR.03/L-154 PËR PRONËSINË DHE TË DREJTAT TJERA SENDORE

LIGJI NR.03/L-139 PËR SHPRONËSIMIN E PRONËS SË PALUAJTSHME

LIGJI NR. 06/L-092 PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM DHE KËMBIMIN E PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

(përfshirë edhe ndryshimj plotësimet e ligjeve të listuara)

STATUTI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

RREGULLORE KOMUNALE NR. 01/2022

RREGULLORE KOMUNALE PËR PLOTËSIM NDRYSHIM NR. 02/2024, etj.

U vendos:

- Të riformulohet: Neni 84B, paragrafi 2. Zhvillon procedurën e vlerësimit të pronës sipas kritereve, standardeve dhe akteve normative në fuqi;
- Fshihet Paragrafi 2 I nenit 84C;
- Fshihet Paragrafi 5 I nenit 84C;
- Riformulohet neni 7 si: Në afatin prej 30 ditësh pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregullorje, Kryetari I Komunës obligohet të zhvilloj procedurën për miratimin e organogramit të Komunës së Mitrovicës së Jugut në përputhje me dispozitat e kësaj rregullorje, rregullores bazë dhe rregullores për plotësim dhe ndryshim të rregullores bazë;
- Fshihet neni 8.


Shqyrtimi dhe vendosja në lidhje me pikat e evidentuara si më lartë është bërë në përbërje të plotë të komisionit, ndërsa vendimi është nxjerr me numër unanim të votave. Kryesuesi I komisionit e mbyll takimin.

Mbledhja përfundoj në ora 15⁰⁵.

Procesmbajtës:



Kryesuesi i Komisionit





Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

DATE/A:	10.03.2026
REFERENCË:	02-052/01-00 12909/20
PËR/ZA/TO:	z. Safet KAMBERI – Kryesues i Kuvendit të Komunës z. Faton PEÇI – Kryetar i Komunës
CC:	Anëtarët e Kuvendit të Komunës
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Nazmi JASHARI – Udhëheqës i Sekretarisë së Kuvendit
NGA/OD/FROM:	z. Bedri MUJA – Kryetar i Komisionit për Hartimin e Draft – Rregullores për Plotësim-Ndryshimin e Rregullores Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale dhe Rregullores për Plotësim Ndryshim të Rregullorës 02/2024
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raport nga Konsultimi Publik për Draft – Rregulloren për Plotësim-Ndryshimin e Rregullores Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale dhe Rregullores për Plotësim Ndryshim të Rregullorës 02/2024

Bazuar në Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës së Mitrovicës së Jugut Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, nenin 14, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5, të Rregulloren (MAPL) Nr. 02/2021 Për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës, nenin 32, paragrafi 1, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komunë, dhe me qëllim të nxitjes dhe sigurimit të pjesëmarrjes së qytetarëve dhe palëve të tjera gjatë procesit të politikëbërjes dhe vendimmarrjes në Kuvendin e Komunës së Mitrovicës së Jugut, Komisioni i formuar me Vendim nr. prot. 01-020/04-0005970/26 të datës 02.02.2026, ka shpall Diskutimin Publik për Draft – Rregulloren për Plotësim-Ndryshimin e Rregullores Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale dhe Rregullores për Plotësim Ndryshim të Rregullorës 02/2024, për datën 27.02.2026, në Sallën e Kuvendit të Komunës, duke filluar nga ora 10:00 h dhe mundësin për dërgimin e komenteve dhe sugjerimeve përmes email adresës deri me datë 06.03.2026.

Ecuria e procesit

Komisioni në harmoni me Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe dispozitat e Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komunë, ka publikuar Njoftimin

për Konsultim Publik të Draft – Rregullores për Plotësim-Ndryshimin e Rregullores Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale në ueb faqen e Komunës 8 (tetë) ditë para mbajtjes së takimit në linkun: <https://mitroviceejugut.rks-gov.net/news/njoftim-per-konsultim-publik/në>, Platformën për Konsultime Publike të Qeverisë së Republikës së Kosovës (<https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=42985>), dhe në rrjetet sociale të Komunës.

Njoftimi për Konsultim Publik është shpall në afatin e paraparë ligjor, respektivisht, nenin 29, paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komunë, duke u interesuar që të sigurohet Njoftim i Plotë dhe i duhur për palët e interesuara. Me Njoftimin për Konsultim Publik palët e interesuara janë njoftuar me datën, vendin dhe kohën e mbajtjes së takimit publik, përveç kësaj edhe mundësin për dërgimin e komenteve dhe sugjerimeve përmes email adresës deri me datë 06.03.2026. Njoftimit i është bashkangjitur Draft – Rregullorja për Plotësim-Ndryshimin e Rregullores Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale dhe Rregullores për Plotësim Ndryshim të Rregullorës 02/2024 që ka qenë objekt i konsultimit publik, shpjegime shtesë, si dhe informatat për personin përgjegjës për pranimin e komenteve.

Metodat e Konsultimit	Kohëzgjatja	Nunri i pjesëmarrësve/kontribuesve
1. Publikimi në ueb faqe	8 ditë para mbajtjes së takimit kryesor	12 Persona dhe atë në përbërje gjinore: - 6 persona nga gjinia femërore dhe - 6 persona nga gjinia mashkullore

Në konsultim publik për Draft – Rregulloren për Plotësim-Ndryshimin e Rregullores Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale kanë marrë pjesë: Komisioni Punues i Draft – Rregullores për Plotësim-Ndryshimin e Rregullores Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale dhe Rregullores për Plotësim Ndryshim të Rregullorës 02/2024, Njësia për Komunikim me Publikun, përfaqësues të fshatrave dhe disa nga zyrtarët e drejtorive.

Në këtë Diskutim Publik nuk ka pasur kërkesa, komente apo rekomandime për ndryshime shtesë jashtë Draftit të punuar nga Komisioni, përveç se të pranishmit kërkuan sqarime shtesë lidhur me ndryshimet e propozuara në këtë Draft.

Përveç kësaj të pranishmit kanë ngritur çështjen e lehtësimit të procedurave për bartjes dhe regjistrimit të drejtës së pronësisë, për të cilat u njoftuan se kjo çështje është e trajtuar me akte ligjore dhe si e till nuk bie në fushë-veprimtarinë dhe objektin e kësaj rregulloreje.

Po ashtu sikurse në shpalljen e konsultimit publik, respektivisht deri me datë 06.03.2026 (c premtë) dhe në vijim nuk kemi pranuar ndonjë sugjerim apo koment në email adresë.

SHTOJÇË:

Lista e pjesëmarrësve në Diskutim Publik.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica - Municipality of Mitrovica South

Nr. 01-020/04-0005970/26-2 dt. 27.02.2026
Mitrovicë

Lista e pjesëmarrjes në Tubimin Publik lidhur me Draft - Rregulloren për Plotësim dhe Ndryshim të Rregullores Komunale nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Organeve të Administratës Komunale e Ndryshuar dhe Plotësuar me Rregulloren nr. 02/2024.

Nr.	Emri e Mbiemri	Datë	Nënshkrimi
1.	ISAIC HAJRA	27.02.2026	
2.	XHIZLARI B. ALI	27.02.2026	
3.	ALBANA AZEMI	27.02.2026	
4.	LUMTURIDE BRAHIMI	27.02.2026	
5.	Bedri Muxa	27.02.2026	
6.	Hënkula Maxhuni	27.02.2026	
7.	Mirza Jashari	27.02.2026	
8.	Hana Rushiti Hakaj	27.02.2026	
9.	Merita Meteo	27.02.2026	
10.	VANJA BASHIRI	27.02.2026	
11.	Refik Hoxhja	27.02.2026	
12.	ICONIDA SHEHITI	27.02.2026	
13.		27.02.2026	
14.		27.02.2026	
15.		27.02.2026	
16.		27.02.2026	
17.		27.02.2026	
18.		27.02.2026	
19.		27.02.2026	
20.		27.02.2026	
21.		27.02.2026	
22.		27.02.2026	
23.		27.02.2026	
24.		27.02.2026	
25.		27.02.2026	
26.		27.02.2026	
27.		27.02.2026	
28.		27.02.2026	
29.		27.02.2026	
30.		27.02.2026	
31.		27.02.2026	
32.		27.02.2026	
33.		27.02.2026	
34.		27.02.2026	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Prot. 01-020/04-0005970/26-2

Datë 18.02.2026

Bazuar në dispozitat e nenit 68 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Statuti i Komunës së Mitrovicës së Jugut, neni 17 pika 1.2 dhe neni 22 pika 2 e Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komunë dhe neni 14, nën-paragrafi 1.5 i Rregullorës (MAPL) nr. 02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës, Komisioni i formuar me Vendim të Kryetarit të Komunës me nr. prot. 01-020/04-0005970/26 të datës 02.02.2026, organizon këtë:

KONSULTIM PUBLIK

Për

Draft - Rregullore për Plotësim dhe Ndryshim të Rregullores Komunale nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Organeve të Administratës Komunale e Ndryshuar dhe Plotësuar me Rregulloren nr. 02/2024.

Të nderuar qytetarë dhe subjekte të Komunës e Mitrovicës së Jugut, ju njoftojmë se Draft - Rregullorja për Plotësim dhe Ndryshim të Rregullores Komunale nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Organeve të Administratës Komunale e Ndryshuar dhe Plotësuar me Rregulloren nr. 02/2024 ka hy në fazën e Konsultimit Publik, për çka ju ftoj që të merrni pjesë në konsultimin publik I caktuar të mbahet me datë 27.02.2026 (e premte), në ora 10⁰⁰ në Sallën e Mediave, kati I i-rë në objektin e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Të drejtën e pjesëmarrjes e kanë të gjithë qytetarët dhe organizatat e ndryshme të Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Këtij njoftimi iu bashkangjitet Draft - Rregullore për Plotësim dhe Ndryshim të Rregullores Komunale nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Organeve të Administratës Komunale e Ndryshuar dhe Plotësuar me Rregulloren nr. 02/2024, ku mund ta gjeni të publikuar në webfaqen zyrtare të Komunës së Mitrovicës së Jugut, <https://mitroviccejugut.rks-gov.net/>.

Komentet dhe sugjerimet e juaja, mund t'i dërgoni deri me datë 06.03.2026 (e premte), në email adresën: bedri.muja@rks-gov.net.




Kryesues i Komisionit

Bedri Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Kryetari i Komunës

Nr. 01-020/04-0005970/26 dt. 02.02.2026
Mitrovicë

Bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenet 14 dhe 77 të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, dhe Kërkesën Elektronike nga z. Shkelzen Haliti – Kabineti i Kryetarit, dt. 28.01.2026, Kryetari i Komunës sjell këtë:

V E N D I M

(Për Formimin e Komisionit për Hartimin e Ndryshim-Plotësimit të Rregullores Komunale Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjëstë e Administratës Komunale e Ndryshuar dhe Plotësuar me Rregullorën Nr. 02/2024)

- 1. FORMOHET** Komisioni për Hartimin e Ndryshim-Plotësimit të Rregullores Komunale Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjëstë e Administratës Komunale e Ndryshuar dhe Plotësuar me Rregullorën Nr. 02/2024, në këtë përbërje:
 - 1.1** Bedri Muja – kryetar (Drejtoria e Inspektionit);
 - 1.2** Lumturije Brahim – anëtare (Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë);
 - 1.3** Albana Azemi – anëtare (Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë).
2. Komisioni është përgjegjës që të bëjë ndryshimin e Rregullores Komunale Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjëstë e Administratës Komunale, e Ndryshuar dhe Plotësuar me Rregullorën Nr. 02/2024, duke shqyrtuar propozimet për ndryshime nga Zyra e Kryetarit dhe Drejtoritë Komunale, dhe të bëjë harmonizimin e këtyre ndryshimeve sipas dispozitave ligjore në fuqi.
3. Komisioni në fjalë obligohet që pas hartimit të Draft - Rregullores për Ndryshimin e Rregullores së lartcekur të njëjtën ta procedojë në Kuvendin e Komunës për shqyrtim dhe miratim përmes Kryetarit të Komunës.
4. Komisioni punues bazë për punën e tij do të ketë: Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Rregullorën (MAPL) Nr. 02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimit e



Merita Preteni

From: Besa Veseli
Sent: e hënë, 16 shkurt 2026 13:52
To: Bedri Muja
Subject: Arsyetim lidhur me komponenten gjinore

I nderuar,

Pasi që kjo rregullore paraqet akt për plotësim dhe ndryshim të Rregullores baze Nr. 01/2022 dhe nuk përben akt të ri normativ. Dispozitat e saj kanë karakter organizativ dhe strukturor, duke rregulluar ndarjen e kompetencave dhe organizimin e brendshëm të administratës komunale.

Theksoj se në hartimin e rregullores baze Nr. 01/2022 kam dërguar komentet për përfshirjen e parimeve të barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit, ndërsa për këtë akt plotësues vlerësoj se nuk cenon, ndryshon apo kufizon parimet e barazisë gjinore të përcaktuara në legjislativ.

Terminologjia e përdorur në këtë Rregullore është neutrale dhe zbatohet në mënyrë të barabartë për të gjitha gjinitë.

Me respekt,

Besa Veseli – Zyrtare për Barazi Gjinore
Email: Besa.Veseli@rks-gov.net
Tel: 049734760

From: Bedri Muja <Bedri.Muja@rks-gov.net>
Sent: Friday, February 13, 2026 1:40 PM
To: Lulzim Hajra <Lulzim.Hajra@rks-gov.net>; Zenel Citaku <Zenel.Citaku@rks-gov.net>; Lavdim Musa <Lavdim.Musa@rks-gov.net>; Besa Veseli <Besa.Veseli@rks-gov.net>
Cc: Enis Osmani <enis.osmani@rks-gov.net>; Albana Azemi <Albana.Azemi@rks-gov.net>; Lumturije Brahim
<lumturije.brahimi@rks-gov.net>
Subject: Pershendetje!

Të nderuar,

Shpresoj që jeni mirë dhe punët po ju ecin mbar,

Kryetari i Komunës me Vendimin Nr. 01-020/04-0005970/26 i datës 02.02.2026 ka formuar Komisionin për Hartimin e Draft-Rregullores për Ndryshim – Plotësim të Rregullores 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale dhe Rregullores 02/2024.

Në cilësi të Kryetarit të Komisionit, ju njoftoj se Komisioni ka përfunduar Draftin Final në bazë të rekomandimeve që i kemi marrë nga Drejtoritë/Njësitë përkatëse, të cilin po ju bashkangjesim në attach, së bashku me Rregulloren bazë.

Ju lutem që të analizoni këtë Draft, dhe të na konfirmoni harmonizimin e tij dhe zbatimin e teknikave të aktit secili për fushën e tij, duke përfshirë aspektin ligjor dhe financiar dhe sugjerimet të i dërgoni më së largu deri më datë 17.02.2026 (ditën e Marte) në ora 14:00 h.

(Drafti në fjalë mund të ketë gabime drejtëshkrimore për të cilat do ti korigjojm në zhvillim të këtij procesi).
)

Në emër të komisionit ju falenderojë për angazhimin tuaj.

Merita Preteni

From: Zenel Citaku
Sent: e hënë, 16 shkurt 2026 11:23
To: Bedri Muja
Cc: Enis Osmani; Albana Azemi; Lumturije Brahimi; Lulzim Hajra; Lavdim Musa; Besa Veseli
Subject: RE: Pershendetje!

Të nderuar/a,

Në cilësinë e Zyrtarit Kryesor Financiar, pas shqyrtimit të Draft-Rregullores për Ndryshim-Plotësim të Rregullores nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale dhe të Rregullores nr. 02/2024, ju njoftoj lidhur me aspektin buxhetor-financiar si në vijim:

Buxheti i Komunës për vitin 2026 është i aprovuar, ndonëse ende nuk ka hyrë në zbatim, pasi që aktualisht jemi duke operuar me ndarjet e përkohshme mujore (1/12) të Buxhetit të vitit 2025. Çdo ndryshim eventual në strukturën organizative që implikon krijimin e kodeve të reja buxhetore, përfshirë edhe kod të veçantë për Drejtorinë e Pronës, nuk mund të realizohet në këtë fazë të vitit fiskal.

Krijimi i kodit të ri buxhetor mund të bëhet vetëm në kuadër të procesit të rishikimit të buxhetit dhe pas marrjes së aprovimeve dhe lejimeve të nevojshme nga Ministria e Financave, përkatësisht përmes reflektimit në sistemin BDMS.

Deri në përfundimin e këtyre procedurave, Drejtoria e Gjeodezisë dhe Kadastrit dhe Drejtoria e Pronës do të vazhdojnë të operojnë në kuadër të të njëjtit kod buxhetor ekzistues.

Nga këndvështrimi buxhetor-financiar, Draft-Rregullorja nuk paraqet implikime shtesë financiare në buxhetin e aprovuar për vitin 2026, me kusht që organizimi dhe funksionimi i njëjstëve të përfshira të mbetet brenda kornizës së ndarjeve buxhetore ekzistuese deri në rishikimin e buxhetit.

Me respekt,

From: Bedri Muja <Bedri.Muja@rks-gov.net>
Sent: Friday, February 13, 2026 1:40 PM
To: Lulzim Hajra <Lulzim.Hajra@rks-gov.net>; Zenel Citaku <Zenel.Citaku@rks-gov.net>; Lavdim Musa <Lavdim.Musa@rks-gov.net>; Besa Veseli <Besa.Veseli@rks-gov.net>
Cc: Enis Osmani <enis.osmani@rks-gov.net>; Albana Azemi <Albana.Azemi@rks-gov.net>; Lumturije Brahimi <lumturije.brahimi@rks-gov.net>
Subject: Pershendetje!

Të Nderuar,

Shpresoj që jeni mirë dhe punët po ju ecin mbar,

Kryetari i Komunës me Vendimin Nr. 01-020/04-0005970/26 i datës 02.02.2026 ka formuar Komisionin për Hartimin e Draft-Rregullores për Ndryshim – Plotësim të Rregullores 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale dhe Rregullores 02/2024.

Ne cilësi të Kryetarit të Komisionit, ju njoftoj se Komisioni ka përfunduar Draftin Final në bazë të rekomandimeve që i kemi marrë nga Drejtoritë/Njësitë përkatëse, të cilin po ju bashkangjesim në attach, së bashku me Rregulloren bazë.

Ju lutem që të analizoni këtë Draft, dhe të na konfirmoni harmonizimin e tij dhe zbatimin e teknikave të aktit secili për fushën e tij, duke përfshirë aspektin ligjor dhe financiar dhe sugjerimet të i dërgoni më së largu deri më datë 17.02.2026 (ditën e Marte) në ora 14:00 h.

(Drafti në fjalë mund të ketë gabime drejtëshkrimore për të cilat do ti korigjojm në zhvillim të këtij procesi).

)

Në emër të komisionit ju falenderojë për angazhimin tuaj.

Merita Preteni

From: Lulzim Hajra
Sent: e hënë, 16 shkurt 2026 11:18
To: Bedri Muja
Cc: Enis Osmani; Albana Azemi; Lumturije Brahimi; Zenel Citaku; Lavdim Musa; Besa Veseli
Subject: RE: Pershendetje!

Përshendetje të nderuar, fillimisht ju përgëzoj për punën dhe angazhimin në hartimin e kësaj draft rregullore.

Fillimisht numri i protokollit dhe data duhet të largohen sepse i vendos Sekretaria e Kuvendit, pas miratimit.

Në preambulë pas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale duhet përfshirë edhe Statuti i Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, konkretisht neni 13 paragrafi 1 nënparagrafi 3, neni 46 paragrafi 1 nënparagrafi 1, dhe neni 84 paragrafi 2.

Në titull të Draftit, tek emërtimi e cekni: Rregullore për Ndryshim dhe Plotësim të Rregullores Komunale... Tutje në rastet kur riformulohet neni apo paragrafi apo edhe në rastet kur shtohet një i tillë, duhet cekur “riformulohet/shtohet si në vijim:”, pastaj vazhdon në kryerresht duke startuar me numrin e nenit ose paragrafit, pastaj teksti. Kjo praktikë duhet përcjellur në tërë tekstin.

Në nenin 5, ku keni cekur “Fshihet neni 84 i rregullores bazë”, duhet cekur “Neni 84 i Rregullores bazë fshihet dhe Riformulohet si në vijim”. Dhe këtu pra në nenin 84 vazhdoni me Drejtorinë e krijuar – Neni 84, Drejtoria e Pronës, tutje me paragrafë specifikoni detyrat dhe përgjegjësit.

Pastaj tek neni 5 i Draftit ku specifikoni “Pas Nenit 89 të rregullores bazë, shtohen 4 nene të reja dhe atë:”, duhet të specifikoni që pas Nenit 84 të Rregullores bazë shtohen edhe 3 nene të reja (Neni 84 A Organizimi i Drejtorisë së Pronës – 84 B, Sektori i Pronës dhe 84 C Sektori për Shpronësim, Këmbim dhe Shfrytëzim të Pronës Komunale).

Si dhe neni 9 i Draftit - Hyrja në fuqi duhet riformuluar

Kjo Rregullore shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë Përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Kjo Referuar Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin e Detyrueshëm të Akteve Komunale dhe Rregullores (MAPL) nr. 02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës.

Siç e keni cekur edhe ju para procedimit duhet bërë edhe lekturimi.

Duke shpresuar në mirëkuptimin nga ana e juaj, ne ju përsëndesim.

Gjitha të mirat.

From: Bedri Muja <Bedri.Muja@rks-gov.net>

Sent: Friday, February 13, 2026 1:40 PM

To: Lulzim Hajra <Lulzim.Hajra@rks-gov.net>; Zenel Citaku <Zenel.Citaku@rks-gov.net>; Lavdim Musa <Lavdim.Musa@rks-gov.net>; Besa Veseli <Besa.Veseli@rks-gov.net>

Cc: Enis Osmani <enis.osmani@rks-gov.net>; Albana Azemi <Albana.Azemi@rks-gov.net>; Lumturije Brahimi <lumturije.brahimi@rks-gov.net>

Subject: Pershendetje!

Të Nderuar,

Shpresoj që jeni mirë dhe punët po ju ecin mbar,

Kryetari i Komunës me Vendimin Nr. 01-020/04-0005970/26 i datës 02.02.2026 ka formuar Komisionin për Hartimin e Draft-Rregullores për Ndryshim – Plotësim të Rregullores 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale dhe Rregullores 02/2024.

Ne cilësi të Kryetarit të Komisionit, ju njoftoj se Komisioni ka përfunduar Draftin Final në bazë të rekomandimeve që i kemi marrë nga Drejtoritë/Njësitë përkatëse, të cilin po ju bashkangjesim në attach, së bashku me Rregulloren bazë.

Ju lutem që të analizoni këtë Draft, dhe të na konfirmoni harmonizimin e tij dhe zbatimin e teknikave të aktit secili për fushën e tij, duke përfshirë aspektin ligjor dhe financiar dhe sugjerimet të i dërgoni më së largu deri më datë 17.02.2026 (ditën e Marte) në ora 14:00 h.

(Drafti në fjalë mund të ketë gabime drejtëshkrimore për të cilat do ti korigjojme në zhvillim të këtij procesi).

)

Në emër të komisionit ju falenderojë për angazhimin tuaj.



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës Jugore
Opština Mitrovica Juzna- Municipality of Mitrovica South

DATE/A:	08.04.2026
REFERENC-Ë:	02-400/03-0018797/26
PËR/ZA/TO:	z. Safet KAMBERI – Kryesues i Kuvendit
KOPJE :	Arkivit
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Faton PEÇI - Kryetari i Komunës
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për bartjen e të hyrave vetanake të pashpenzuara në vitin 2025 dhe vitet paraprake në vitin 2026



Të nderuar/a,

Organizata buxhetore (642) – Komuna e Mitrovicës, në zbatim të Ligjit Nr. 10/ L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, bilancet e pashpenzuara të të hyrave vetanake të komunave nga viti fiskal 2025 dhe vitet paraprake, të depozituara në Fondin e Kosovës dhe të regjistruara në SIMFK si ndarje buxhetore për një komunë, ndahen për vitin fiskal 2026 sipas autorizimeve të LMFPF-së.

Andaj me këtë shkresë kërkojmë nga **Komiteti për Politikë dhe Financa** që të bëhet aprovimi i bartjes së të hyrave vetanake në vlerë totale 1,229,563.36 euro

- Kategorinë e shpenzimeve Mallra dhe Shërbime, në programet/nënprogramet:
Zhvillimi Ekonomik (48022) në vlerë 804,563.36 euro;
Inspektime (16643) në vlerë 80,000.00 euro;
Menaxhimi i katastrofave natyrore (18466) në vlerë 30,000.00 euro dhe
Zyra e Kuvendit (16922) në vlerë 20,000.00 euro
TOTALI në kategorine Mallra dhe Shërbime 934,563.36 euro.
- Kategorinë e shpenzimeve Subvencione dhe Transfere, në nënprogramet:
Administrata e Përgjithshme (16322), në vlerë 75,000.00 euro dhe
Shërbimet Kulturore (85022), në vlerë 80,000.00 euro.
Bujqësia (47022), në vlerë 90,000.00 euro
Shërbimet Sociale (75606), në vlerë 50,000.00 euro
TOTALI në kategorine Subvencione dhe Transfere 295,000.00 euro

Me respekt!

Arsyetimi:

1.1 Në zbatim të Nenit 6 pika 3 e LIGJIT NR. 08/L-332 MBI NDARJET BUXHETORE PËR BUXHETIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN 2025 Të hyrat vetanake komunale nga arsimit regjistrohen veçmas dhe të hyrat e tilla autorizohen dhe shfrytëzohen nga komuna vetëm për qëllime të arsimit.

-
- 2.1 Qëllimi i këtyre mjeteve është “ Hartimi i projekteve për investime kapitale ”
 - 2.2 Qëllimi i këtyre mjeteve është “Trajtimi i qenëve që bredhin lirshum në Komunën e Mitrovicës - qentë endacak”
 - 2.3 Qëllimi i këtyre mjeteve është “ Mirëmbajtja e Ndriqimit Publik”
 - 2.4 Qëllimi i këtyre mjeteve është “ Mirëmbajtja Verore”
 - 2.5 Qëllimi i këtyre mjeteve është “Larja dhe fshirja e rrugëve”
 - 2.6 Qëllimi i këtyre mjeteve është “ Riparimi dhe rregullimi i rrugëve dhe shesheve”
 - 2.7 Qëllimi i këtyre mjeteve është “ Sinjalizimi rrugore”

2.1 “Hartimi i projekteve per Investime Kapitale” nevojiten edhe 110,000.00 euro që të plotësohet planifikimi dhe te bëhet hartimi i projekteve per investime kapitale qe jane te nevojshme dhe domosdoshme për procedura tenderuese dhe zhvillimin e projekteve.

2.2 “Trajtimi i qenëve që bredhin lirshum në Komunën e Mitrovicës - qentë endacak” nevojiten edhe 100,000.00 euro për shkak të ofrimit të sigurisë publike dhe trajtimit human të tyre.

2.3 “ Mirëmbajtja e Ndriqimit Publik” nevojiten 120,000.00 euro që të plotësohet planifikimi dhe te behet rregullimi dhe mirmbajtja e ndriqimit publik për shkak të sigurisë publike në rrugëve lokale.

2.4 “ Mirëmbajtja Verore” nevojiten 150,000.00 euro për shkak sigurisë si dhe shtimit të jetëgjatësisë së infrastrukturës rrugore.

2.5 “ Larja dhe fshirja e rrugëve ” nevojiten 120,000.00 euro për shkak të mirëmbajtjes se rrugeve duke bere pastrimin, fshirjen dhe larjen e rrugeve dhe sigurin ne shendet.

2.6 “ Riparimi dhe rregullimi i rrugëve dhe shesheve ” nevojiten 120,000.00 euro që të plotësohet planifikimi dhe te bëhet rregullimi i rrugeve dhe troturave si dhe shesheve që janë të dëmtuara.

2.7 “ Sinjalizimi rrugore” nevojiten edhe 84,563.36 euro që të plotësohet planifikimi dhe te shtohet siguria duke bere sinjalizimin dhe rrit sigurine ne trafik e cila është edhe obligim ndaj komunikacionit dhe sigurise se rrugëve lokale.

Me respekt!

Arsyetimi:

Administrata e Përgjithshme (16322)

- Qëllimi i shfrytëzimit të mjeteve të bartura nga të hyrat vetanake të vitit 2025 në vitin 2026 është rritja e numrit të bursave për studentët, si dhe rritja e shumës së përkrahjes financiare nga 630 € në 720 € për student, me qëllim të përmirësimit të mbështetjes për arsimimin e lartë - 75,000.00 €.
-

Shërbimet Sociale (75606)

- Qëllimi i shfrytëzimit të mjeteve të bartura nga të hyrat vetanake të vitit 2025 në vitin 2026 është realizimi i pagesave për shërbimet e varrimit “Bashkësia Islame” – 50,000.00 €.
-

Menaxhimi i Katastrofave Natyrore (18466)

- Qëllimi i shfrytëzimit të mjeteve të bartura nga të hyrat vetanake të vitit 2025 në vitin 2026 është blerja e pajisjeve profesionale për Njësinë e Zjarrfikjes dhe Shpëtimit (NJZSH), duke përfshirë radiolidhjet dhe pajisje të tjera të nevojshme, të cilat konsiderohen prioritet i Drejtorisë për këtë periudhë, me qëllim të rritjes së kapaciteteve operacionale dhe sigurisë në terren – 30,000.00 €.
-

Shërbimet Kulturore (85022)

- Qëllimi i shfrytëzimit të mjeteve të bartura nga të hyrat vetanake të vitit 2025 në vitin 2026 është subvencionimi i klubeve sportive, me qëllim të mbështetjes dhe zhvillimit të aktiviteteve sportive në komunë - 80,000.00 €.
-

Inspektimet (16643)

- Qëllimi i shfrytëzimit të mjeteve të bartura nga të hyrat vetanake të vitit 2025 në vitin 2026 është kontraktimi i një operatori ekonomik për rrënimin, largimin si dhe sanimin/riparimin e parregullsive dhe dëmeve të shkaktuara në terren nga subjektet e papërgjegjshme, me qëllim të përmirësimit të gjendjes në hapësirat publike dhe sigurimit të zbatimit të rregullave në fuqi - 70,000.00 €.
 - Po ashtu, një shumë prej 10,000.00 € është planifikuar në kategorinë paga dhe mëditje, në kodin ekonomik 11431 për mbulimin e punës jashtë orarit.
-

Bujqësia (47022)

Qëllimi i shfrytëzimit të mjeteve të bartura është realizimi i projekteve si në vijim:

- Memorandum bashkëpunimi me NH “Iber Lepenc” – 35,000.00 €;
- Subvencionimi i fermerëve për sasinë e qumështit të dorëzuar në pikat grumbulluese (0.10 € për njësi) – 15,000.00 €;
- Instalimi i paneleve solare në ekonomitë bujqësore (shtallat) – 30,000.00 €;
- Pompa uji për ujitje – 10,000.00 €.



KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

DATE/A:	07.04.2026,
REFERENCË:	Nr. 02-060/01-0018345-4/26
PËR/ZA/TO:	Anëtarët e Kuvendit të Komunës Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa
CC:	Faton Peci – Kryetar i Komunës
NGA/OD/FROM:	Safet Kamberi – Kryesues i Kuvendit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Propozim Vendim Për kompensim të anëtarëve të Komiteteve Konsultative, Komiteteve tjera, kryetarëve të këshillave lokale dhe komisioneve Ad hoc të formuara nga Kuvendi i Komunës, për vitin 2026

Duke u bazuar në nenin 12, paragrafi 2, pika d, dhe 58 pika h, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale (GZ Nr. 28, publikuar më 4 qershor 2008); nenin 4, paragrafi 1,2,3 dhe nenin 14 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.01/2016 Për procedurën e themelimit, organizimin dhe kompetencat e komiteteve konsultative në komuna: nenit 15 paragrafi 1,2,3 të Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr. 05/2020 Për Procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe Komiteteve Tjera në Komonë: nenin 12 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) NR. 02/2019 Për organizmin, funksionimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane: në nenin 13, paragrafi 1, nën paragrafi 1.4 paragrafi 1 nën paragrafi 1.10 të Statutit të Komunës, Komitetit për Politikë dhe Financa dhe përmes tij Kuvendit të Komunës i propozoj këtë:

VENDIM

Për kompensimin të anëtarëve të Komiteteve Konsultative, Komiteteve tjera, kryetarëve të këshillave lokale dhe komisioneve ad hoc të formuara nga Kuvendi i Komunës, për vitin 2026

1. MIRATOHET vendimi për kompensimin e anëtarëve të Komiteteve Konsultative dhe Komiteteve tjera, kryetarëve të këshillave lokale dhe komisioneve Ad hoc të formuara nga Kuvendi i Komunës për vitin 2026 në Komunën e Mitrovicës së Jugut, në shumën prej 50,00 € (pesëdhjetë) për mbledhje.
2. Sipas pikës 1 të këtij vendimi Anëtarët e komiteteve konsultative të themeluara nga Kuvendi i Komunës së Mitrovicës së Jugut me Vendimin Nr. 02-060/01- 0011451-4/26 dt. 27.03.2026, për punën e tyre kompensohen nga buxheti i komunës, Kodi mallra dhe shërbime i Zyrës së Kuvendit të Komunës.
 - 2.1 Anëtarët e komiteteve konsultative nuk mund të paguhen për më shumë se gjashtë (6) mbledhje të cilat mbahen brenda vitit.
 - 2.2 Kompensimi sipas këtij neni jepet vetëm një (1) herë brenda muajit dhe paguhet vetëm nëse anëtarët Komitetit marrin pjesë në mbledhje.
3. Komitetet Tjera janë themeluar me Vendim të kuvendit të Komunës për punën e tyre

kompensohen nga buxheti i komunës, Kodi mallra dhe shërbime i Zyrës së Kuvendit të Komunës.

3.1 Anëtarët e komiteteve tjera nuk mund të paguhen për më shumë se gjashtë (6) mbledhje të cilat mbahen brenda vitit.

3.2 Kompensimi sipas këtij neni jepet vetëm një (1) herë brenda muajit dhe paguhet vetëm nëse anëtarët Komitetit marrin pjesë në mbledhje.

3.3 Anëtarët e komiteteve tjera përfshijn anëtarët e komiteteve themeluara me Vendime të kuvendit të komunës si në vijim:

3.3.1 Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale Vendimi Nr. 02-060/01-0005630-6/26, dt. 10.02.2026,

3.3.2 Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, Vendimi Nr. 02-060/01-0005630-7/26, dt. 10.02.2026,

3.3.3 Komiteti për Zhvillim Ekonomik Vendimi Nr. 02-060/01-0005630-8/26, dt. 10.02.2026,

3.3.4 Komiteti për Planifikim Urban, Kadastër, Pronë dhe Mbrojtje të Ambientit Vendimi Nr. 02-060/01-0005630-9/26, dt. 10.02.2026,

3.3.5 Komitetit për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim Vendimi Nr. 02-060/01-0005630-10/26, dt. 10.02.2026,

3.3.6 Komiteti për Barazi Gjinore Vendimi Nr. 02-060/01-0005630-11/26, dt. 10.02.2026.

4. Kryetarët e këshillave lokale për punën e tyre kompensohen nga buxheti i komunës Kodi mallra dhe shërbime i Zyrës së Kuvendit të Komunës.

4.1 Kompensimi për pjesëmarrjen në mbledhje bëhet vetëm për gjashtë (6) takime të këshillit lokal të mbajtura brenda vitit.

4.2 Kompensimi sipas këtij neni jepet vetëm një (1) herë brenda muajit dhe paguhet vetëm nëse kryetari merr pjesë në mbledhje.

5. Anëtarët e Komisioneve ad hoc të formuara nga Kuvendi i Komunës, kompensohen nga buxheti i komunës Kodi mallra dhe shërbime i Zyrës së Kuvendit të Komunës. Anëtarët e komisioneve ad hoc nuk mund të paguhen për më shumë se gjashtë (6) mbledhje të cilat mbahen brenda vitit.

6. Për Zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Kryesuesi i Kuvendit të Komunës në bashkëpunim me Drejtorin për Buxhet e Financa.

7. Vendimi shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.





Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës
Opština Mitrovica – Municipality of Mitrovica

DATË/A:	30.03.2026
REFERENCË/A	02-400/03 - 0018087/26
PËR/ZA/TO:	z. Safet Kamberi – Kryesues i Kuvëndit ne Komunën e Mitrovicës se Jugut
CC:	z. Gazmend Gjoshaj - Drejtor për Buxhet dhe Financa
PËRMES/ PREKO/ THROUGH:	z. Faton Peci - Kryetar i Komunës se Mitrovicës Jugore
NGA/OD/FROM:	z. Ramadan Beshiri - Drejtor i Drejtorisë për Mirëqenie Sociale
TEMA/SUBJEKAT/ SUBJECT:	Propozim vendim për Subvencionimin e fëmijëve me autizëm

Të nderuar,

Duke synuar të jemi pranë kategorive në nevojë dhe të rrisim përfshirjen sociale, Drejtoria e Mirëqenies Sociale përmes Kryetarit z. FATON PEÇI, propozon përkrahje financiare për fëmijët me autizëm, të evidentuar nga Qendra për Punë Sociale në Mitrovicën e Jugut.

Sipas listës zyrtare të Qendrës për Punë Sociale, janë evidentuar: **52 fëmijë me autizëm nga mosha (0-18). Propozimi: 50 € subvencion për secilin fëmijë. Llogaritja: 52 × 50 € = 2,600.00 €.**

Ky propozim vjen në prag të 2 Prillit – Ditës Botërore për Ndërgjegjësim ndaj Autizmit dhe përfaqëson një mbështetje simbolike, por të rëndësishme, për këtë kategori dhe familjet e tyre. Jemi të vetëdijshëm për sfidat dhe barren e vazhdueshme financiare dhe sociale për trajtimin e fëmijëve me autizëm, andaj kemi parë të arsyeshme këtë mbështetje drejtuar kategorisë së personave me aftësi të kufizuara me autizëm.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës
Opština Mitrovica – Municipality of Mitrovica

DATE/A:	20.04.2026
REFERENCË/A	02-352/01-0021964/20
PËR/ZA/TO:	z. Safet Kamberi – Kryesues i Kuvendit ne Komunën e Mitrovicës se Jugut
CC:	z. Gazmend Asllani – Drejtori i Kulturës, Rinisë dhe Sportit z. Arjeta Beqiri Hyseni – Drejtoresha për Mbrojtje të Mjedisit
PËRMES/ PREKO/ THROUGH:	z. Façon Peci - Kryetar i Komunës se Mitrovicës Jugore
NGA/OD/FROM:	z. Ramadan Beshiri - Drejtor i Drejtorisë për Mirëqenie Sociale
TEMA/SUBJEKAT/ SUBJECT:	Propozim vendim për: vendosjen e Pllakës Përkujtimore Heroit “Driton Veliu”

Të nderuar,

Në mbështetje të, neneve për kompetencat komunale nga **Ligji Nr. 03/L-040** për Vetëqeverisjen Lokale, i cili përcakton se komunat kanë kompetencë të plotë për të rregulluar dhe menaxhuar çështjet e interesit publik local. Parimit të subsidiaritetit dhe autonomisë lokale, sipas të cilit komuna vendos për organizimin e hapësirave publike dhe kujtesën historike në territorin e saj. Kompetencave për menaxhimin e pronës komunale dhe hapësirave publike.

Drejtoria për Mirëqenie Sociale propozon, vendosja e Pllakës Përkujtimore për Hero “Driton Veliu”, i cili ra heroikisht më 21 prill 1999, në luftën për Çlirimtare për çlirimin e Kosovës. Pllaka përkujtimore vendoset në Iliridë, pranë stadiumit të futbollit “Australia”, në rrugën që mban emrin “Driton Veliu”, si hapësirë publike në administrim të Komunës së Mitrovicës.

ARSETIM I PROPOZIM-VENDIMIT për vendosjen e pllakës përkujtimore kushtuar hero “Driton Veliu”.

Vendosja e kësaj pllake përkujtimore ka për qëllim ruajtjen dhe kultivimin e kujtesës kolektive, nderimin e sakrificës së dëshmorëve dhe promovimin e vlerave të lirisë dhe atdhedashurisë tek brezat e rinj. Po ashtu, kjo nismë kontribuon në identitetin historik dhe kulturor të komunitetit lokal.

Specifikat e pllakës përkujtimore:

- Dimensionet: 45 cm x 65 cm
- Materiali: Granit (material i qëndrueshëm ndaj kushteve atmosferike, i përshtatshëm për hapësira publike)
- Vlera: 350 € (Pagesa nga kategoria: Mallra dhe Shërbime)
- Punëkryesi i kontraktuar: “Granit Dizajn” - Mitrovicë

Lokacioni i vendosjes

Lagja Iliridë, pranë stadiumit të futbollit “Australia”, në rrugën që mban emrin “Driton Veliu”, hapësirë publike në administrim të Komunës së Mitrovicës.

Ky lokacion është përzgjedhur duke marrë parasysh rëndësinë simbolike dhe lidhjen me komunitetin lokal, si dhe aksesin e lirë për qytetarët.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës Jugore
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

DATË/A:	21.04.2026
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	Ramadan Beshiri -Drejtorja për Mirëqenie Sociale
CC:	Arkivit
PËRMES/PREKO/THROUGHT	Nazmi Kelmendi -Drejtor i Drejtorisë për gjeodezi, Kadastër dhe Pronë
NGA/OD/FROM:	Albana Azemi -Zyrtare për Çështje Pronësore
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Konfirmim mbi pronësinë e parcelës

I nderuar Drejtor z. Ramadan Beshiri,

Në bazë të kërkesës tuaj të adresuar me anë të emailit, ju njoftojmë se sipas të dhënave zyrtare në dispozicionin tonë, parcela me nr P-71208072-02915-2 Zona Kadastrale Mitrovicë, me sipërfaqe 1360m², rezultoi e regjistruar në emër të Komuna e Mitrovicës Jugore me numër personal 600535126. Ky konstatim bazohet në të dhënat zyrtare të regjistruara dhe të verifikuara në sistemin përkatës kadastral.


Me respekt!



print_2026-04-20


Y: 7487957.569
X: 4749288.977

Y: 7488327.477
X: 4749288.977



Y: 7487957.569
X: 4749027.426

Y: 7488327.477
X: 4749027.426





Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor / Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja /

Ministry of Environment and Spatial Planning

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71208072-02915-28

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:	Certificate draft
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:	20.04.2026 - 14:51
Komuna / Opština / Municipality:	MITROVICË / MITROVICA / MITROVICË
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:	Mitrovicë / Mitrovica / Mitrovicë
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:	MITROVICË / MITROVICA / MITROVICË

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësisë kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësisë Vrsta Jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m ²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-71208072-02915-28	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Drushtvena Imovina / Socially owned Land	Urban	16023	REG.PARAQ.36/12 RN.Korigjim Zyrtar Aktvendimi iDGJKP Nr.15-464-63615/15		24.07.2015

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKJE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
GRADSKA EKONOMIJA/IBAR	0			24.07.2015

A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja (m ²) Površina (m ²) Area (m ²)
1	Bujqësore/Poljoprivredno/Agriculture	Arat/Njive/Arable	Arë E Klasës 3/Njiva 3 Klase/3rd Class Arable Land	1360

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojedinsti adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Posehim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	Komuna e Mitrovicës Jugore	600535126	MITROVICË / MITROVICA / MITROVICÉ /		BEDRI GJINAJ	1/1	138-2004	



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor / Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja /

Ministry of Environment and Spatial Planning

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71208072-02915-2

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:	Certificate draft
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:	20.04.2026 - 14:51
Komuna / Opština / Municipality:	MITROVICË / MITROVICA / MITROVICË
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:	Mitrovicë / Mitrovica / Mitrovicë
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:	MITROVICË / MITROVICA / MITROVICË

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësisë kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësisë Vrsta Jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-71208072-02915-2	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land		1360	138-2004		

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKJE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
GRADSKA EKONOMIJA	0			

A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta korisçenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno korisçenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja (m ²) Površina (m ²) Area (m ²)
1	Bujqësore/Poljoprivredno/Agriculture	Arat/Njive/Arable	Arë E Klasës 3/Njiva 3 Klase/3rd Class Arable Land	16023

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojedinsti adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	Komuna e Mitrovicës Jugore	600535126	MITROVICË / MITROVICA / MITROVICË /		BEDRI GJINAJ	1/1	REG.PARAQ.36/12 RN	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës Jugore
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

DATE/A:	20.04.2026
REFERENC-Ë:	02-463/06-0021360/26
PËR/ZA/TO:	Znj. Safet Kamberi, Kryesues i Kuvendit të Komunës
CC:	Anëtarëve të Kuvendit Komunal dhe Komitetit për Politikë dhe Financa
NGA/OD/FROM:	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport Drejtore Gazmend Asllani
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Kryetari i Komunës z. Faton Peci
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Propozim - Vendim

Bazuar në nenet 12, 14 dhe 58, pika (h) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 21 paragrafi 1, pika 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, të Rregullores së (QRK) nr. 09/2020, për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, neni 13, 15, 77, paragrafi 1.10, të Statutit të Komunës Mitrovica Jugore Nr.02-060/01-0056607/20-4, datë 24.09.2020, si dhe në propozim vendimin e drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, i Propozon Kuvendit të Komunës këtë:

PROPOZIM - VENDIM

Për caktimin e selisë së përhershme të muzeut të qytetit të Mitrovicës

1. I Propozohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim të Propozimit - Vendimit për caktimin e selisë së përhershme të muzeut të qytetit të Mitrovicës
2. Prona e Paluajtshme Komonale e propozuar për caktim të selisë është:
 - Parcela Kadastrale P-71208072-01600-6, në sipërfaqe prej: S=1812m² Parcela Kadastrale P-71208072-01600-7, në sipërfaqe prej: S=2375m², në vendin e quajtur "Ish Domi i Armates", në pronësi Komuna e Mitrovicës Jugore, Zona Kadastrale Mitrovicë, sipas Çertifikatës mbi të drejtat e pronës të lëshuar nga Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë.
3. Qëllimi i propozimit për caktimin e selisë së përhershme është sepse edhe objekti i cili është i ndertuar në pronën e lartëcekur është objekt i mbrojtur dhe në shfrytëzim nga Muzeu i qytetit ku mbas caktimit të selisë do të mundësohen edhe investimet në këto hapësira .
4. Shfrytëzimi (caktimi i selisë) i pronës do të jetë në kohëzgjatje të përhershme.
5. Caktimi i selisë së pronës së paluajtshme të Komunës nga pika 2, do të evidentohet në regjistrin e të drejtave pronësore.

6. Për zbatimin e këtij Vendimi kujdesen Kryetari i Komunës, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Drejtoria për Planifikim dhe Urbanizëm dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport .

8.Vendimi shpallet pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Shtojcë:

- Çertifikata mbi të Drejtat e Pronës
- Kopja e Planit;




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY
KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : MITROVICË
Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Mitrovicë

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-71208072-01600-7	Parcelë / Parcela / Parcel	2375
P-71208072-01600-6	Parcelë / Parcela / Parcel	1812



Shkalla/Razmera/Scale: 1:743

Punoi/Obradio/Created: Ruzhdi Ujkanj

Nënshkrimi/Potpis/Signature: 

Shënim/Beleška/Note:

Data/ Data/Date: 17.04.2026

Koha/ Vreme/ Time: 11:35:22





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor / Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja /
Ministry of Environment and Spatial Planning
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

EKSTRAKT NGA CERTIFIKATA / IZVOD IZ CERTIFIKATA / EXTRACT OF CERTIFICATE

PERSONI/OSOBA/PERSON : Komuna e Mitrovicës Jugore

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:	15-942-0020984
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:	17.04.2026 - 11:33
Komuna / Opština / Municipality:	MITROVICË / MITROVICA / MITROVICË
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:	MITROVICË / MITROVICA / MITROVICË

A. TË DHËNAT PËR PERSONIN / PODACI O OSOBI / PERSON'S DATA

Mbiemri/Emri i afarizmit (biznesit) Prezime/ Naziv poslovanja (biznisa) Last Name / Business Name	Emri Ime First Name	Emri i babait Ime oca Father's Name	Gjinia Pol Gender	Nr. personal/ biznesit Lični broj/broj poslovanja ID. No.	Shteti i shtetësisë apo regjistrimit Država državljanstva ili uknjiženja Country of citizenship	Ditëlindja/Data e themelimit Rodendan/Dan osnivanja Date of Birth/Establishment	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
Komuna e Mitrovicës Jugore			/	600535126	KOSOVA / KOSOVA / KOSOVO		24.12.2020	05.01.2021

A.1 ADRESA E PERSONIT / ADRESA OSOBE / PERSON'S ADDRESS

Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Hollësitë e adresës Pojedinsti adrese Address Details	Adresa tjetër Druga adresa Other address	Azhuruar Ažurirano Updated
MITROVICË / MITROVICA / MITROVICË		BEDRI GJINAJ		05.01.2021

B. NJESIA KADASTRALE/ KATASTARSKA JEDINICA/CADAstral UNIT

Njësia kadastrale Katastarska jedinica Cadastral unit	Komuna / Opština / Municipality	Zona kadastrale Katastarska zona Cadastral zone	Lloji i njësisë Vrsta jedinice Unit type	Tipi i pronës Tip imovine Property Type / Lloji i pronës Vrsta imovine Property kind	Kati/ Katet Br.Sprat a/ Spratova Floor number	Vendi i quajtur Zvano mesto Place name	Sipërfaqja Površina Area	Shfrytëzimi aktual/Kultura- klasa Aktualna upotreba/ Kultura-klasa Actual use/Culture-class	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Lloji i së drejtës Vrsta prava Type of the right	Azhuruar Azurirano Updated
P-71208072-01600-6	MITROVICË / MITROVICA / MITROVICË	Mitrovicë / Mitrovica / Mitrovicë	PARCELË / PARCELA / parcel	Pronë shoqërore Drushtvena Imovina Socially owned Land / U		KEJ LJUSHTE / KEJ LJUSHTE / KEJ LJUSHTE	1812	Tokë Ndërtimore - Oborr - (782 m²) / Tokë Ndërtimore - Shtëpi-Ndërtese - (1030 m²) / / Gradjevinsko zemljište - Dvorište - / Gradjevinsko zemljište - Kuca- Zgrada - / / Construction land - BackYard - / Construction land - House-Building - / /	1 / 1	Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	19.07.2023
P-71208072-01600-7	MITROVICË / MITROVICA / MITROVICË	Mitrovicë / Mitrovica / Mitrovicë	PARCELË / PARCELA / parcel	Pronë shoqërore Drushtvena Imovina Socially owned Land / U		KEJ LJUSHTE / KEJ LJUSHTE / KEJ LJUSHTE	2375	Tokë Ndërtimore - Oborr - (2375 m²) / / Gradjevinsko zemljište - Dvorište - / / Construction land - BackYard - / /	1 / 1	Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	19.07.2023
Totali i sipërfaqes së parcelave:							4187				



Arsyetim


Arsyeja pse po e kerkojme te ju caktohet selia e perhershme e Muzeut te qytetit eshte sepse objekti ne te cilen eshte I vendosur dhe eshte objekt I mbrojtur, dhe si komun dhe si drejtori nuk mundemi te investojme ne hapesirat te cilat gjinden aty deri ne caktimin e selise. Caktimi I selise eshte shume I domosdoshem ku perveq investimeve si komune mundemi te kemi edhe investime tjera nga Ministria.

Muzeu eshte I vendosur ne kekte object nga viti 2009 por qe ansjeher nuk eshte bere investim ne infrastruktur te objektit

Si drejtori kemi te ndara mjete per Muzeun 150,000.00 viti 2026 , 250,000.00 viti 2027 si dhe 350,000.00 euro viti 2028 ne total 700,000.00 euro.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government



Ministria e Ekonomisë
Ministarstvo Ekonomije /Ministry of Economy

Për:	Faton Peci, Kryetar i Komunës Mitrovicë e Jugut Safet Kamberi, Kryesues i Kuvendit Mitrovicë e Jugut Erblin Hetemi, Drejtor i Departamentit Ligjor /MAPL
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër në MAPL Jeton Qela Sekretar i Përgjithshëm në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve/MAPL
Përmes:	Artane Rizvanolli, Ministre e Ekonomisë <i>p.p. Çmijaku</i> Leonita Shabani Mullarama, Sekretare e Përgjithshme në Ministrinë e Ekonomisë
Nga:	Deniza Krasniqi, Ud. Drejtoreshë e Departamentit Ligjor/ME
Datë:	17.03.2026
Zyrtarët përgjegjës: 1.Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor 2.Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Dëfrim Pllashniku, Udhëheqës i Divizionit për Politika të NP/NJPMNP <i>D. Pllashniku</i> Arbërore Bërnica-Hasani, Analiste ligjore/NJPMNP
Lënda:	Shqyrtim i ligjshmërisë së aktit të Komunës Mitrovicë e Jugut
Lloji i aktit:	Vendimi i Kuvendit të Komunës Mitrovicë e Jugut

I nderuar Kryetar z. Peci,
I nderuar Kryesues z. Kamberi,

